

Dhjetor 2017
Numri: 117
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

Orientimi NË KOHË TRAZIRASH



TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*


Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Dhjetor 2017

VITI: XI

NUMRI: 117

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Maqedonija

Mob: +389 7042 8245

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJTOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

- Net të errëta dhe fitne...

- Kohë, kur ai që vret nuk e di për çfarë po vret dhe ai që vritet nuk e di përse u vra... (Muslim, Fiten, 55.)

- Kohë, kur njeriu do të gdhiehet besimtar dhe do të ngryset mohues, ose do të ngryset besimtar dhe do të gdhiehet mohues, ndërsa feja do të shitet për një çmim shumë të vogël... (Muslim, Iman, 186.)

Këto janë kohët për të cilat i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka paralajmëruar besimtarët...

Mbi të gjitha, paralajmërimet e Profetit (a.s.), i cili flet për vajtje-ardhjet nga besimi në mohim, e nga mohimi në besim, kanë të bëjnë direkt me besimtarët. Pra, është e pamundur të mos shqetësohesh!.. Po sikur zemrat tona të jenë përballë një rreziku të tillë të rënies në anaforen e kësaj vajtje-ardhjeje!..

Besimtarët kanë përjetuar periudha të tilla të vështira që prej shekujve të parë.

Për shembull, i Dërguari i Allahut, (a.s.), përdor fjalën, "herxh", kur flet për këto periudha të kohës... Kur u pyet, "çfarë është herxh", ai përgjigjet: "Vrasja juaj me njëri-tjetrin!" (Buhari, Ilim, 24, Hakim, Mustedrek, IV, 504/8412.)

Në luftën e Siffinit, e cila në Historinë Islame cilësohet si "fitneja e parë", në krye të njërës anë prej dy grupeve që u përballën me njëri-tjetrin, qëndronte djali i xhaxhait dhe dhëndri i Profetit (a.s.), Aliu (r.a.), ndërsa në krye të anës tjetër qëndronte ish-sekretari i Profetit (a.s.), i cili shkruante shpalljen pasi i zbritet atij, Muauija (r.a.). Në këtë luftë u vranë shtatëdhjetë mijë persona. Të dyja palët ishin besimtarë. Midis dëshmorëve gjendeshin edhe sahabë si Ammar bin Jasir (r.a.). Pak para ngjarjes së Siffinit, kishte ndodhur ngjarja e Xhemelit. Në atë ngjarje shohim se janë përfshirë në luftë personalitete si Aisheja (r.a.) dhe Aliu (r.a.).

Brenda një feje, ku sipas kriterëve të Kuranit, të vrasësh një njeri, është njësoj sikur të vrasësh gjithë njerëzimin, prej të dyja palëve vriten shtatëdhjetë mijë besimtarë. Gjeje tani përgjigjen e një pyetje të tmerrshme e cila do të vazhdojë të përsëritet mbase gjatë gjithë historisë Islame: "Çfarë janë të vrrarët, çfarë janë vrasësit?"...

Çfarë ndodhi që myslimanët rrëshqitën në një situatë të tillë pa kaluar ende gjysmë shekulli prej emigrimit të Profetit (a.s.), në botën tjetër? Si arritën ta shihnin njëri-tjetrin si njerëz që mund të vriten? Si e legjitimuan qëndrimin e tyre? Si e nxorën gjykimin Islam për këtë dhe ishin aq të sigurt për llogarinë në botën tjetër?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë, "si errësira e natës..." E mbase për këtë shkak syri nuk e sheh syrin në këto kohë...

Nuk është e lehtë të thuash, "neve nuk na prek kjo!.." Njeri është ky. Brenda ka edhe egërsirën, edhe melekun...

"Shejtani shëtiti në damarët e njeriut..." (Ebu Daud, Sunnet, 18.)

Për këtë arsye i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë se, "I fortë nuk është ai që e mund kundërshtarin në mundje, por ai që mbizotëron zemërimin e tij kur nervozohet!" Kjo, sepse të mundësh kundërshtarin në mundje, është çështje e forcës fizike. Përpiqesh, stërvitesh dhe nëse e arrin atë forcë, arrin edhe sukses. Por, zemërimi është një çështje shpirtërore dhe, kur të fryhen damarët, nuk është e lehtë ta frenosh atë. E aq më keq nëse zemërimi merr përmasa shoqërore dhe e shtyn atë drejt dhunës... Pikërisht këtu, lind një ambient linçimi dhe barbarie shoqërore.

Përmbajtja



Qytetërimi i Urave
Dr. Ardian Mushi

16




8

Pesha jonë specifike
Nuredin Jëlldëz



Gjithësia, Kurani dhe Njeriu - 3
Osman Nuri Topbash

34



10

24

Sahabi që mori pjesë në dy Akabetë
Muadh Ibn Harith (r.a.)
Mustafa Erish



5 Ruajtja e orientimit në kohë fitnesh
Ahmet Tashgetiren

10 Falimentimi njerëzimit
Ali Riza Temel

13 Varësia ndaj alkoolit dhe drogës
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

19 Pajtimi ndërmjet besimtarëve
M. Sami Ramazanollu

20 Urdhri i parë
Idris Arpat

22 Thellësia e meditimt në besim
Xhafer Durmush

26 Vetëbesimi
Xhihan Tashtan

27 Lumturia është të kuptuarit
Muaz Erdem

28 Kush janë personazhet e Hockney-t?
Edison Çeraj



48

I dituri dhe i riu shëtitës 29
Urtësi

Islami në Spanjë 30
Alisia Rodrighez Mejuta
Një Ajet - Një Hadith 32

Semi dhe Basir 40
Ilir Hoxha

Të kuptosh që të jetosh 45
Edison Çeraj

Të mësosh duke luajtur 48
Hulja Akbul Çakër

Shëndeti dhe mendja jonë janë në rrezik 50
Fatma H. Liman

Degët e xhenetit 54
Seher Ajdën

Urtësia dhe vetëpërmbajtja 56
Ferid Piku

42



Psikologjia dhe prehtë
Kybra Ergin



Vegjetativët
Nuredin Nazarko

46

RUAJTJA E ORIENTIMIT NË KOHË FITNESS

— Ahmet Tashgetiren —

- Net të errëta dhe fitne¹...

- Kohë, kur ai që vret nuk e di për çfarë po vret dhe ai që vritet nuk e di përse u vra... (Muslim, Fiten, 55.)

- Kohë, kur njeriu do të gdhiet besimtar dhe do të ngryset mohues, ose do të ngryset besimtar dhe do të gdhiet mohues, ndërsa feja do të shitet për një çmim shumë të vogël... (Muslim, Iman, 186.)

Këto janë kohët për të cilat i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka paralajmëruar besimtarët...

Njerëzit i kanë lexuar këto ngjarje si “shenja të Kiametit”, pra, “ndodhi që do të zhvillohen në kohën para Kiametit”. Nga një anë ata i kanë parë nëse kishin apo jo ngjashmëri me kohën në të cilën jetonin, duke u shqetësuar dhe frikësuar, por nga ana tjetër edhe nuk e kanë vrarë shumë mendjen dhe i kanë anashkaluar (këto shenja), duke i parë sikur “kanë ende kohë”!..

1. - Fitne: Trazirë, turbullirë apo ngatërresë që lind një situatë ku është e vështirë të ndahet e drejta nga e padrejta, e mira nga e keqja, e sakta nga e gabuara. (Allahu na ruajttë!).

Mirëpo, nëse para “Kiametit të përgjithshëm”, i shohim këto si, “kiameti i njeriut”, si “kiameti i shoqërisë”, ose si zëri i hapave të Kiametit të përgjithshëm dhe i mendojmë si një shenjë e procesit të prishjes që zgjatet nëpër shekuj, duke i konsideruar ato që po përjetojnë dhe situatën në të cilën gjendemi, në një vijë me Kiametin, atëherë do ta kuptojmë se po shkojmë drejt Kiametit.

Mbi të gjitha, paralajmërimet e Profetit (a.s.), i cili flet për vajtje-ardhjet nga besimi në mohim, e nga mohimi në besim, kanë të bëjnë direkt me besimtarët. Pra, është e pamundur të mos shqetësohesh!.. Po sikur zemrat tona të jenë përballë një rreziku të tillë të rënies në anaforën e kësaj vajtje-ardhjeje!..

Besimtarët kanë përjetuar periudha të tilla të vështira që prej shekujve të parë.

Për shembull, i Dërguari i Allahut, (a.s.), përdor fjalën, “herxh”, kur flet për këto periudha të kohës... Kur u pyet, “çfarë është herxh”, ai përgjigjet: “Vrasja juaj me njëri-tjetrin!” (Buhari, Ilim, 24, Hakim, Mustedrek, IV, 504/8412.)

Në luftën e Siffinit, e cila në Historinë Islame cilësohet si “fitneja e parë”, në krye të njëres anë prej dy grupeve që u përballën me njëri-tjetrin, qëndronte djali i xhaxhait dhe dhëndri i Profetit (a.s.), Aliu (r.a.), ndërsa në krye të anës tjetër qëndronte

ish-sekretari i Profetit

(a.s.), i cili shkruante

shpalljen pasi i zbrittej

atij, Muauija (r.a.). Në këtë

luftë u vranë shtatëdhjetë mijë

persona. Të dyja palët ishin besimtarë.

Midis dëshmorëve gjendeshin edhe sahabë

si Ammar bin Jasir (r.a.). Pak para ngjarjes së Siffinit, kishte ndodhur ngjarja e Xhemelit. Në atë

ngjarje shohim se janë përfshirë në

luftë personalitete si Aishe-

ja (r.a.) dhe Aliu

(r.a.).

Ditën luftonin, ndërsa në mbrëmje varrosnin trupat e atyre që vrisnin. Shumica ishin të afërm dhe e njihnin njëri-tjetrin. Mbase para pak ditësh kishin falur edhe namazin së bashku në të njëjtën xhami... Por...

Brenda një feje, ku sipas kriterëve të Kuranit, të vrasësh një njeri, është njësoj sikur të vrasësh gjithë njerëzimin², prej të dyja palëve vriten shtatëdhjetë-mijë besimtarë. Gjeje tani përgjigjen e një pyetje të tmerrshme e cila do të vazhdojë të përsëritet mbase gjatë gjithë historisë Islame: *“Çfarë janë të vrarët, çfarë janë vrasësit?”*...

Çfarë ndodhi që myslimanët rrëshqitën në një situatë të tillë pa kaluar ende gjysmë shekulli prej emigrimit të Profetit (a.s.), në botën tjetër? Si arritën ta shihnin njëri-tjetrin si njerëz që mund të vriten? Si e legjitimuan qëndrimin e tyre? Si e nxorën gjykimin Islam për këtë dhe ishin aq të sigurt për llogarinë në botën tjetër?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë, *“si errësira e natës...”* E mbase për këtë shkak syri nuk e sheh syrin në këto kohë...

Nuk është e lehtë të thuash, *“neve nuk na prek kjo!”* Njeri është ky. Brenda ka edhe egërsirën, edhe melekun...

“Shejtani shëtiti në damarët e njeriut...” (Ebu Daud, Sunnet, 18.)

Për këtë arsye i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë se, *“I fortë nuk është ai që e mund kundërshtarin në mundje, por ai që mbizotëron zemërimin e tij kur nervozohet!”* Kjo, sepse të mundësh kundërshtarin në

mundje, është çështje e forcës fizike. Përpiqesh, stërvitesh dhe nëse e arrin atë forcë, arrin edhe sukses. Por, zemërimi është një çështje shpirtërore dhe, kur të fryhen damarët, nuk është e lehtë ta frenosh atë. E aq më keq nëse zemërimi merr përmasa shoqërore dhe e shtyn atë drejt dhunës... Pikërisht këtu, lind një ambient linçimi dhe barbarie shoqërore.

TË MENDOJMË KERBELANË

Ç’ishte ajo fatkeqësi? Çdo të thotë të vrasësh nipin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), t’i presësh kokën, t’ia vendosësh mbi heshtë dhe t’ia shpiesh në Damask!? Çfarë poshtërsie është kjo? Çfarë barbarie?..

Le të mendojmë për ditët kur kufomat e njerëzve nxirreshin prej varreve dhe rriheshin...³ Vrasjet që u bënë ndër shekuj në emër të racizmit fisnor-klanor...

Dhe “egoja e grupit” që ka arritur deri në kohën tonë, e cila lindi fitne në marrëdhëniet e myslimanëve me njëri-tjetrin...

Një person e kap të Dërguarin e Allahut, (a.s.), prej jakës, e tërheq fort dhe i thotë: *“Ndaje drejt plaçkën e luftës!”*. E ç’të thoshte i Dërguari i Allahut, (a.s.), përballë këtij njeriu pa takt? Prandaj e pa të nevojshme të thoshte se: *“Nëse unë nuk jam i drejtë, prej kujt tjetër prisni drejtësi?”*

Momenti i ndarjes së plaçkës është i vështirë. Njeriu mund ta prishë marrëdhënien edhe me Profetin e Zotit. Njerëz të tillë gjen gjithmonë. Në kohë ndarjeje të plaçkës, syri i disa njerëzve mund të mos e shohë as të Dërguarin e Allahut. Ky potencial i çuditshëm njerëzor fle brenda nesh dhe kur na gjen të dobët ose

2. - shih. Maide, 32.

3. - Tensioni midis Abbasitëve dhe Emeuitëve.

kur gjendemi në një sprovë të vështirë, ai mund të dalë dhe të na tjetërsojë.

Një sprovë e tillë ishte ajo e shigjetarëve të Uhudit, të cilët e lëshuan kodrën, që nuk duhej ta lëshonin kurrë, kur panë se në fushëbetejë po mblidhej plaçka e luftës...

Këto janë dobësi njerëzore që janë përjetuar në kohën e Profetit, i cili ka qenë vetë dëshmitar dhe që Kurani i ka korrigjuar...

Ta zëmë se jemi në kohë lufte... Personi me të cilin po luftoni papritur thotë shehadetin. Çfarë do të bëni?

Nëse e vrisni dhe për t'u arsyetuar thoni, "besoi nga frika", i Dërguari i Allahut, (a.s.), do t'ju kërkojë llogari duke thënë: *"Përse e vrave një person që besoi, përse e vrave? A mos ia hape zemrën dhe pe ç'kishte në të?"*

Ta zëmë se personi me të cilin po luftoni, ju pësh-tyn në fytyrë pikërisht kur jeni duke e varur! Çfarë do të bëni?

Nëse hiqni dorë nga vrasja e tij për shkak të frikës se mos jeni duke e varur ngaqë ofendoj personin tuaj, pikërisht ky është qëndrimi i një personaliteti me disiplinë të lartë shpirtërore si Aliu (r.a.).

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka njoftuar se, do vijë një kohë kur disa njerëz do të lexojnë Kuran, por ai nuk do t'ju zbrësë poshtë fytit.

Vallë kush janë ata?

Kush janë ata që edhe pse lexojnë Kuran, ai nuk do t'iu shtojë asgjë jetës së tyre?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në të njëjtin hadith thotë: *"Kur shikoni namazet dhe agjërimet e tyre do të nënvleftësoni namazet dhe agjërimet tuaja!"*⁴ Domethënë se, në dukje, në jetën e tyre fetare nuk ka asnjë problem. Domethënë se, marrëdhënia me Kuranin, është një çështje tjetër botëkuptimi.

Kur harixhinjtë e kundërshtuan Aliun (r.a.), në çështjen e "gjykatësit" dhe sollën si argument ajetin, *"...Vendimi i përket vetëm Allahut!.."*⁵, Aliu (r.a.), iu përgjigj duke thënë: *"Thonë fjalë të drejta, por synojnë të shtrembtën!"*. Po, *"...Vendimi i përket vetëm Allahut!.."*, është shprehje e Kuranit, është fjala e Allahut, por nëse e përdorni atë për dëshirat tuaja, mund ta ktheni atë në arsyetim për punë të këqija.

Kur është koha e fitneve?

A po e përjetojmë ne kohën e fitneve?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk ka përcaktuar asnjë datë.

Kur është pyetur se "kur do të bëhet Kiameti?", Profeti (a.s.), nuk jep datë të saktë, që ne të mund të themi, "kjo kohë është koha para Kiametit".

Në këtë situatë, çdo njeri dhe çdo shoqëri duhet të shohë jetën e vet dhe të ruhet nga një kohë kur mund të gdhiet besimtar e të ngryset mohues. Ata duhet të përpiqen ta plotësojnë ditën prej mëngjesit deri në mbrëmje si besimtarë. Duhet të zhvillojnë një disiplinë shpirtërore të atillë, që të mund t'i mbizotërojnë damarët e tyre, për të mos e lejuar shejtanin të shëtisë në to. Marrëdhënien me Librin e Allahut duhet ta ndryshojnë, që të mos jenë nga "ata që nuk u kalon poshtë fytit", por ta bëjnë atë "librin e jetës" së tyre.

TË RUASH ORIENTIMIN...

Kjo është puna më e vështirë.

Lëkundjet janë pjesë e pandashme e jetës së njeriut dhe shoqërisë. Do të ketë patjetër ulje-ngritje, vështirësi-lehtësi, ngushtime-lirime. Kjo është e paevitueshme!

Ndonjëherë, fitne mund të bëhet pasuria, e ndonjëherë varfëria... Ndonjëherë fuqia, e ndonjëherë dobësia... Ndonjëherë do të ketë fitne në luftë, e ndonjëherë në paqe...

Cila është zgjidhja për të ruajtur orientimin?

Disiplina e të jetuarit sikur je duke e parë Allahun! Të mos e harrosh Allahun, të mos e harrosh se Allahu i Madhëruar na sheh dhe se Ai na jep forcën për të bërë çdo gjë që jemi duke bërë! Të mos e harrojmë se nëse ai na e pret frymëmarrjen, nuk do të kemi fuqi për asgjë dhe, për këtë arsye, duhet të ruhem në mënyrë instinktive nga veprimi i diçkaje me të cilën Ai nuk është i kënaqur, njësoj sikur të na pritet fryma!..

Të bëjmë kujdes të mos na prishet përbërja kimike e trupit dhe e shpirtit tonë...

Dhe në kohët kur mendoni se po përjetoni fitne, të veproni ashtu siç ka këshilluar i Dërguari i Allahut, (a.s.): *"Të luteni dhe të strehoheni tek Allahu, ashtu siç përgjërohet njeriu i cili është duke u mbytur"* (Bejhaki, Shuab, II, 367-1077.)

4. - Buhari : 7.v.3381.fq – 15.v.6798.

5. - Jusuf, 40.

Pesha jonë specifike

Nuredin Jëlldëz

Si umet, pesha jonë specifike është në atë gradë sa të matet me të gjithë njerëzimin. Ne jemi një umet **“i ardhur për gjithë njerëzimin”**. Që prej Ademit (a.s.), e këtij, çdo gjë që është krijuar në emër të njerëzimit, janë fusha jonë e interesit. Çdo gjë që ka lidhje me mbrojtjen dhe gjallërimin e së mirës dhe eliminimin e së keqes, është në supet e këtij umeti.

Ne nuk jemi të kufizuar me kohën dhe vendin ku jetojmë. Për këtë arsye, pesha jonë specifike si umet, në asnjë mënyrë nuk është e kufizuar me “Lindjen e Mesme” apo me “arabët”. Ne jemi përfaqësuesit e Islamit tek i gjithë njerëzimi. Barra në supet tanë, është një barrë e ngarkuar në emër të njerëzimit. Peshën tonë, mund ta matim me peshën e gjithë njerëzimit prej njeriut të parë, e deri tek i fundit. Vetëm ata që kanë aftësinë e një matjeje të tillë, mund ta kuptojnë këtë umet. Dhe, është e pamundur

ta kuptosh me një logjikë tjetër vuajtjen dhe vështirësinë e punës së këtij umeti.

Si umet, shohim se i Dërguari i Allahut, (a.s.), është ai që mban peshën më të madhe të kësaj barre. Nëse ne si umet bartim një peshë kaq të rëndë dhe të gjerë/përhapur, kjo peshë në fakt më parë ka qenë në supet e Profetit (a.s.). Dhe, fakti që jemi umeti i tij, do të thotë se duhet t'i vëmë supin barrës së tij.

Kur bëjmë analizën e jetës madhështore të Profetit tonë (a.s.), e kuptojmë atë me mrekuilitë e tij, si miraxhi dhe të tjera të ngjashme. Duke nxjerr në pah dallimin e tij nga profetët e



tjerë, vlerën e tij të madhe tek Allahu dhe duke përmendur fjalët e thëna në lidhje me të, përpigemi ta kuptojmë atë. Mirëpo, nëse përkrah këtyre përpigemi të meditojmë edhe në lidhje me barrën në supet e tij, do ta kuptojmë edhe më mirë atë.

Fakti që ai është “mëshirë për botët”, në të njëjtën kohë nënkupton edhe se ai bart peshën e të gjitha botëve. Të njëjtin kuptim që shpreh fjala “botë”, të njëjtin kuptim ka edhe pesha e barrës së Profetit tonë (a.s.), i cili ka ardhur si mëshirë për botët. Ky fakt, është një prej të vërtetave të mëdha që mbushin brendësinë e madhështisë së tij.

Feja Islame, është zgjidhja e fundit për njerëzimin. Me të, njerëzimi vazhdon të ketë fatin të ekzistojë si specie njerëzore. Dhe kjo, na tregon se logjika e të kuptuarit të Islamit si një fe e kufizuar me namaz dhe agjërim, është e gabuar. Pesha specifike e Islamit është shumë më e madhe. Që të konsiderohet “edukim Islam”, duhet që përmbajtja e edukimit të zgjerohet neaq tema, sa të përfshijë gjithë njerëzimin.

Pesha specifike e familjes, shoqërisë, tregtisë, e madje edhe e një udhëtimi Islam, duhet të jetë më e madhe se sa pesha që dihet në përgjithësi. Kjo do të thotë ta bashkosh udhëtimin me xhihadin. Kjo do të thotë ta shohësh familjen si qendër e xhihadt. Kjo do të thotë ta kuptosh shoqërinë si një bashkësi njerëzish të formuar nga vëllezër të mëshirshëm dhe të matur ndaj njëri-tjetrit.

Kur një i ri të përmendet si, “i ri mysliman”, peshën e tij specifike nuk duhet ta matim as me kilogramët e trupit të tij, e as me diplomat që zotëron. Pesha specifike e të riut mysliman, duhet matur me besimin në zemrën e tij. Kështu u mat rinia e sahabëve fisnikë. Në sajë të këtij botëkuptimi të matjes, ata u vunë në krye të ushtrisë në moshën e të rinjve të sotëm që pranohen si “fëmijë”. Mbi të gjitha, ata kërkuar sanxhakun që mbante në dorë Profeti (a.s.) dhe u vlerësuan me meritën për ta bartur atë. Allahu qoftë i kënaqur prej tyre! Ata i dhanë hakun në kuptimin e plotë të fjalës peshës specifike që Allahu u kishte caktuar. Dhe me atë peshë ata i

dhanë jetë pozitës në të cilën ndodheshin. Kjo, sepse ata ishin të rinjtë e umetit. Ata ekzistuan në emër të këtij umeti dhe për këtë umet. Ata ishin një apo pesë të rinj, por në vendin ku u gjendën, pesha e tyre u mat me mijëra të tjerë. Ata ishin “të rinjtë e Muhammedit (a.s.)”. Kjo ishte pesha që Allahu caktoi për ta. Dhe për shkak se qëndruan në përputhje me peshën e tyre, ata u dukën si një ushtri e madhe edhe kur ishin vetëm pak veta.

Brezat e sotëm dhe ata që kanë përgjegjësinë e edukimit të këtyre brezave, duhet ta dinë këtë. Ata duhet t'i edukojnë të rinjtë jo me peshën e letrës së diplomës, por me peshën e të qenit të rinjtë e këtij umeti. Po ashtu, edhe të rinjtë këtë duhet të kërkojnë. Në bazë të kësaj duhet rregulluar edhe shigjeta e peshores ku do të peshohemi. Të rinjtë duhet të peshohen me peshoret e rregulluara në atë mënyrë, që të bëhen të rinjtë e këtij umeti. Duke u peshuar me këtë peshore në të gjitha kohërat dhe të gjitha vendet, mund të gjejmë peshën tonë specifike. Të gjitha numrat në peshoret e tjera që tregojnë peshën tonë, janë numra që ose janë ndikuar nga forca tërheqëse e tokës, ose janë vendosur me hilen e dikujt.

Të rinjtë dhe të rejat tona, duhet të shpëtojnë nga ndikimi i forcës tërheqëse të tokës dhe duhet të peshohen në peshoret që janë nën ndikimin e xheneteve. Vetëm atëherë do të dalë në pah pesha e tyre e vërtetë. Vetëm atëherë do ta kuptojmë se kush është një hafiz Kurani i edukuar mirë. Vetëm atëherë do ta kuptojmë se si një thirrje “subhanallah”, mund të shprehet me një peshë që matet me qiejt. Vetëm atëherë mund të ndjejmë se çfarë ka gjetur dëshmori. Si mund ta peshojmë peshën tonë specifike me gjëra më të lehta se ne? Nëse ne i përdorim si peshore vlerat e kësaj bote, ndërkohë që të gjitha interesat e kësaj bote dhe e gjithë bota nuk kanë vlerë për ne as sa “një krahë mize”, numrat që do na shfaqen para syve, nuk mund të jenë numrat e peshës sonë specifike. Në këto kushte, nuk mund të kuptojmë as ato që na thotë feja jonë!

Falimentimi i njerëzimit

Ali Riza Temel

Gjatë gjithë historisë njerëzore kanë ndodhur shumë ngjarje të cilat na bëjnë të turpërohem që jemi njerëz.

Mirëpo, tablotë e turpit në botën e ditëve tona, e cila pretendon se është e "civilizuar", janë shtuar aq shumë, sa që e shkuara nuk ia vlen të përmendet fare. Në fakt, fuqia dhe mundësitë teknologjike që janë arritur, me tepër se në dobi, po përdoren në dëm të njerëzimit. Këto mundësi, në vend që të japin jetë, marrin, në vend që të ndërtojnë, shkatërrojnë.

Shpesh, përballë veprime çnjerëzore që bëjnë disa njerëz, personat e ndërgjegjshëm shprehen, "më vjen turp që jam njeri". Gjatë gjithë historisë njerëzore kanë ndodhur shumë ngjarje të cilat na bëjnë të turpërohem që jemi njerëz. Mirëpo, tablotë e turpit në botën e ditëve tona, e cila pretendon se është e "civilizuar", janë shtuar aq shumë, sa që e shkuara nuk ia vlen të përmendet fare. Në fakt, fuqia dhe mundësitë teknologjike që janë arritur, me tepër se në dobi, po përdoren në dëm të njerëzimit. Këto mundësi, në vend që të japin jetë, marrin, në vend që të ndërtojnë, shkatërrojnë.

Materializmi dhe kapitalizmi i egër, e ka kthyer njeriun në ujë për njeriun. Në ditët tona kur pangopësia dhe lakmia ka arritur kulmin, njerëzimi është burgosur në burgun e errët të egoizmit. Ndërsa filozofia "i forti



ka gjithmonë të drejtë”, e ka kthyer botën tonë në një varrezë të frikshme ku vijnë vërdallë ujçërit, çakejtë dhe hienat.

Në përkufizimin e tij të njeriut të sotëm, mendimtari i njohur Rene Guenon, shprehet: “Tashmë asgjë dhe askush nuk është në vendin ku duhet të jetë normalisht. Tashmë, njerëzit nuk njohin asnjë autoritet të vërtetë në aspektin shpirtëror dhe asnjë fuqi ligjore në aspektin material. Qarqet laike diskutojnë qetësisht të shenjtat, duke kundërshtuar cilësitë, e madje edhe ekzistencën e tyre. Kjo gjendje, do të thotë që e ulëta të gjykojë të lartën, padituria t’i vendosë pengesa diturisë, e gabuara të mbizotërojnë të saktën, njerëzorja të zërë vendin e hyjnore, toka të mposhtë qiellin, individit ta bëjë veten kriter për çdo gjë dhe që ligjet e vendosura me mendjen e tij të kufizuar e të gabueshme, t’ia imponojë me dhunë universit.” (Krizja e Botës Moderne, fq. 116.)

Bota jonë, ku tashmë mbizotëron alkooli, droga, prostitucioni, shfrytëzimi, pangopësia, terrori, gara për armatime, vrasjet masive dhe afetaria, në njëfarë kuptimi është kthyer në xhehenem. Një mendimtar perëndimor, e ka cilësuar shekullin e njëzetën si “shekulli i vrasjes”.

Allahu i Madhëruar, ia la njeriut amanet këtë botë, të pastër dhe të banueshme dhe, megjithëse Ai urdhëroi duke thënë, “mos bëni trazira në tokë!..”, në vend që të përmirësohej, njerëzimi hyri në garën e shkatërrimit. “Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve!..” (Rum, 41)

Tashmë, bota jonë e mekanizuar, në vend që të jetë një botë me qendër Zotin dhe njeriun, është kthyer në një botë me qendër mekanizimin. Civilizimi është i fokusuar në atë që është materiale dhe trupore.

Kur shpjegon për shkaqet e krizës njerëzore, Alexy Carrel thotë: “Vendi i ndërtuar me zgjuarsinë dhe zbulimet e njeriut, nuk është i përshtatshëm për

strukturën e tij. Njeriu është i huaj në këtë vend që ka ndërtuar. Përditë e më shumë, njeriu po e humbet identitetin e vet, sepse ai ka ngrënë “frutin e ndaluar” të pemës së qytetërimit. Edhe babai ynë Ademi dhe nëna jonë Hauaja janë dëbuar prej Xhenetit për shkak se kanë ngrënë prej “frutit të ndaluar”.

Poetët bëjnë të flasin edhe të pajetët në botën e imagjinatës. Mendimtari dhe poeti i madh i shekullit të shkuar, Muhammed Ikbali, bën diellin të flasë. Për të, dielli i ankohet kështu Allahut: “O Zot! Unë u mërzita duke ardhur përreth këtyre që gjoja janë njerëz për t’u dhënë dritë. Ose jepi fund detyrës sime, ose krijë njerëz të vërtetë!”

Njeriu, i cili është krijuar si “halifja/mëkëmbësi i Allahut, krijesa më fisnike, thelbi i gjithësisë dhe krijesa më e mirë” dhe të cilit i janë vënë në shërbim të gjitha mirësitë e tokës dhe të qiellit, për shkak të tiranisë dhe mosmirënjohjes së tij, është rrokullisur në gradën e “esfel-i safilin/më të poshtrit të të poshtërve”. Në këtë mënyrë, duke e tradhtuar amanetin, ai shkatërroi edhe veten, edhe botën e tij.

Shkaktari i tablosë së keqe që po përjetohet sot, është njeriu dora vet. “Eh, sa e sa fshatra e qytete i kemi zhdukur Ne, sepse banorët e tyre bënin jetë të shfrenuar!.. Ne kurrë nuk i kemi shkatërruar vendbanimet (pa shkak), por vetëm kur banorët e tyre kanë

qenë keqbërës!” (Kasas, 58-59)

Ndërsa Roger Garaudy, thekson se problemi nuk është vetëm ekonomik dhe politik. Ai mendon se problemi thelbësor është mungesa e synimit dhe besimit në Zot. Ja si e shpreh ai këtë gjendje të rëndë: “Pa itinerar në dorë, në një anije me kapiten të dehur e të çoroditur që ka humbur vetëdijen, nuk dimë se ku shkojmë!..” Një botë ku çdo gjë shihet si mall në shitje dhe të cilës i japin formë fituesit dhe humbësit, ata që hanë dhe ata që bëjnë sehir, ata që qeshin dhe ata që qajnë, shtypësit dhe të shtypurit, sigurisht që nuk mund të jetë e përhershme.

Pavarësisht gjithë këtyre gjërave negative e jo shpresëdhënëse, siç shprehet edhe vet R. Garaudy: *“Kemi ende kohë për të jetuar. Por këtë mund ta bëjmë vetëm në sajë të një kthese të madhe pas. Mjeshtërit e kaosit, duan që ne t’i bindemi një bote pa njerëz dhe devijimeve të njerëzve të cilët nuk kanë qëllime njerëzore. Mirëpo, ringjallja, ose mbijetesa e njeriut, kërkon jo përshtatje me këtë fat që të çon drejt vdekjes, por një shkëputje rrënjësore prej tij.”*

Me qëllim që të mos përplasemi sa andej këndeje përballë erërave, duhet një pengesë, një rezistencë ndaj saj. Dorëzimi ndaj tyre, do të thotë pranim i skllavërisë. Shpëtimi prej burgut, nuk bëhet duke iu lutur gardianit.

Kundër materializmit dhe kapitalizmit të egër që ka shkaktuar rrënimin e njerëzimit, ka nevojë për një revolucion të mbështetur në dashuri dhe mëshirë. Profetët janë liderët e këtij revolucioni shpirtëror. Sigurisht që kjo është e vështirë dhe kërkon një luftë të ashpër, por për të arritur një jetë dinjitoze, ka gjithmonë një çmim. Ata që pranojnë të jetojnë pa dinjitet, nuk kanë të drejtë të ankohen prej skllavërisë.

Ata që e humbin veten si fëmijë përballë lodrave të shtrenjta dhe joshëse dhe janë robërit e dëshirave e epsheve kalimtare, nuk kanë fuqi për të ndryshuar ecurinë aktuale dhe aftësitë për t’u bërë lider. Revolucionin mund ta realizojnë vetëm ata që zotërojnë vullnet të fortë dhe besim tek Zoti. Kjo, kërkon një rebelim, një kryengritje në kuadrin moral. Kjo nuk është një kryengritje me bazë raciste, medh’hebiste, nacionaliste dhe rajonale, por një kryengritje me bazë ringjalljen e vlerave njerëzore dhe morale tashmë të rrënuara e të degjeneruara.

Ky është një rebelim i ndërgjegjes, mëshirës, dashurisë dhe sakrificës kundër tiranisë, barbarisë, urrejtjes, egoizmit dhe mungesës së synimit. Ky është një rebelim i bekuar. Është lufta për të rifituar njerëzoren. Të ndjesh dhimbjen dhe hidhërimin e të gjitha gjallesave dhe përpjekja për to, është lufta më fisnike. Kjo është lufta që e shpëton njeriun nga shndërrimi në qenë që vijnë vërdallë rreth një kocke. Shpendët që ushqehen me kërma, rendin pas kufomave që janë vrarë e copëtuar. Ndërsa njerëzit e vërtetë, luftojnë për të dhënë jetë. Ata heqin dorë nga kënaqësia e të jetuarit dhe kërkojnë pasionin e dhënies jetë

të tjerëve. Në vend të thonë, edhe e jotja është e imja, ata thonë, edhe imja është e jotja. Edhe pse janë vetë nevojtarë, ata preferojnë të tjerët para vetes. Ata nuk bien në gjumë ndërkohë që fqinji i tyre është i uritur. Ata ndjejnë urinë e të uriturve dhe të ftohtin e atyre që kanë ftohtë. Ata bëhen si Mevlana, i cili thotë: *“Unë nga Shemsi Tebrizi kam mësuar të ndjej o miqtë e mi! Para se të njihja atë, unë qëndroja në krye të oxhakut i mbështjellë me gëzof, ndërkohë që të varfrit dridheshin prej të ftohtit të acartë. Qëndroja në krye të sofrës kur para derës sime kalonin të uriturit. Ndërsa tani, nuk mund të ngopem pa u ngopur të gjithë të uriturit dhe kam ftohtë edhe përballë flakëve të nxehta pa u veshur të zhveshurit. Prej tij e kam mësuar se dija është një barrë që pengon ndjenjën. Shemsi Tebrizi më mësoi të digjem, e të piqem!”*

Një dije që nuk i flet shpirtit dhe botës së ndjenjave të njeriut dhe nuk çel tek ai ndjenja njerëzore dhe morale, nuk është asgjë tjetër përveç hamallëkut. Kështu është edhe besimi falsë që nuk reflektohet në sjellje. Një besim i vërtetë, kërkon të luftosh për arritjen e qëllimeve të larta. *“E ç’dobi ka të besoni në Zot nëse nuk keni vepra? E ç’dobi ka besimi yt nëse një vëlla apo motra jote nuk ka çdo ditë për të ngrënë diçka, e ti nuk i jep asgjë nga ushqimi yt?”* (R. Garaudy, Terrori i Perëndimit, fq. 106.)

Gjallërimi i njerëzimit të falimentuar, është i mundur vetëm me anë të njerëzve të edukuar në shkollën e besimit. Dhe, modeli më i bukur, është Profeti (a.s.). Në librin e tij me titull, *“Heronjtë”*, Thomas Carlyl, e ka përmbledhur Profetin tonë (a.s.), me këto fjalë: *“Edhe ai ishte një njeri. Por ishte një njeri që kishte ardhur për të përkufizuar njerëzimin!”*

Shkrimin tonë po e përfundojmë me këto fjalë të R. Garaudy, i cili thotë: *“Unë nuk jam nga ata që thonë, «njeriu ka vdekur»! Në të vërtetë, njeriu tani nuk ekziston. A doni të punojmë që ai të ekzistojë? Të përpiqemi që të ekzistojmë? Domethënë të mos bëhemi një hallkë në zinxhirin shkak-pasojë, por përkundrazi të bëhemi njerëz që lindin çdo çast me fuqi më të mëdha dhe me qëllime më të qarta?”* (R. Garaudy, Thirrje për ata që jetojnë, fq. 29.)

VARËSIA NDAJ ALKOOLIT DHE DROGËS

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

*“Emr-i bi'l-ma'ruf vëllazëria islame na ishte,
E pengonte vëllai vëllain kur në të keqe e shihte!”¹*

Në shkrimin tonë të radhës në serinë me titull “Dëmtuesit e jetës së umetit”, do të vazhdojmë me trajtimin e temës së varësisë ndaj alkoolit dhe drogës.

Përveç personave dashakeqës dhe injorantëve, nuk bëhet fjalë që dikush tjetër të mund të ketë kundërshtime për sa i përket dëmeve të alkoolit dhe lëndëve narkotike. Më duket sikur ju dëgjoj të thoni se, për të trajtuar një temë të tillë në lidhje me të cilën gjithkush është i vetëdijshëm, duhet të ketë një arsye të rëndësishme. Të them të drejtën, më duhet të pohoj se edhe unë e ndiej një ngurrim të tillë. Mirëpo, për nga aspekti i ruajtjes së tërësisë së serisë “Dëmtuesit e jetës së umetit”, tek unë mbizotëroi më tepër mendimi i domosdoshmërisë së trajtimit të varësisë ndaj alkoolit dhe drogës.

Para së gjithash, Zoti ynë i Madhëruar e ka cilësuar alkoolin si “**vepër e ndytë e shejtanit**”², ndërsa i Dërguari i Tij (a.s.), e ka cilësuar si “**nëna e të gjitha të këqijave**”³. Fakti që alkooli të jep guxim për të bërë të këqija dhe gjynahe, ambientet që krijohen përreth alkoolit, fenomenet negative që vërehen në sektorët si ato të reklamave dhe të tregtisë etj., janë tregues të mjaftueshëm se alkooli dhe lëndët narkotike janë gjynahe shumë të mëdha dhe nëna e të gjitha të këqijave. Pra, është e qartë se të gjitha këto janë vepra të pista që dëshiron t'i nxisë shejtani.

Këto evidencime që i tejkalojnë shekujt, janë deklaratë e hapur se alkooli dhe lëndë të tjera si drogat të cilat ia marrin mendtë njeriut, janë gjithmonë në aktualitetin e jetës së umetit në aspektin e moralit dhe të marrëdhënieve njerëzore dhe gjëra me rrezik dhe dëm shumë të madh.

Përveç kësaj, edhe historiani anglez A. Toynbee, është

1. - Mehmet Akif Ersoj


2. - shih. Maide, 90.

3. - shih. Ibn Hibban, Sahih XII, 170; Darekutni, Sunen IV, 247.

shprehur se, “Qytetërimi islam, është më superior ndaj Qytetërimit Perëndimor në tre aspekte të ndryshme, që janë, ruajtja e besimit monoteist, ndalesa e racizmit/nacionalizmit dhe ndalesa e alkoolit”. Me këtë, ai e tregon umetin e Muhamedit (a.s.), si shembull për perëndimorët. Padyshim se një evidentim i tillë, është një arsye më tepër që e bën të detyrueshme trajtimin e kësaj teme nga aspekti i jetës së umetit. Kjo, sepse në ditët tona, umeti i Muhamedit (a.s.), po vuan probleme shumë të mëdha në aspektin shoqëror për shkak të nacionalizmit/racizmit dhe në aspektin moral për shkak të alkoolit dhe drogës.

Në vitet kur ende nuk kishin filluar transmetimet televizive, një ministër i Doganës, mbajti një fjalim në radion e shtetit, të cilin nuk do ta harroj kurrë. Ndër të tjera, ai tha :

ËSHTË SHUMË E QARTË SE NUK KA ASNJË RRUGË TJETËR PËRVEÇ ZBATIMIT TË KËSAJ MASE THELBËSORE QË ËSHTË MARRË NË FUSHËN E MORALIT NGA ANA E FESË SONË MADHËSHTORE PËR SIGURIMIN E NJË JETE TË SHËNDETSHME DHE TË GJALLË TË UMETIT.



“Niveli i zhvillimit të një populli, matet me përqindjen e alkoolit që ai konsumon!” Për mua, ky ishte një pohim i qartë i gjendjes së keqe në të cilën ndodheshim.

Ndërsa kohët e fundit shohim politikanë që në vend që ta përgëzojnë faktin që tashmë në mbledhjet zyrtare nuk ofrohen më pije alkoolike, ata e kundërshtojnë këtë sikur të ketë ndodhur ndonjë krim, duke e konsideruar madje në kundërshtim me filozofinë e themelimit të shtetit dhe si presion apo mungesë respekti ndaj të ftuarve.

Nga ana tjetër, vërehet se përdorimi i duhanit, alkoolit dhe drogës, të cilat janë edhe nxitëse të njëra-tjetrës, ka zbritur deri në moshën e shkollës fillore, fenomen ky që është shtuar mjaft, dhe që në aktualitetin tonë, trajtohet si një arsye e hidhur shoqërore.

Atëherë, pikësëpari le të kujtojmë ajetet fisnike që bëjnë të qartë ndalesën në lidhje me alkoolin:

“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e shejtanit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!

Vërtet, shejtani me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë? Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit! Kujdes! Nëse nuk ia vini veshin, ta dini se i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë shpalljen e qartë!” (Maide, 90-92)

MESAZHI I AJETEVE FISNIKE

Në këto ajete, shihet qartë se ndalimi i pijes alkoolike ka ardhur në mënyrë graduale, duke e bërë shoqërinë të mendojë dhe duke e edukuar atë në këtë çështje. Dhe, në fund, është dhënë vendimi i prerë i ndalesës, duke theksuar se ajo është “një vepër e ndyrë e shejtanit” dhe “një poshtërsi”. Më pas, është urdhëruar se: **“...Me pije alkoolike dhe me bixhoz, shejtani kërkon të fusë armiqësi e urrejtje midis jush dhe t’ju shmangë nga përkujtimi i Allahut dhe kryerja e namazit...”**, duke e shprehur qartë rrezikun që kanë këto për strukturën e umetit. Menjëherë pas saj, shpjegohet se ato pengojnë në kryerjen e detyrave personale dhe thelbësore ndaj Krijuesit (si përkujtimi i Allahu dhe namazi). Në këtë mënyrë, i është bërë një thirrje vetëdijes së besimtarëve edhe për dëmet individuale, edhe për dëmet shoqërore që shkaktojnë ato. Madje, në një farë kuptimi, duke u shprehur, **“...Prandaj, a po hiqni dorë?..”**, duket sikur zbatimi i kësaj ndalesë i është lënë në dorë disi edhe vetë besimtarëve. Kjo ndalesë, synon të parandalojë varësinë ndaj atyre të këqijave të përmendura dhe të veprave apo gjërave të ngjashme si varësia ndaj drogës, etj., të cilat janë një rrezik i madh për identitetin e myslimanit, shëndetin e tij trupor e shpirtëror, për dinamikën e shoqërisë/umetit dhe për lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër. Dëmi më i madh i pijeve alkoolike dhe lëndëve narkotike, është zakoni/varësia që ato krijojnë tek përdoruesit, gjë

e cila është shumë e vështirë të parandalohet qoftë edhe me përpjekje dhe shpenzime të mëdha.

Me çfarëdolloj arsyeje qoftë, nëse nuk u vihet veshi paralajmërimeve në këto ajete fisnike, e vërteta që duhet ditur, është se: **“i Dërguari ka për detyrë vetëm të përçojë shpalljen e qartë!”** Pjesa tjetër, i mbetet atyre që nuk janë të bindur. Pra, ky mbetet problemi i tyre.

HADITHET FISNIKE

Profeti (a.s.), i cili është përpjekur vazhdimisht për të ndërtuar një strukturë shoqërore të pastër prej çdolloj të keqeje dhe ndyrësie dhe për ta zbukuruar me virtyte të larta, në lidhje me çështjen e pijes alkoolike, ka shumë thënie, disa prej të cilave është me vend t'i përmendim në këtë shkrim:

Aisheja (r.anha), tregon: “I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *«Çdo pije që të deh është haram!»*” (Buhari, Eshribe 4, Udu 71)

Shprehja, *“pije që të deh”*, e përdorur në këtë hadith, ka kuptim të përgjithshëm, gjë që do të thotë se përfshin edhe çdo lloj lënde narkotike.

Xhabir bin Abdullah (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Ajo që të deh me të shumtën e saj, është haram edhe e pakta e saj!”* (Ebu Daud: 3681, Tirmidhi: 1927, Ibni Maxhe: 3393.)

Rreziku që ka pija alkoolike për shoqërinë/umetin, është shprehur shumë qartë me këto pak fjalë:

“Pija alkoolike është nëna e të gjitha të këqijave.” (Ibn Hibban, Sahih, XII, 170; Darekutni, Sunen IV, 247.)

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet se Osmani (r.a.), ka thënë:

“Ruhuni prej pijes alkoolike, sepse ajo është nëna e të gjitha të këqijave!” (Nesai, Eshribe, 44.)

Në një transmetim tjetër, kjo shprehje është shpjeguar me këto fjalë:

“Qëndroni larg pijes alkoolike, sepse ajo është çelësi i çdo të keqeje!” (Ibn Maxhe, fiten 23; Bejhaki, Shuabu'l-iman V, 10, 11; Hakim, Mustedrek, IV, 162.)

Fakti që në kohën tonë pijet alkoolike janë emërtuar me emra të ndryshëm si, birra, alkool, raki, vodkë, shampanjë etj., nuk e ndryshon vendimin për ndalesën e tyre për sa kohë që ato shkaktojnë dehje. Lidhur me këtë, na ka tërhequr vëmendjen edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ka thënë:

“Disa njerëz prej umetit tim, do të pinë alkool dhe do ta emërtojnë atë me emra të ndryshëm!” (Ahmed b. Hanbel, Musned IV, 237; Bejhaki, es-Sunenu'l-kubra, VIII, 512, 513.)

Shprehja *“të pish”* e cila përdoret në këto hadithet fisnike, padyshim që përfshin edhe lëndët narkotike që merren në mënyra të ndryshme dhe të cilat bëhen shkak i humbjes së funksioneve normale mendore, qoftë edhe për një kohë të shkurtër.

Është shumë e qartë se nuk ka asnjë rrugë tjetër përveç zbatimit të kësaj mase thelbësore që është marrë në fushën e moralit nga ana e fesë sonë madhështore për sigurimin e një jete të shëndetshme dhe të gjallë të umetit. Kjo duhet të bjerë në vesh të çdo kryetari shteti të vendeve islame!

QYTETËRIMI I URAVE

Dr. Ardian Muhaj

Studimi krahasues në aspektin diakronik përbën një qasje themelore për të kuptuar prirjet e zhvillimeve historike. Tradicionalisht urat e vjetra, të cilat edhe në rast se mbijetojnë janë praktikisht jofunksionale, janë vlerësuar vetëm nga pikëpamja arkitektonike dhe jo nga domethënia dhe vlera e tyre për historinë ekonomike. Një nga treguesit më të njohur që hedh dritë mbi dinamikën e zhvillimeve ekonomike është shkalla e investimeve publike, veçanërisht në infrastrukturën e transportit.¹ Shtimi apo pakësimi i këtyre investimeve është parë përkatësisht si përshpejtim apo ngadalësim i zhvillimit ekonomik. Në këtë kuadër, një nga investimet thelbësore të infrastrukturës së transportit janë urat.

Evidentimi i saktë i vendndodhjes gjeografike të këtyre urave, shërben gjithashtu si një e dhënë e rëndësishme për të skicuar rrugët e komunikimit tregtar ndërmjet krahinave të ndryshme. Jo vetëm numri i urave të ndërtuara, por edhe madhësia dhe përmasat e tyre, teknikat e ndërtimit dhe cilësia e materialeve të përdorura, janë tregues të rëndësi-

shëm të cilët nuk mund të mos përfillen në kuadrin e vlerësimit të rëndësisë së tyre ekonomike. Territorët shqiptarë duke qenë përgjithësisht malorë me përrunj e lumenj të shumtë ruajnë një numër relativisht të lartë urash të vjetra duke u paraqitur si një nga trevat ballkanike që ruan ndërtime të kësaj gjinie më të shumta në raport me sipërfaqen që ka.

Krahasimi ndërmjet dinamikës së ndërtimit të urave gjatë periudhës osmane dhe asaj paraosmane në trevat shqiptare nxjerr në pah se për territorin e Republikës së Shqipërisë, nga periudhat historike të mesjetës së hershme dhe të mesme nuk ka mjaft gjurmë urash. Deri në fazën e tanishme të gjurmëve mund të thuhet se e vetmja urë e ruajtur nga periudha mesjetare paraosmane ende në këmbë dhe në funksion është ura mbi përroin e Grykës në Blinisht.² Pra, fakti është se më shumë ura janë ruajtur apo janë ndërtuar gjatë periudhës antike se sa gjatë mesjetës paraosmane dhe nga ana tjetër akoma edhe më shumë ura janë ndërtuar gjatë periudhës osmane. Në krahasimin mes mesjetës paraosmane dhe periudhës osmane periudha e parë ka një shtrirje prej një mijëvjeçari, pra nga shekulli V deri në sheku-

1. Henry Kraus, *Gold Was the Mortar: The Economics of Cathedral Building*. London, Boston: Routledge and Kegan Paul, 1979. "even the the building of great Gothic cathedrals was dominated by the availability of money" D. Jaggar, R R Morton, *Design and the Economics of Building*, Taylor & Francis, 2003, f. 354.

2. Kjo është e vetmja urë e ruajtur në vendin tonë nga periudha arkitekturës romanike. Valter Shtylla, *Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri*, Tiranë: Toena, 1997, f. 68-69.



llin e XV, ndërsa e dyta është shumë më e shkurtër, vetëm nga shekulli XVI deri në shekullin XIX, pra po krahasojmë 10 shekuj me 3 shekuj. Megjithatë, rezultatet e periudhës osmane më të shkurtër janë shumëfish më të mëdha.

Nga 84 ura të vjetra që janë në mbrojtje shtetërore në Republikën e Shqipërisë, 72 janë të periudhës osmane ndërmjet shekujve XVI-XIX, dhe vetëm 12 ura edhe ato në gjendje rrënojë trashëgohe nga antikiteti dhe mesjeta. Pra antikiteti ka 11 ura të mbrojtura me ligj, mesjeta 1 urë dhe periudha osmane 72 ura. Tek periudha osmane numri mund të shkonte edhe më tej po të përfshiheshin edhe ura të cilat janë të dëshmuara historikisht, por që nuk e gëzojnë statusin e mbrojtjes për shkak se nuk ekzistojnë më si të tilla. Këtu mund të përmendnim urën madhështore të Bahçallëkut në Shkodër, urën po aq madhështore të Vezirit në Kukës etj.

Në aspektin e gjeografisë politike mund të themi se mesjeta në tokat shqiptare favorizonte më tepër ndërtimin e barrierave se sa të urave. Në një dokument të vitit 1426 gjejmë kufizimin mes qytetit të Shkodrës që ndodhej nën sundimin venedikas dhe atij të Drishtit, nën sundimin serb. Ky kufi fillonte prej bregut të liqenit të Shkodrës e vazhdonte duke prerë rrugën që lidhte Shkodrën me Koplikun, dhe aty ku më vonë do ndërtohej ura madhështore e Mesit, nga Mehmet Pashë Plaku, në shekullin e XV ishte kufiri ndërmjet venedikasve e serbëve.³ Po të kemi parasysh se këto dy qytete ndodheshin më pak se 10 km nga njëri-tjetri, dhe se kufiri politik që i ndante

ishte vetëm disa km nga Shkodra, mund të kuptohet fare qartë funksioni pengues i këtyre kufijve në aspektin e marrëdhënieve tregtare.

Copëtimi i theksuar politik, paqëndrueshmëria institucionale, pushtimet e shpeshta nuk ishin kushte favorizuese për ndërtimin e rrugëve dhe urave. Ndërtimi dhe më pas mirëmbajtja e një rruge apo ure, pikësëpari ishte shprehje e një vullneti politik. Në se mungonte vullneti politik për të lehtësuar komunikimin, dhe përkundrazi ekzistonte një prirje për të krijuar sa më shumë barrierë atëherë do të investohej më shumë në mbrojtje se sa në komunikim, më tepër në forcimin e kështjellave dhe sigurinë e kufijve se sa në ndërtimin e urave dhe rrugëve të komunikimit.

Këto të dhëna pikësëpari dëshmojnë tendencën e zgjerimit të gjeografisë së rrjetit tregtar dhe gjithashtu edhe forcimin e marrëdhënieve tregtare brendashqiptare dhe po ashtu ndërballkanike gjatë periudhës osmane. Dëshmojnë po ashtu forcimin e rolit të qyteteve si qendra të prodhimit zejtar dhe të këmbimeve tregtare. Gjatë shekullit XVI u forcuan mjaft marrëdhëniet tregtare ndërballkanike. Në portet e Lezhës, Shkodrës, Vlorës e Durrësit punonin gjithnjë e më tepër tregtarë vendas e të huaj, që sillnin nga perëndimi mallra për t'i tregtuar në zonat dhe tregjet e ndryshme të Ballkanit (Sofje, Selanik, Stamboll).⁴

Në këta shekuj vërehet një gjallërim ekonomik i dukshëm, nëpërmjet atij procesi të cilin Alain Ducellier e quan "rigjetja e funksionit të tranzitit të tokave shqiptare në tregtinë mes Adriatikut dhe brendësisë së Ballkanit".⁵ Ky autor mbas studimit të hollësi-

3. «Et primo dechiaremo i confini de Scutari a drivasto comenzando del lago dreto per lo bosco al alboro clamado el pobo grande, e cussi avanti per lo fosso,... in fine ala piera in lo pian e de la piera in fin altra piera che se va in la via grande che viem da Scutari a Copenicho». Acta Albania Veneta, saeculorum XIV et XV, Josephi Valentini S. J. Labore, reperta et transcripta ac typis mandata. Pars secunda. Saeculi praescanderbegianam periodum complectens, Tomus duodecimus, München-Roma 1971, dok. 3075.

4. Zija Shkodra, *Esnafet Shqiptare (shek. XV-XX)*, Tiranë, 1973, f. 39.

5. Ide e argumentuar nga ky autor në një varg punimesh. Alain Ducellier, *Genesis and Failure of the Albanian State in the Fourteenth and Fifteenth*



shëm të dokumentacionit të kohës, veçanërisht të dokumenteve raguzase dhe venedikase, thekson se ky proces është dëshmi e një rikthimi në atë traditë që përbënte çelësin e suksesit ekonomik të Ilirisë së lashtë.

Në fakt, periudha më intensive e ndërtimit të urave monumentale prej guri në trojet shqiptare, është ajo e lulëzimit të pashallëqeve autonome shqiptare. Pikërisht në këtë periudhë kur prodhimi vendas, si ai zejtar ashtu edhe ai bujqësor, arrin kulmin e zhvillimit për periudhën osmane, merr hov si asnjëherë më parë edhe tregtia. Investimi ekonomik i autoriteteve autonome shqiptare në ndërtimin e përshpejtuar të urave, kishte si funksion pikësëpari krijimin e lehtësive të domosdoshme të komunikimit mes qendrave kryesore tregtare ndërshtetërore. Vezirët autonomë të Shkodrës ndërtuan urat madhështore të Bahçallëkut dhe të Mesit mbi lumin Kir, të Kukësit, mbi lumin Drin, të Podgoricës, të Tamarës në Kelmend etj., Ahmed Kurd Pasha i Beratit financoi ndërtimin e urës së Velabishtit e të Goricës në Berat, të Çukasis në Kuç, të Mollasit mbi lumin Devoll në Gostimë, urën e Vokopolës etj. Ali Pasha i Janinës, ndërtoi urat e Zagori-Pogonit e të Rrëzomës në Delvinë, si dhe riparoj urën mbi Vjosë në Tepelenë.⁶

Shtimi i popullsisë qytetare dhe rritja demografike e qyteteve, shoqërohet me ndryshime sociale dhe arkitekturore.⁷ Për prodhimin zejtar, shekulli XVII shënon fillimin e një periudhe të re zhvillimi me

rritje që vazhdon pandërprerë gjatë shekullit XVIII, me zgjerimin e tregut të brendshëm dhe me lulëzimin e zejeve. Në qytete, numri i zejeve u shtua në mënyrë të ndjeshme, duke arritur deri në 60 lloje. Në vitet 30-40 të shekullit XVIII, pazari i Shkodrës i vendosur ndërmjet kalasë dhe liqenit përmbante rreth 1000 dyqane.⁸ Nga gjysma e dytë e shekullit XVII tregtarët shqiptarë vizitojnë rregullisht panairët e Plovdivit, Xham-Pazarit, Nevrokopit, Dohanit, Serezit e Mavronorosit, duke shkuar deri në Itali.⁹

Një aspekt tjetër për t'u vënë në dukje, është fakti se jo vetëm investimi financiar i këtyre urave madhështore kishte zanafillë vendase, por edhe realizimi arkitektonik dhe ndërtimor i tyre mbante vulën shqiptare, me projektues dhe ndërtues shqiptarë. Gjatë shekujve XVI-XVII janë të njohur arkitektët Sinani dhe Kasemi me origjinë shqiptare, kryearkitektët të perandorisë osmane. Mimar Kasemi, kryearkiteti i perandorisë në gjysmën e parë të shek. XVII, ka kryer shumë punime në Shqipëri. Veç tjerave ai mirëmbante rrugët Berat-Korçë dhe Berat-Elbasan-Ohër me të gjitha ndërtimet gjatë tyre. Po ashtu, ai ndërtoi urën e Kasabashit mbi lumin e Çorovodës në Skrapar.¹⁰ Vetëm fakti që gjatë kësaj periudhe u ndërtuan dhjetëra ura me gjatësi mbi njëqind metra, nuk lë vend për dyshime se trevat shqiptare deri në shekullin XIX kishin një zhvillim ekonomik-social të tillë që nuk qëndronte aspak në nivel inferior jo vetëm në krahasim me trevat e tjera të perandorisë osmane, por as me ato të Europës Perëndimore.

Century, në *Studies on Kosova*, bot. Arshi Pipa & Sami Repishti. East European Monographs CLV, Boulder, Colorado, ff. 3-22, ku thekson "after 1460, western merchants, especially the Ragusans, rediscovers the virtues of a unified state in the Balkans."

6. V. Shtylla, *Rrugët dhe urat e vjetra*, f. 205.

7. Emin Riza, *Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë (Shek. XV-mesi i dheq. XIX)*, Akademia e Shkencave të RPSSH, Tiranë 1991, f. 94.

8. Stavri N. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatlinjve*, Tiranë 1964, f. 43.

9. Shkodra, *Esnafet Shqiptare (shek. XV-XX)*, f. 80.

10. Shtylla, *Rrugët dhe urat e vjetra*, f. 205.



PAJTIMI NDËRMJET BESIMTARËVE

M. Sami Ramazanollu

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni.” (Huxhurat, 10)

Pra, për shkak se besimtarët janë të gjithë të mbledhur nën flamurin e teuhidit, ata janë si vëllezër të lindur prej një nëne dhe një babai. Prandaj, nëse midis vëllezërve shfaqen grindje dhe debate, atëherë pajtojini ata.

“...Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas (pranimit të) besimit!..” (Huxhurat, 11) Nisur nga kjo, nëse dikush e shan ose i thërret vëllait të vet me një emër të papëlqyeshëm, ai duhet të nxitojë të bëjë teube, të pendohet tek Allahu.

Pra, o besimtarë, nëse bëni gabim dhe shani njëri-tjetrin me fjalë të këqija, është njësoj sikur keni sharë veten tuaj, sepse besimtarët janë si një person i vetëm në vëllazërinë islame. Për rrjedhojë, nëse një besimtar shahet ose përçmohet me diçka, është njësoj sikur janë sharë dhe përçmuar të gjithë besimtarët.

Shkaku i zbritjes së ajetit fisnik në lidhje me përgojimin, ishin përgojimet ndaj Selman Farisiut (r.a.):

Në disa udhëtime, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e caktonte Selman Farisiun (r.a.), si ndihmës të dy personave që përgatitnin ushqimin. Njëherë, Selman Farisiun (r.a.), e kishte marrë gjumi dhe nuk e kishte përgatitur ushqimin. Dy personat e dërguan Selman Farisiun (r.a.), te Profeti (a.s.), që të merrte ndonjë ushqim që mund të kishte tepruar. Selman Farisiu (r.a.), shkoi tek Usame bin Zejdi (r.a.), i cili përgatiste ushqimin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Kur Usame bin Zejdi (r.a.), i tha se nuk kishte ngelur më ushqim, Selman Farisiu (r.a.), u kthye dhe u tha

se nuk kishte ngelur më asgjë për të ngrënë.

Më pas, këta dy persona filluan ta përgojonin Selman Farisiun (r.a.), duke thënë: “Edhe nëse e çon në një pus me ujë, kthehet pa ujë!”. Madje thanë edhe se, gjoja i Dërguari i Allahut, (a.s.), paska pasur ushqim, por Usame bin Zejdit (r.a.), nuk i paska dhënë.

Kur këta dy persona erdhën para të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ai tha:

“Ç’po ndodh me mua, që po shoh copa mishi jeshile në gojën tuaj!?” Ata thanë:

“Ne nuk kemi ngrënë mish o i Dërguar i Allahut!” Mirëpo, Profeti u tha:

“Keni përgojuar Selmanin. Nëse një besimtar përgojon vëllain e tij, është njësoj sikur t’ia ketë ngrënë mishin!”

Ja pra, sipas Haizit dhe Bejdaviut, pas kësaj ngjarjeje u zbrit edhe ai ajet fisnik.

Njëherë, Ebu Dherri (r.a.), i foli rëndë Bilal Habeshiut (r.a.), duke e thirrur: “O biri i gruas së zezë!” Menjëherë pas kësaj, Bilali (r.a.), u ankua tek i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili tha:

“O Eba Dherri! A po e shan për shkak të nënës së tij? Domethënë, ti paske ende prej moralit të injorancës brenda teje” Më pas vazhdoi e tha:

“Ka nga ata vëllezër që janë nën urdhrat tuaja, të cilët Allahu i Madhëruar ua ka besuar juve!” (Buhari) Pra, Profeti (a.s.), ka urdhëruar që edhe pse janë ende robër, me ta duhet të silleni si vëllezër!

Më pas, për t’i fituar përsëri zemrën Bilal Habeshiut (r.a.), Ebu Dherri (r.a.), e vendosi faqen në tokë dhe tha: “Nuk do të ngrihem nga këtu derisa Bilali të më shkelë me këmbën e vet në fytyrë!”

Ja pra, në këtë hadith fisnik, ka shumë këshilla mësimdhënëse për ne, umetin e Muhammedit (a.s.).

Urdhri i parë

Idris Arpat

Lexo miku im! Ti e di që urdhri i parë i Zotit tonë të Madhëruar është **“Lexo!”**. **“Lexo me emrin e Zotit tënd!”** Synimi i përpjekjeve të tua për të lexuar, kuptuar, nxënë dhe mësuar le të jetë “kënaqësia e Allahut”. Lexo për hir të Sunduesit të tokës dhe të qiejve! Lexo për të parë madhështinë e Tij dhe për të shtuar çdo ditë e më shumë “botëkuptimin e së bukurës”! Lexo për të përparuar në fushën e mahnitjes dhe admirimit!

Çdo krijesë është një “gisht tregues” që tregon Allahun. Tregon Fuqinë hyjnore!

Pa lexuar dhe pa kuptuar do të bëhen këto punë?

Si do të arrish mënyrën e të jetuarit si mysliman, pa njohur njerëzillëkun, pa njohur myslimanizmin, pa kuptuar ç’është adhurimi, ç’është devotshmëria, ç’është sexhdja?.. Nëse këto punë do të funksionin pa

lexuar, pa menduar, pa dhënë mundin dhe zemrën, a do të thoshte Zoti ynë që në shpalljen e parë, **“Lexo, lexo!”**? A do të fliste për letrën dhe lapsin?

Nisur nga fakti që urdhri i parë është **“Lexo!”**, unë mendoj se, në Ditën e Gjykimit, pyetja e parë do të jetë, **“a lexove?”**.

Nëse je i privuar prej virtyteve të leximit, mendimit dhe ndjenjës, si do ta kuptosh misionin tënd kryesor? Koha kur jetoje me punë dore kaloi. Koha që ka ardhur, është ajo e njeriut me finesë. Për të kaluar prej trungut në njeri, duhet të gdhendesh, të hollohesh dhe të vlesh për diçka. Rruga e atyre që jetojnë si trungje, kalon prej zjarrit. Nëse nuk je bërë dot as bisht për sëpatë, bëhesh sëpatë në krye të bishtit për të thyer e shkatërruar gjithçka...

Lexo të shohësh! Allahu krijon vazhdimisht. Allahu që krijon vazhdimisht, ka robër që prodhojnë vazhdimisht. Përderisa Allahu, i Cili është Zot dhe i panevojshëm për asgjë, punon (krijon), sigurisht që edhe robit të Tij i takon të punojë.

Filloje leximin nga librat për nivelin tënd. Ti e di që shkallët ngjiten një nga një. Mos i hyr punëve që të tejkalojnë, mos hyr nën barrën që s’e bart dot... s’ka ç’të duhen çështjet e thella të filozofisë. Njihi edhe kufijtë edhe masën tënde! Librin tonë të shenjtë fillo dhe lexoje prej historisë së Jusufit (a.s.), prej përpjekjeve të Ibrahimit (a.s.) dhe Musait (a.s.).

Ajo që dua të them, është se, mos e përjeto tensionin “lexoj, lexoj, por nuk kuptoj”! Dihet se “çdo moshë ka një punë, e çdo punë ka një moshë”. Planifikimi i kohës dhe i jetës është shumë i rëndësishëm.

Dua të të kujtoj se, si do të veprosh “Ditën e Llogarisë”, kur Allahu i Madhëruar të zemërohet e të të flasë ashpër duke thënë: “të gjithëve ua ke lexuar librat, po Librin Tim përse nuk e ke lexuar”? A mos do të thuash: “Nuk e ndjeva të nevojshme ta lexoja Librin Tënd dhe as që nuk më interesonte se çfarë kishe thënë në të”?

Krijuesi ta jep në dorë

hartën e udhës, me qëllim që të mos përplasesh sa andej këndeje në këtë botë me furtuna të shumta dhe të mos kthehesh në një përrua që zhytet drejt shkretëtirave përvëluese. Por, nëse ti nuk e hap këtë hartë dhe nuk sheh në të, askush nuk ka për ta interpretuar mirë këtë ëndërr. Nesër, askush nuk do të të vijë në ndihmë!

Lexo! Prej grimcës deri në trupin më të madh, prej zeros deri në pafundësi.

Lexo me radhë, hap pas hapi!

Të uroj shumë durim!

* * *

Zoti ynë i Madhëruar pyet:

“A janë njësoj ata që dinë me ata që nuk dinë?”

Dija është lënda e parë e mendimit. Kur njerëzit mendohen dhe marrin vendime, përdorin ato që dinë. Nëse është e nevojshme të japim një shembull, mund të themi se, për të bërë ëmbëlsirë, përdorim vaj, miell dhe sheqer, të cilat janë “dija”. Ai që dëshiron të arrijë një rezultat të qëlluar, është kuzhinieri që realizon procesin e bërjes së ëmbëlsirës. Ëmbëlsira që del nga ky proces, është vendimi dhe gjykimi i qëlluar. Nëse nuk kemi vaj, miell dhe sheqer, jo vetëm që nuk mund ta bëjmë ëmbëlsirën, por nëse këto përbërës janë të prishur, atëherë s’mund ta bëjmë atë ëmbëlsirë që duam. Për këtë arsye, nuk duhet ta anashkalojmë radhitjen, “dije e saktë, mendim i saktë, vendim i saktë, jetë e saktë”.

Kushti i parë për të bërë një jetë të saktë, është dija e saktë. Për këtë arsye edhe shpallja e parë ka qenë me përmbajtje “leximi-shkrimi”.

Kur thuhet, të mësosh, të dish, para nesh hapet një fushë e pakufishme, pa anë e pa fund. Një fushë që prej mikros deri në makro...

“A është i njëjtë ai që di me atë që nuk di?”

A është i njëjtë ai që e di qëllimin e krijimit me atë që nuk e di?

A është i njëjtë ai që di se ç’është njerëzillëku, ç’është myslimanizmi me atë që nuk e di?

A është i njëjtë ai që di se ç’është materia-shpirti, mali-guri, krimbi-zogu, detajet e gjithësisë e të botës, strukturën e brendshme e të jashtme, pafundësinë e pakufishmërinë, me atë që nuk i di këto?

A është i njëjtë ai që di të punojë e të fitojë, me atë që nuk di?

A është i njëjtë ai që e di metodën e të qenit mëshirë për botët, me atë që nuk e di?

Ndryshe është ta shohësh një pemë vetëm si dru apo dërrasë, e ndryshe është ta shohësh si një fabrikë oksigjeni. (Oksigjeni pastron gjakun tonë. Falënderimi i takon Allahut që ka krijuar një lidhje midis gjethes jashtë dhe gjakut brenda në damarë.)

Sikur ta dinim kuptimin ndërmjet “ardhjes në këtë botë” dhe “ikjes prej kësaj bote”!

Sikur të merrnim në dorë shkaqet e tragjedisë që po përjetohet prej shekujsh në botën Islame!

Kurban i cilës neglizhencë janë trupat e pajetë të fëmijëve që dalin në brigje, apo fëmijët që përpiqen të fshijnë gjakun në tëmtha me duart e tyre me pluhur e dhe?

A e kemi lodhur ndonjëherë trurin për të kuptuar ajetet: **“Ue len terda anke’l jehudu.../hebrenjtë nuk do të kënaqen kurrë me ty...”**? Ne nuk jemi munduar ta kuptojmë fjalën e Allahut: **“Ue alleme ademe’l-esma’e.../dhe i mësoi Ademit emrat!”**!

Ky indiferentizëm na e kërrus belin!

Nuk jemi në pozitën e ankesës dhe qarjes, por në botën e sprovave. Mundësitë që zotërojmë nuk janë për t’u lavdëruar, por për t’u sprovuar.

* * *

Dija e parë që duhet të marrim, është dija e Kuranit. Prej këtui duhet filluar, sepse në shtëpi nuk hyhet prej dritareve, por prej derës. Kurani është një libër që nuk pranon dyshime. Ato që thuhet dhe tregohen aty, janë të drejta dhe të vërteta. T’i dalësh zot të drejtës dhe të vërtetës dhe të jetosh sipas tyre, i jep vlerë njeriut, sepse vlera e njeriut vjen prej së drejtës dhe të vërtetës.

“Ndër robërit e Allahut, ata që ia kanë më tepër frikën janë të diturit.” (Fatir, 28) Ata që zotërojnë dijen e saktë në lidhje me Librin, njeriun dhe gjithësinë, e gjejnë veten në mes të botës së mrekullive. Dhe kjo, lind ndjenjën e frikë-respektit të thellë ndaj Krijuesit të Madhërishëm, gjë e cila sjell me vete një jetë me në qendër Allahun. **“Një jetë me në qendër Allahun, do të thotë që njeriu të jetojë në përputhje me natyrën e vet.”**

Dituria ka fillim, por nuk ka fund. Biri i njeriut, do të vazhdojë të mësojë gjëra të reja deri në fundin e kësaj bote. Nëse shtatë dete bëhen bojë, e të gjitha pemët bëhen lapsa, të gjitha këto do të përfundojnë, por misteret e gjithësisë nuk do të marrin fund. Për rrjedhojë, si në të nëntat, ashtu edhe në të nëntëdhjetenëntat, njeriu duhet të vazhdojë të thotë: **“O Zot më shto diturinë!”**

Dituria është një oqean. Ndërsa ne jemi fëmijë që luajmë në brigjet e tij. Herë pas here dallgët nxjerrin ndonjë gjë në breg, me të cilët ne gëzohemi. Por ne nuk e dimë aspak se çfarë fsheh ky oqean.

Mbi çdo të ditur ka një që di edhe më shumë. Ndërsa ai që di çdo gjë, është Allahu i Madhëruar. Pra, eja miku im! Eja të mësojmë dituri me një ndjenjë të thellë respekti!.. Të shohim çdo të na tregojë, “Alimun Habir/i Gjithëdijshmi, i Gjithëinformuari”!..



Thellësia E MEDITIMIT NË BESIM

Në Kuranin Fisnik, gjenden shumë ajete që na kujtojnë meditimin dhe përkujtimin.¹ Mes këtyre ajeteve po i hedhim një sy sures Al-i Imran, në të cilën urdhërohet:

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) «O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit. O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për mohuesit nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi. O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonë në besim: “Besoni Zotin tuaj!” Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët! O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!” (Al-i Imran, 190-194)


Në këto ajete fisnike, krijimi i qiejve dhe i tokës, i natës dhe i ditës, e thënë ndryshe, prova e fuqisë hyjnore në hapësirë dhe në kohë, i ofrohen për meditimin mendjeve të shëndosha. Pas kësaj, kërkohet të bëhet përpjekje për arritjen e dijes së vërtetë të ekzistencës. Këtu bëhet e qartë se ata që arrijnë ta bëjnë këtë, mund të ndjekin gjurmët e fuqisë hyjnore

tek krijesat, në atë masë që ata arrijnë të thellohen në meditimin. Po ashtu, tregohet se gjatë soditjes së manifestimit të artit hyjnor, është i nevojshëm falënderimi i Allahut, me një madhërim të përsëritshëm. Mirëpo, argumentet për të cilat bëhet fjalë këtu, nuk janë për të gjithë njerëzit me mendje të shëndoshë. Këtu theksohet se ato janë shkak për zgjimin e njerëzve që kanë cilësinë, “ulu’l-el-bab”, që do të thotë, “njerëzit me mendje të shëndoshë dhe të pastër”.

Lidhur me këtë, në suren Bekare, urdhërohet: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.”** (Bekare, 164)

Në këtë ajet fisnik janë numëruar tetë argumente për vërtetimin e njëshmërisë së Zotit, të cilat u drejtohen njerëzve me mendje të shëndoshë. Ndërsa në ajete që kanë të bëjnë me temën tonë, në cilësinë e argumenteve janë përmendur krijimi i qiejve dhe i tokës, bashkë me rrotullimin e natës dhe të ditës. Kjo, sepse ndërkohë që në ajetin e sures Bekare flitet për njëshmërinë e Zotit, aty bëhet fjalë për fillimin e njohjes së Allahut. Ndërsa këtu, duhet folur për “përparimin” në njohjen e Zotit. Për rrjedhojë, Fahreddin Razi (Allahu e mëshiroftë), ka thënë: **“Për udhëtarin e rrugës së Allahut, në fillim duhen shtuar**

1. - Bekare, 2/219; 266; En'am, 6/50; A'raf, 7/176; 57; Junus, 10/16.



argumentet që vërtetojnë njëshmërinë e Allahut. Mirëpo, pasi zemra të ndriçohet njëherë me dritën e njohjes së Zotit, është e panevojshme të merresh me këto argumente. Madje, kjo mund të bëhet një perde për atë njeri dhe mund ta pengojë përparimin e tij në rrugën e njohjes së Zotit.”²

Siç theksohet edhe në komentimin e ajetit, njerëzit në cilësinë “ulu’l-el-bab”, e përmendin vazhdimisht Allahun kur janë në këmbë, ulur ose shtrirë, pra në të tria pozicionet që mund të gjendet njeriu. Vazhdimësia e tyre në përmendjen e Allahut, përfshin gjendjen e ngritjes, e qëndrimit në nivelin e mesëm dhe të rënies poshtë. Ndryshimet me të cilat përballlet në jetë, si zemërimi dhe gëzimi, kamja dhe skamja, lodhja dhe rehatia, etj., nuk i pengon ata në vazhdimin e përmendjes së Allahut. Përveç gjendjes së gjumit, të fikëtisë dhe të vdekjes, ata vazhdojnë ta përmendin Allahun, qoftë me gjuhë, qoftë me gjendje. Edhe nëse duart e tyre janë të angazhuara me punë dhe gjuhët e tyre janë duke folur, zemrat e tyre janë vazhdimisht me Allahun. Njerëzit me mendje të shëndoshë dhe të pastër, në çdo gjendje dhe situatë, janë të angazhuar me dashurinë ndaj Allahut. Për këtë arsye, ata janë gjithmonë me Të edhe me zemër. Duke qenë se janë të vetëdijshëm se çdo krijesë është krijuar me një urtësi, ata strehohen tek Allahu nga frika se mos e përdorin ndonjë prej atyre krijesave jashtë urtësisë së krijimit të vet. Gjuha e tyre është gjithmonë e njomë me lutje dhe përgjërime.

Abdullah b. Omer (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), një natë kishte qarë aq

shumë sa kishte lagur me lot edhe sexhaden e tij, duke lexuar Kuran me meditim të thellë. Kur Bilali (r.a.), erdhi për ta thirrur në namazin e sabahut dhe e pa në atë gjendje, i tha: “O i Dërguar i Allahut! A po qani edhe pse Allahu ju ka falur të gjitha gjynahet e shkuara dhe të ardhshme?” Kur dëgjoi këto fjalë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: “A mos të bëhem një rob falënderues?” Dhe pasi lajmëroi zbritjen e ajeteve që po trajtojmë këtu, tha: “Mjerë ai që i lexon këto dhe nuk mendon!” (Buhari, Tefsiru Sure, 48.)

Ky paralajmërim i Profetit (a.s.) dhe ajetet e temës sonë, tregojnë se besimtarët e përsosur janë udhëtarët e një rrugëtimi dashurie që të çon prej krijesës, tek Krijuesi. Po ashtu, kuptojmë se besimtarët mund të kërkojnë faljen e Allahut në sajë të besimit dhe bindjes ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Më pas, besimtari duhet ta shpenzojë energjinë e tij në këtë drejtim, duke jetuar si një rob me të cilin kënaqet Allahu, duke qëndruar me robërit e mirë dhe duke u lutur që në botën tjetër të ringjallet së bashku me ta. Besimi, i cili është fati më i madh i robit, kërkon që ai ta përdorë në atë rrugë edhe mendjen, e cila është mirësia më e madhe e tij.



PËRMBLEDHJA E MORALIT ISLAM

Në suren Nisa, urdhërohet: “**Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë) dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj. Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë.**” (Nisa, 36)

Mund të themi se në këtë ajet fisnik, na jepet misioni kryesor i njeriut në gjithësi, ose përmbledhja e moralit Islam. Sepse kjo është ajo që kërkon devotshmëria ndaj Allahut. Pra, të çosh në vend përgjegjësitë që përmenden në këtë ajet. Një person i cili hyn diku dhe e di se aty ka rregulla, duke e pranuar këtë si të mirëqenë, nuk duhet të harrojë se, edhe Allahu i Madhëruar, i Cili e krijoi, e dërgoi në këtë botë dhe e furnizoi me të mira, kërkon prej tij që ai të adhurojë vetëm Atë dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim. Pas kësaj, kërkohet sjellja me mirësi ndaj prindërve, të afërmeve, jetimëve, skamnorrëve, fqinjëve të afërt e të largët, miqve të afërt, udhëtarëve dhe personave që në përgjegjësinë tonë. Në fakt, këto janë detyrat themelore me të cilat Allahu i Madhëruar e ka ngarkuar njeriun me anë të çdo shpalljeje që ka zbritur. Pas këtyre detyrave, njeriu mund dhe duhet ta zgjerojë fushën e përgjegjësisë të veta sa të ketë mundësi.

Sigurisht që myslimani duhet të sillet mirë me të gjithë dhe me çdo gjë, sepse kjo është një domosdoshmëri e besimit të përsosur. Nisur nga kjo, ata që nuk kujdesen për personat që përmenden në ajet -edhe sikur t'i kryejnë të gjitha detyrat e tyre personale-, ata nuk mund të jenë robër të pranuar tek Allahu, sepse nëse nuk kujdesen për të drejtat e robërve, atëherë do të bëjnë të kundërtën e mirësisë, që është “e keqja”, duke u sjellë me vrazhdësi, duke bërë padrejtësi e koprraci dhe duke i dëmtuar njerëzit.

2. - shih. Hamdi Yazır, Hak Dini Kur'an Dili, c. 2, s. 1257.

Sahabi që mori pjesë në dy Akabetë

MUADH IBN HARITH

R A D I J A L L A H U A N H

Mustafa Erish

Muadh ibn Harithi (r.a.), ishte një sahab në moshë të re, i cili pati nderin të ishte në të dyja Besëlidhjet e Akabes me të Dërguarin e Allahut, (a.s.)!..

Ai ishte një prej tre vëllezërve trima që njiheshin si bijtë e Afra Hatun, të cilët shfaqën heroizma të papara kur morën pjesë në betejën e Bedrit!..

Muadh ibn Harithi (r.a.), lindi dhe u rrit në Medinë. Ai u edukua në ambientin e një familjeje myslimane, e cila ishte pjesë e fisit Hazrexh nga dega e Nexharëve. Ai është përmendur edhe me emrin e babait, edhe me atë të nënës.

Datëlindja e Muadh ibn Harithit nuk dihet. Por dihet se kur ai mori pjesë së bashku me dy vëllezërit e tij, Muauuizin dhe Aufin, në betejën e Bedrit, ishin ende shumë të rinj. (Ibn Haxher, el-Isabe, VIII, 26-27.)

Babai, nëna Afra binti Ubejd dhe xhaxhai i tij Rafi', ishin sahabë. Muadhi (r.a.), i cili mori pjesë në të gjitha betejat e zhvilluara nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka marrë pjesë së bashku me vëllain e tij Aufin edhe në të dyja Besëlidhjet e Akabes.

Ata që morën pjesë në Besëlidhjen e Parë të Akabes, ishin: 1. Es'ad ibn Zurare, 2. Auf ibn Harith, 3. Ukbe ibn Amir, 4. Kutbe ibn Amir, 5. Râfi' ibn Malik, 6. Muadh ibn Harith, 7. Zekvan ibn Abdi Kajs, 8. Ubade ibn Samit, 9. Jezid ibn Sa'lebe, 10. Abbas ibn Ubade, 11. Ebu'l-Hejthem Malik ibn Tejjihan, 12. Uvejm ibn Saide (radijallahu anhum).

Këshillat dhe porositë që u dhanë në këtë Besëlidhje, janë deklaruar në këtë ajet fisnik:

“O Profet, nëse vijnë tek ty besimtarët e të betohen se nuk do t’i shoqërojnë Allahut asgjë (në adhurim), nuk do të vjedhin, nuk do të kurvërojnë, nuk do t’i vrasin fëmijët e tyre, nuk do të sjellin ndonjë shpifje të sajuar nga ato vetë dhe se nuk do të të kundërshtojnë në çfarë është e drejtë dhe e arsyeshme, atëherë ti pranoje betimin e tyre dhe lutju Allahut t’i falë. Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”
(Mumtehine, 12)

Pasi emigruan në Medinë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), Muadh ibn Harithin (r.a.) dhe nipin e Omanit (r.a.), Ma'mer ibn Harithin (r.a.), i shpalli vëllezër. Siç u tha më sipër, Muadh ibn Harithi (r.a.), ishte një nga vëllezërit e njohur si bijtë e Afra Hatun, të cilët dolën trimërisht në fushëbetejën e Bedrit. Trimëria dhe guximi që shfaqën ata në këtë betejë, tregohet në këtë mënyrë:

“Në ditën e Bedrit, tre persona prej Kurejshëve dolën përpara dhe kërkuan tre veta për t'u ndeshur. Muadhi, Muauuizi dhe Aufi (r.anhum), dolën menjëherë përpara. Mirëpo, idhujtarët i përçmuan këta tre të rinj që dolën në shesh dhe thanë se, “*ne nuk kemi punë me medinasit*”, duke kërkuar luftëtarë prej Kurejshëve, si vetja e tyre.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u gëzua për trimërinë dhe guximin që shfaqën këta tre vëlle-



zër dhe u lut për ta. Mirëpo, për shkak se idhujtarët kërkuan që luftëtarët e parë të jenë prej Kurejshëve dhe, pikërisht prej bijve të xhaxhai të tij, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i urdhëroi tre vëllezërit të kthehen në vendin e tyre. (Ibn Hisham, II, 277; Ibn Sa'd, II, 17.)

Muadh ibn Harithi (r.a.), ishte një djalosh që e donte shumë të Dërguarin e Allahut. Ai kishte një dashuri aq të madhe për Profetin (a.s.), sa që mund të sakrifikonte çdo gjë në rrugë të tij. Ngjarjen e tre vëllezërve në ditën e Bedrit, e cila tregon se sa e dominin të Dërguarin e Allahut, (a.s.), të gjithë sahabët, prej më të riut, deri tek më i vjetri, e transmeton Abdurrahman ibn Auf (r.a.), me këto fjalë:

“Ditën e Bedrit, pashë majtas e djathtas dhe vura re se ndodhesha në mes të dy të rinjve prej ensarëve. Kjo nuk më pëlqeu aspak, sepse dëshiroja të isha në mes të njerëzve më të fuqishëm. Njëri prej tyre, pa dashur ta dëgjojë shoku i vet, më tha:

- *Xhaxhi! A e njeh Ebu Xhehlin ti?*

- *Po, e njoh! Ç'e doni atë? – i thash unë.*

- *Me sa kam dëgjuar, ai e shanë shumë të Dërguarin e Allahut, (a.s.)! Betohej në Allahun, i cili ka në dorë ekzistencën time, që nëse e shoh veç njëherë atë, nuk do t'i ndahem pa vdekur njëri prej nesh! – tha djali.*

Unë u mahnita nga fjalët e këtij djaloshi. Të njëjtat gjëra më tha edhe i riu tjetër. Tashmë, unë ndihesha shumë i lumtur që gjendesha midis këtyre dy të rinjve. Pak më vonë, e pashë Ebu Xhehlin të sillej rrotull në fushëbetejë dhe menjëherë ua bëra me shenjë atyre të rinjve duke u thënë:

- *Shikoni, ja ku është ai që kërkuat!*

Djelmoshat nxorën shpatat dhe vrapuan drejt e tek Ebu Xhehli dhe e shtrinë në tokë me goditjet e shpatave. Këta djelmosha ishin Muadh ibn Afra dhe Muadh ibn Amr (r.anhuma)” (Buhari, Megazi, 10; Muslim, Xhihad, 42.)

Sipas një transmetimi tjetër, Muadhi dhe Muauuizi e plagosën Ebu Xhehlin, ndërsa më pas Abdullah ibn Mes'udi e vrau atë. Përveç kësaj, thuhet edhe se Muauuizi me Aafin i prenë këmbën Ebu Xhehlit në betejën e Bedrit, e më pas, djali i tij Ikrimë, i vrau ata të dy. (Buhari, Megazi, 8; Ibn Abdulber, III, 1408-1409.)

Gjithashtu, Muadh ibn Harithi (r.a.), përmendet edhe në një transmetim ku tregohet se ai ishte ndaluar nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), që të falte namaze nafile pas namazit të sabahut dhe të ikindisë.

Muadh ibn Harithi (r.a.), ka jetuar edhe gjatë periudhave të katër halifëve të drejtë pas vdekjes së Profetit (a.s.). Lidhur me datën e vdekjes së tij ka transmetime të ndryshme. Një prej tyre dhe më e njohura, është se ai vdiq në vitin (37/657) në betejën e Siffinit duke luftuar në krah të Aliut (r.a.). (Ibnu'l-Esir, V, 197; Ibn Haxher, el-Isabe, VI, 138-139.)

Allahu qoftë i kënaqur me të!

Allahu i Madhëruar na dhëntë edhe neve prej trimërisë, ndjenjës së sakrificës dhe dashurisë për Profetin (a.s.), që kishte Muadhi (r.a.). Amin!



VETËBESIMI

NUK ËSHTË SIGURIA QË TË JEP VETJA

❧ Xhihan Tashtan ❧

Në moshën 14- vjeçare vizatova projektin e një makine, por ai nuk u pranua, pavarësisht kësaj, përdorimi i durimit, lutjes, singëritetit dhe ambicies në rrugën e duhur, bëri që të arrijmë suksese që nuk i kemi ëndërruar.

Teksa po shikoja lajmin e makinës pa shofer që kishte dalë në rrugë, më doli përpara syve projekti që kisha shkruar në vitin e dytë të gjimnazit. TUBITAK organizonte një garë për projekte inovative dhe nxënësit e shkollës së mesme dorëzonin projektet e tyre. Këto projekte do të gjykoreshin nga një juri dhe ato që shikoheshin si më të çmuara do të shkonin në finalen që zhvillohej në Ankara. Për ditë të tëra qëndrova në laboratorin e informatikës të shkollës sime që ndodhej rreth 70 km larg qendrës së qytetit Van. Ideja ime ishte parandalimi i aksidenteve në rrugë duke vendosur sensor në pjesën e përparme të makinës për të paralajmëruar shoferin për makinën që i vjen përballë. Teksa televizori shfaqte mekanizmat e makinës pa shofer, më dilte para syve projekti që kisha vizatuar vite më parë. Sa shumë ngjasonin...

Dy muaj më pas erdhi letra e shumëpritur nga TUBITAK. Unë isha një njeri që jetoja në Van dhe marrja e një letre nga Ankaraja ishte një moment i paharrueshëm...

Por...

“Në përfundim të vlerësimeve tona vendosëm që projekti juaj nuk është i mjaftueshëm. Ju urojmë suksese të mëtejshme!”

Kjo përgjigje m’i theu ëndrrat e mia! Ky projekt do të ishte një “Bismillah” për mua në rrugën e shkencës... Sigurisht që pas kësaj përgjigjeje fshihej një arsye e kuptueshme: në një kohë kur Lindja ka

kaq shumë probleme, nuk keni përse ta harxhoni kohën tuaj me gjëra kaq të panevojshme.

Vitet kaluan dhe më në fund fitova të drejtën për të hyrë në shkollën që ëndërroja: “Middle East Technical University”, në fakultetin e Biologjisë Molekulare dhe Gjenetikës. Dëshira për të realizuar projekte ishte akoma brenda meje, por për momentin po bënte gjumin dimëror. Me fillimin e vitit të dytë vendosëm që të merrnim pjesë në të gjitha garat e mëdha që bëheshin në fushën tonë. Do të merrnim pjesë në konkursin e Harvardit dhe Massachusetts Institute of Technology me temë: “Makinat me Gjenetikë të Ndryshuar (IGEM)”. Deri atë kohë, grupet e shkollës sonë në shumicën e rasteve ishin kthyer me medalje bronzi. Ndërkohë asnjë grup nga universitetet e tjera të Turqisë nuk merrte pjesë. Kaluam muaj të tërë pas zyrave të mësuesve në kërkim të një mbështetjeje sado të vogël. Nuk kishim as financues dhe as ide për të filluar projektin tonë. Diçka që nuk do ta harroj kurrë ishte refuzimi i disa mësuesve me fjalinë: “Shkoni e mësoni mësimet e mos u merrni me këto gjëra”. Vetëm vite më vonë do e kuptonim rëndësinë e zgjedhjes së bërë në atë kohë. Ne nuk do të hiqnim dorë dhe do ta vazhdonim rrugën tonë, edhe nëse do të mbesnim vetëm. Muajt kaluan dhe ne sponsorizonim veten. Për të përshkruar më mirë gjendjen tonë, mund të përdorim shprehjen: “Ne ishim fëmijë dhe nuk kishim dikë që të na mbante për dore.” Më në fund e morëm shpërblimin e durimit të stërgjatë, nëpërmjet një mësuesi që besonte tek ne dhe kompanisë së tij. Tani ishte radha jonë... Pas netëve të gjatë në laborator, më në fund shkua në SHBA për të prezantuar projektin tonë në MIT. I kishim shpenzuar të gjitha burimet tona materiale dhe shpirtërore. Teksa shikonim grupet e tjera pranë

nesh, na qante zemra nga mungesa e një mësuesi. Puna jonë do të shpërblehej shpejt pas kthimit në shkollë me medalje të argjendtë. Fryma e fakultetit ndryshoi krejtësisht dhe ne merrnim urime nga mësuesit e nga rektori. Ne ishim bërë iniciatorë të kësaj rruge. Kur kthejmë kokën pas përsërisim një fjali: “Sikur të shkoja përsëri në universitet, përsëri do të zgjidhja METU”.

Gjatë viteve në vazhdim morëm pjesë në të njëjtin konkurs për t'u kthyer me medalje ari dhe vendin e

parë në Europë. Një vlerësim i tillë bëri që njerëzit të na shikonin me respekt dhe të harronim lëndimin e refuzimit të TUBITAK-ut.

Kur më kujtohen vitet e shkuara, mendoj se pavarësisht dëshpërimit të një projekti të parealizuar përdorimi i durimit, lutjes, singleritetit dhe ambicies në rrugën e duhur, bëri që të arrijmë suksese që nuk i kemi ëndërruar. Tani shikojmë të rinjtë e shumë universiteteve që ecin në rrugët që hapëm ne...

Nëse je optimist... Ka shpresë...

Makro Univers

LUMTURIA ËSHTË TË KUPTUARIT

Muaz Erdem

Kështu thotë Stephen Hawkingu: “Lumturia gjendet në të kuptuarit.” Pra, lumturia gjendet në të menduar. Stephen Hawkingu ka dhënë kontribute të jashtëzakonshme për shkencën në lidhje me Fizikën Kuantike dhe Vrimat e Zeza. Ai pranohet si fizikani teoricien më i ndritur që nga Ajnshtjani e deri në ditët e sotme. Për shkak të sëmundjes ASL që është e pashërueshme dhe që u kaplua në moshën 21 vjeçare, përjetoi paralizim të sistemit nervor. Kjo sëmundje nuk ia dëmtoi funksionet e mendjes. Hawkingu e vazhdon jetën e tij në një karrige me rrota. Në sajë të kompjuterit që i shndërron shkrimet në zë, ai vazhdon të shkruajë libra, materiale, të japë mësimet dhe të nxjerrë në pah teori.

DIZAJNI I MADH (THE GRAND DESIGN)

Hawkingu që ka rënë në sy me botën e mendimit të tij plot me batica-zbatica, në librin e fundit me titull, “Dizajni i Madh” thotë: “Nuk ka nevojë për Zotin. Çdo gjë ka ndodhur për shkak të forcës së gravitetit.” Mirë, por si ka hyrë në gjithësi kjo forcë graviteti? Për këtë nuk flet, por nganjëherë përpigjet ta përputhë me rastësinë. Për shembull, thotë: “Po të mos ishin si tani disa forca brenda bërthamës së atomit, atomet nuk do të formoheshin dhe ne nuk do të ekzistonim. Ne gjendemi këtu, sepse të gjitha ligjet e fizikës janë caktuar në atë mënyrë. Pra, ato janë bashkuar rastësisht dhe në këtë mënyrë ka filluar jeta në gjithësi.” Fakti që gjithësia është në

përputhshmëri të plotë me ligjet fizike, e pengon atë për të parë Vënsin e vërtetë të ligjeve. Ndërkohë, edhe titulli i librit të tij është mjaft interesant, sepse domosdoshmërisht “dizajni” e ka një “dizajnues”. Nëse flasim vetëm për forcën e gravitetit, mendja nuk bindet plotësisht.

Hawkingu më parë ka thënë në librin e tij me titull “Historia e Shkurtër e Kohës”: “Nëse do të kishim mundësi për të përdorur një teori të plotë, atëherë kjo do të ishte fitorja e logjikës së njeriut. Në këtë mënyrë, mund të kuptonim edhe mendjen e Zotit.” Domethënë, heton funksionimin dhe ligjet e universit. Por nëse ka një ligj, vallë kush është Vënsi i atij ligji?

Përfundimisht, në librin e parë të tij e pranon dhe thotë: “Të kërkoj mendjen e Zotit.” Ndërsa në librin e dytë thotë se është formuar “rastësisht”.

“Formimi i gjithësisë mbështetet te vërtetësia e shkencës, por kjo nuk do të thotë se nuk ka një Zot që i ka krijuar rregullat e shkencës!” Stephen Hawking

Hawkingu që tashmë përsëri bëri një shpjegim se “ka Zot”, shpresojmë t’i marrë për shembull sado pak atomet e qëndrueshme. Të menduarit, të dyshuarit dhe të hetuarit sigurisht që janë parime të shkencës, por shpjegimet sipas dëshirës që nuk e kanë arritur një pjekuri të caktuar, mund të bëhen pengesë vetëm për ata që nuk logjikojnë. Andaj kini kujdes!



Kush janë personazhet e Hockney-t?

Edison Çeraj

Ndjesia e parë që të shkaktojnë pikturat e Hockney-t është një përzjerje – jo dhe aq e përballueshme – midis boshit dhe anonimatit. Pra ka diçka nga këto dy gjendje, të cilat mund ta zëvendësojnë njëra-tjetrën si dy anë të së njëjtës medalje.

Në fakt, një pjesë e madhe e pikturave të tij karakterizohen nga ngjyra “të nderura”, plot gjallni, siç është jeshilja dhe roza. Megjithatë, ngarkesa që u jep autori i bën ato të përcjellin diçka krejt tjetër. Ai iu heq gjuhën tradicionale këtyre ngjyrave, duke i bërë të shprehen me një gjuhë tjetër, sidoqë pa ia cenuar alfabetin. Kështu ai gëzon aftësinë t’i personalizojë ato, gjë që përbën sinjalin e parë se një autor meriton vëmendje. Forca personalizuese në këtë kontekst është pasoja e prekshme e forcës krijuese.

Nganjëherë Hockney të kujton Hopper-in: vijimësi e të njëjtës përmbajtje por me një tjetër veshje, që “i përshtatet” më shumë kohës. Dinamika apo lëvizja në pikturat e tyre është e ndryshme, kurse gjendja – si emëruese e përbashkët e të gjithë elementeve në një vepër – është pothuaj e njëjtë. Por, sigurisht që nuk është kaq e thjeshtë.

Personazhet e Hockney-t nuk bëjnë asgjë. Ata janë të qartë dhe të pamundur në të njëjtën kohë. Nuk presin asgjë. Nuk kërkojnë asgjë. Nuk mohojnë dhe nuk pohojnë asgjë. Ata janë të aftë të bëjnë vetëm një gjë: asgjënë – një asgjë që buron nga një përrallë e munguar e kohës. Çdo fjalë që ata nuk mund ta shprehin është “si një njollë e parëndësishme mbi heshtjen dhe asgjënë”. (Beckett)

Ata nuk janë të vetëdijshëm se kanë çdo gjë e një-kohësisht nuk duan asgjë. Janë të pranishëm vetëm kur mungojnë, dhe të papranishëm ndërkohë që janë aty. Ata nuk kanë ndonjë lidhje “organike” me çfarë i rrethon. Ata janë aty ku janë si për të na përcjellë diçka, diçka që as ata nuk e dinë se ç’është, por thjesht u duhet ta përcjellin.

Hockney i privon nga veprimi personazhet e tij për t’i shndërruar në shenja, ose në një Logos të përmbysur. Në këtë përmbysje çdo gjë është e pamundur, pavarësisht se çdo gjë është e lejuar. Vetëdija dhe pavetëdija janë

e njëjta gjë për ta. Të dalluarit nuk ka asnjë kuptim, sepse nuk kanë asnjë motiv.

Disa prej pikturave ngjajnë si përkthime të Kafka-s dhe Beckett-it në gjuhën e imazhit. Por, megjithatë, te Hockney ka një lloj tejkalimi të këtyre dy autorëve, ose një konfirmim bindës të vërtetësisë së mesazhit të tyre. Tëhuajësimi në raport me veten, me tjetrin dhe mjedisin është një gjendje e përbashkët e Hockney-t me autorë si Kafka apo Beckett-i. Personazhet që na kanë dhënë këta autorë janë të dënuar të mos kenë asnjë qëllim në jetët e tyre, pavarësisht se mund të lexohen si kërkim i pavetëdijshëm i një qëllimi. Nëse do i merrnim hua Beckett-it edhe nja dy fjalë, le të themi se ata janë mbi tokë, dhe për këtë nuk gjejnë dot asnjë kurë.

Mjedisi që u krijon Hockney personazheve të tij është pothuaj idilik – dritë dhe ngjyra të hareshme, si fragmente të parajsës që premtojnë utopitë. Pastaj asgjëja. Më e pushtetshme se çdo gjë. Është një nga rastet e rralla ku gjëja ka kaq pak peshë, dhe i gjithë graviteti ushtrohet te asgjëja. Si në rastin e veprës *A Bigger Splash*, ku ka mbetur vetëm spërkatja – uji i mbetur (fiksuar) përpjetë pas hedhjes nga trampolina në pishinë, dhe nga ana tjetër një karrige bosh buzë një shtëpie kubike për verim. Një skenë e sapoboshatisur, ku dikush është zhdukur, pothuajse si pas një krimi të papërcaktueshëm. Koha është pezull, si palëvizshmëria e ujit në pishinë. Elementet e tjerë, si: bari, trunget e dy pemëve, xhamat dhe imazhi i pasqyruar aty janë zhveshur nga mundësia për të provokuar emocionet e zakonshme që marrim në të tilla raste. Është një lloj çnjerëzimi i ushtruar në paqe. Nuk ka asgjë tërheqëse – kjo është tërheqja.

Heidegger-i thoshte se poetët janë antenat e njerëzimit, por besoj se kjo vlen edhe në rastin e arteve pamore. Sinjali që na transmeton Hockney ka të bëjë me një gjendje akomunikuese, rrjedhojë e një botëkuptimi dhe rendi që e ka reduktuar qenien në funksion, dhe ku me hir e ku me pahir është mënjeluar qëllimi, dhe duke u mënjeluar, edhe harrohet.

Ja pse personazhet e Hockney-t nuk kërkojnë e nuk përpiqen për asgjë. Ata përfaqësojnë pamundësinë.



I DITURI DHE I RIU SHËTITËS

Një djalë i ri kishte dalë të shëtiste botën për të mësuar kuptimin e jetës. Në njërin prej vendeve ku kishte shëtitur, kishte vizituar një njeri të ditur. I riu shëtitës pa se muret e shtëpisë ku jetonte i dituri ishin të mbushura me libra. Pasi e pa shtëpinë me kujdes, vuri re se në shtëpi nuk kishte asgjë përveç një qilimi në tokë, një shtrati të thjeshtë dhe në mes një tavolinë e një karrige. Të diturin e pyeti me kureshtje:

“Përse nuk keni asnjë gjë? Kolltukët, divanët, tapetat... Ku janë këto?”

I dituri i bëri një pyetje të tillë të riut shëtitës si përgjigje për pyetjen e tij:

“Bir! Edhe ti ke vetëm një çantë të vogël që e mbart në kurriz. Po ti ku i ke gjërat e tua?”

I riu shëtitës menjëherë u hodh dhe i dha përgjigje kësaj pyetjeje:

“Siç e shikoni... Unë jam një udhëtar.”

I dituri qeshi sikur po i jepte të drejtë dhe i vendosi pikën kësaj çështjeje:

“Edhe unë ashtu jam, bir...”

FAKTE INTERESANTE

- ▶ *Muskuli më i fortë në trupin e njeriut është gjuha.*
- ▶ *Ushqimi i vetëm që nuk prishet është mjalti natyral.*
- ▶ *Një ëndërr zgjat mesatarisht 2-3 sekonda.*

NJË LUTJE

“O Zot!

*Më bëj prej robërve të Tu
që gëzohen kur bëjnë mirë dhe kërkojnë falje
kur bëjnë keq!”*

(Ibn Maxhe, Edeb, 57.)

Islami në Spanjë

NJË HISTORI E COPEZUAR, NJË IDENTITET I COPEZUAR

Alisia Rodriguez Mejuto

Islami u është paraqitur europianëve si diçka e huaj dhe kërcënuese, por, në fakt, ata ndajnë një histori të 1300 viteve. Spanja, në veçanti, ka një lidhje të veçantë me botën muslimane: *el-Andaluzi* ishte rezultati i kontaktit të parë të Islamit me Europën.

Por, që me rënien e Granadës, një aparat i suksesshëm propagande po i mbulon dhe po i shtrembëron ngjarjet historike, duke krijuar kështu një identitet kolektiv të copëzuar dhe të lëndueshëm, të paaftë për ta brendatrupëzuar dhe shprehur qartë pjesën e së shkuarës së një populli të tërë, dhe kjo traumë vazhdon sot në shoqërinë spanjolle.

“Spanja bashkëkohore u bën fuqimisht publicitet Alhambrës dhe monumenteve të tjera të el-Andaluzit si atraksione të mëdha turistike. Ndonëse promovuesit dhe udhërrëfyesit e turneve nuk e vënë plotësisht në dukje se këto janë trashëgimi të gati tetë shekujve, gjatë së cilëve muslimanët jo vetëm e morën Spanjën, por mbollën rrënjët e Rilindjes Europiane përmes bartjes së pashoqe të dijes në thuajse çdo fushë të njohur. Me fjalë të tjera, ndërsa Spanja dhe Perëndimi janë të lumtur të jenë trashëgimtarë të trashëgimisë së Spanjës islame dhe të përfitojnë prej saj, kanë një ngurrim të paepur për ta pranuar se si ajo trashëgimi ndihmoi për ngjitjen e Europës. Udhëtari amerikan, Uashington Irving (Washington Irving), e vuri re këtë paradoks kur vizitoi Spanjën gjatë fillimit të shekullit të tetëmbëdhjetë. Spanjollët, u shpreh ai, i konsideronin muslimanët vetëm si ‘pushtues dhe uzurpues’; dhe kështu duket të jetë ende dhe tani...”

Në ditët e sotme ka rreth 200 xhami në Spanjë, 50 prej tyre në rajonin e Andaluzisë. Dikur, sigurisht, kishte mbi 1600 xhami vetëm në Kordovë!”

Përrshkrimi i mësipërm përmbledh në mënyrë të përkryer identitetet paragjyquese spanjolle dhe përrëndimore. Por le të bëjmë një udhëtim të shkurtër

në të shkuarën dhe të shohim jehonat dhe rrjedhojat e atyre ngjarjeve historike në të tashmen.

Spanja ishte përpjekja e parë për të vënë këmbën në Europë në kërkimin për ta universalizuar mesazhin e Islamit dhe për të treguar se si formula e tij e thjeshtë dhe e pastër, teuhidi, ashtu si shiu, mund të bënte të lindnin një larmi shprehjesh kulturore, kërkimi shkencor dhe aktiviteti tregtar. Hapja e Spanjës është përhapja e natyrshme e një force të zgjerueshme të vënë në lëvizje nga bërthama e bashkësisë muslimane që kishte lindur gjatë jetës së Profetit (a.s.).

Unë huazova disa paragrafe të kronologjisë vijuese për të treguar ngjarje të rëndësishme gjatë kësaj periudhe 800-vjeçare që ndihmuan në formimin dhe mbajtjen gjallë të gjendjes aktuale konfliktuale shoqërore, fetare dhe kulturore.

Periudha nën sundimin islam në Spanjë dhe në Portugali nisi më 19 korrik 711 dhe përfundoi më 1 janar 1492. Kronologjia është si vijon:

19 korrik 711 gjer në vitin 714: çlirimi dhe konsolidimi musliman.

912-961: sundimi i Abdurrahmanit III, më i madhi i omejadëve iberikë. El-Andaluzi është vendi më në lulëzim në tërë Europën. Vetëm Konstandinopoja e rivalizon Kordovën. El-Medinetu’z-Zehra (qyteti i lulëzuar) është ngritur si një qytet mbretëror.

“El-Andaluzi ishte midis manifestimeve më të mëdha të qytetërimit që ka parë ndonjëherë Europa. Andaluzianët ishin në mënyrë të vetëdijshme europianë, dhe e kultivuan atë identitet në poezinë e tyre. Nga pikëpamja etnike, muslimanët andaluzianë nuk dallonin në mënyrë domethënëse nga fqinjët e tyre krishterë në veri. Qytetërimi andaluzian qe tolerant dhe kozmopolitan; ai i përqafoi muslimanët,



të krishterët dhe hebrenjtë. Popullsia e tij muslimane ishte e ndryshme: iberikë [latinë dhe keltë], berberë, arabë, teutonë, afrikanë nënsaharianë, sllavë, persianë, e të tjerë. El-Andaluzi njohu në kohët e veta më të errëta ndarjet e shëmtuara racore, veçanërisht midis berberëve dhe arabëve, por ia doli shpejt ta arabizonte popullsinë e vet dhe t'i bashkonte ata në një trup”.

1095: Iberia është bërë teatri përëndimor i luftës së Europës katolike kundër Islamit. Ka një ndërhyrje të shtuar të huaj kishtare dhe ushtarake (europianoveriore) në jug të Pirenejve. Me fillimin e kryqëzatave të mëdha pas Klermontit, rishtënia në dorë e Spanjës dhe Portugalisë është bërë një fazë thelbësore në rrugën për në varrin e Shenjtë të Jerusalemit. Papët e Romës do të përkrahin nga shekulli i 11-të deri në shekullin e 15-të një luftë të armatosur tërësore kundër Islamit në Iberi dhe në Lindjen e Mesme.

1 janar 1492: rënia dhe dorëzimi i Mbretërisë së Granadës mbretërve katolikë (Isabelës dhe Ferdinandit).

Shekujt e 15-të dhe 16-të: inkuizicioni spanjoll bëhet instrumenti kryesor i shtetit për sjelljen e hegjemonisë dhe të unifikimit kulturor, gjuhësor e politik të Spanjës nën një besim të vetëm, të bashkuar, katolik. Inkuizicioni shërbeu si aparat sigurimi shtetëror dhe si mjet i enkulturimit spanjoll. Gjuha arabe, veshjet dhe zakonet muslimane janë ndaluar me ligj.

1609: zgjidhja përfundimtare. Edikti i Dëbimit të moriskëve nga Spanja.

1834: Inkuizicioni spanjoll është zhdukur për jetë të jetëve. Në vitet 1830, një morisko i zonave malore të Sierra Nevadës në Granadë ishte muslimani i fundit që do të ekzekutohej në Spanjë nga Inkuizicioni.

Fillimi i shekullit të 20-të: është e zakonshme për kumbarat në fshatrat spanjolle t'u thonë prindërve të një fëmije pas pagëzimit nën patronazhin e tyre: “Miq, këtu është djali juaj. Ju ma dhatë atë një maur, dhe unë ua ktheva si një të krishter.”

Propaganda zyrtare e vënë në punë menjëherë nga sundimtarët gjatë Inkuizicionit depërtoi në tërë shprehjet e shoqërisë, duke i dhënë trajtë një miti dhe perceptimi të rremë në vend të një realiteti historik. Ajo u kristalizua në moton e tashme kombëtare: *“Spanja u pushtua nga arabët (muslimanët), dhe pas 800 viteve lufte ne ishim në gjendje ta rimarrim Spanjën prej atyre “pushtuesve dhe uzurpuesve”.*

Por, nëse e zbulojmë këtë qasje ideologjike ndaj historisë, ngjarjet na tregojnë se:

– Spanja nuk ekzistonte si entitet politik në ato kohë; ato ishin mbretëritë vizigote në luftë civile.

– Ai nuk ishte një pushtim. Gjeneral Tarik bin Zijadi u thirr për ndihmë. E shpjeguar kjo goftë me arsyen e historisë legjendare të Kont Julianit, qeverisësit vizigot të Ceutës, dhe humbjes së nderit të vajzës së tij prej mbretit Roderik, apo me versionet e ndryshme historike që tregojnë se bijtë e shpronësuar të mbretit vizigot të vdekur së fundi, Vitizës, iu drejtuan muslimanëve për ndihmë në luftën civile.

– Ata nuk ishin arabë: Tarik bin Zijadi dhe ushtria e tij ishin në shumicë dërrmuese berberë.

– Ata nuk dëbuan “maurët” apo “moriskot”: më 1609, pas 800 vitesh, dëbimi ishte për spanjollët, muslimanët spanjollë, jo për të huajt apo për të ardhurit rishtas.

– Ideja e rreme e një *Rekonkuiste*: mbretëritë krishtere ishin ngritur pas arritjes së Islamit. Do të ketë qenë me tepër një çështje e legjitimitetit politik të këtyre mbretërve, që e konsideronin veten pasardhësit dhe trashëgimtarët e vërtetë të vizigotëve, dhe përpjekje e mbretërve krishtere (veçanërisht të Kastiljes) për të justifikuar pushtimet e tyre. Historianë me emër, të tillë si Ignacio Videla Olague te “Revolucioni islam në Perëndim”, besojnë se pushtimi ushtarak arab është një mit, dhe janë të mendimit se krijimi i el-Andaluzit ishte rezultat i konvertimit në Islam të shumë prej popullsisë hispanike. Këto teza janë studiuar nga arabisti i famshëm Gonzales Ferrin te punimi i tij, “Historia e përgjithshme e el-Andaluzit”, ku, duke folur për Rekonkuistën, ai thotë “se nuk ekzistoi kurrë vërtet”, dhe sugjeron gjithashtu që el-Andaluzi “është një hallkë e domosdoshme në historinë europiane”.

Sot në shoqërinë spanjolle ka një tension të dukshëm ndaj bashkësisë muslimane, të përbërë kryesisht nga marokenë dhe pakistanezë, dhe shpesh konfliktet dhe polemikat lindin për shkak të një vendi të ri adhurimi apo për arsye të hixhabit të grave. Muslimanët janë gjithmonë të dyshimtë, dhe një prani e bezdisshme, edhe muslimanët spanjollë madje. Në imagjinatën popullore, “maurët janë duke u kthyer”; paradoksi është se maurët kurrë nuk ikën plotësisht, ata po rrjedhin në gjakun e tyre, në pritje për t'u njohur!

“Ju jeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ta; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.” (Ali Imran, 110)

Ky ajet, përkrah vlerësimit që i bën bashkësisë islame për statusin madhështor që zotëron në krahasim me bashkësitë e tjera, e ngarkon edhe me shumë përgjegjësi.

“Ju jeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”

Bashkësia islame duhet ta vlerësojë dhe respektojë nderimin që i bën Allahu, duke e konsideruar si bashkësinë më të dobishme për të gjithë njerëzimit. Në të njëjtën kohë, kjo bashkësi islame është e ngarkuar edhe me detyrën për të udhëhequr njerëzimin drejt paqes universale. Por që bashkësia islame të arrijë këtë pozitë, duhet të plotësojë disa kushte, sepse kjo pozitë mund të meritohet vetëm mbas përpjekjeve të mëdha. Nga pikëpamja e teorike (besimi) dhe sistemi social, bashkësia islame është plotësisht e denjë për këtë pozitë, por nuk mjafton vetëm kjo. Përkrah kësaj, për të përfaqësuar denjësisht vullnetin e Allahut në tokë, duhet zotëruar dhe zhvilluar më tej shkenca dhe teknologjia, si dhe çdo gjë që sjell dobi për njerëzit. Nëse kjo bashkësi ndjek me përpikëri metodën hyjnore dhe sjell në vend atë që kërkohet prej saj, Allahu e lartëson këtë bashkësi në të gjitha fushat. Rrugat e arritjes së kësaj pozite është e mbushur me vështirësi, por megjithëse e vështirë dhe me pengesa, është e domosdoshme të formohet dhe të ruhet një mënyrë jetese sipas vullnetit të Allahut.

Për të përcaktuar saktë të mirën dhe

të keqen, është i domosdoshëm besimi. Në kohën kur kriteret që përcaktojnë të keqen dhe të mirën ndryshojnë brenda ditës, është e domosdoshme të mbështetemi në kritere hyjnore, sepse mënyra e jetesës së bashkësive të tjera nuk është kriter për përcaktimin se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe. Botëkuptimi islam me burim hyjnor, qartëson pozitën dhe rolin e njeriut në tokë, duke formuar marrëdhënie harmonike ndërmjet krijuesit, natyrës dhe njerëzve. Pra, për të pasur sukses, duhet një besim i fortë, sepse gjatë rrugës, bashkësia islame do të përballlet me vështirësi dhe armiq të shumtë dhe, i vetmi tek i cili mund të mbështetet, është Allahu. Nxitja për mirë dhe ndalimi nga e keqja, është detyrë e bashkësisë islame dhe, nëse nuk e realizojnë këtë detyrë, nuk e meritojnë emrin mysliman në kuptimin e plotë të fjalës.

“Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ta; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”

Kjo është shprehje inkurajuese ndaj ithtarëve të librit për të pranuar fenë islame, sepse besimi në fenë islame do t’u sillte dobi në këtë botë dhe në botën tjetër.

“...ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”

Me këtë citat të fundit të ajetit, Allahu (xh.sh.), shpjegon gjendjen e atyre që besuan dhe janë vepërmirë, duke i vlerësuar për aktin e kryer.

Xhabiri, (r.a.) transmeton se Resulullahu (a.s.):

Kaloi nëpër treg, kurse njerëzit ishin tubuar rreth tij. Pastaj ndaloi pranë një caji të ngordhur me veshë të vegjël, e kapi për veshi dhe tha: **“Cili prej jush dëshiron ta marrë për një dërhem?”** I thanë: “Asnjëri nga ne nuk jep gjë për të, çfarë mund të bëjmë me të?” Pastaj tha: **“A e doni të jetë juaji (falas)?”** Thanë: “Pasha Allahun, edhe të ishte i gjallë, ishte me të meta, për arsye se ka veshë të vegjël e jo më i ngordhur!” Atëherë tha: **“Pasha Allahun, vërtet për Allahun kjo botë është më e pavlefshme sesa ky (cjav) për ju.”** (Muslim, Zuhd, 2)

Profeti (a.s.), interesohej për çdo gjë që kishte përreth dhe çdo gjë që e shih-te të vlefshme e përdorte si material edukimi. Një nga këto shembuj e shohim edhe në këtë hadith fisnik.

Kapja prej veshi e një caji të ngordhur dhe tërheqja e vëmendjes së njerëzve tek ai, dëshmon për pavlefshmërinë e asaj gjëje. Megjithatë, ai (a.s.), i pyeti sahabët se për sa dërhem do ta blinin atë cjav. Por dihej mirë se askush nga ata që ndodheshin aty nuk do t'i jepte ndonjë vlerë dhe nuk do ta blinte. Dhe me të vërtetë askush nuk doli e ta blinte atë cjav. Madje ata nuk pranuan ta merrnin dhe falas. Në fakt, kjo ishte ajo që edhe pritej të ndodhte. Mbi të gjitha, sahabët u shprehën se nuk do ta dëshironin atë edhe sikur të ishte i gjallë, sepse ishte një kafshë me të meta, pra, i kishte veshët e vegjël. Kjo ishte ajo që donte edhe Profeti (a.s.), sepse ky rast ishte i përshtatshëm për mësimin që donte t'i jepte shokëve të vet.

Duke u nisur nga ky refuzim, u tha sahabëve se vlera e kësaj bote tek Alla-

hu ishte më e vogël se sa vlera e këtij caji që ndodhej para tyre. Kështu që i këshilloi myslimanët se nuk duhej të mashtroheshin nga të mirat dhe pasuritë e përkohshme të kësaj bote. Gjithashtu i lajmëroi se për shkak të vlerës së pakët të kësaj bote, Allahu Teala, atyre që punojnë dhe mundohen, do t'u japë prej kësaj bote pa bërë dallim midis besimtarëve dhe mohuesve. Kjo është drejtësia e Allahut. Për këtë arsye Allahu u jep pasuri mohuesve që punojnë shumë në krahasim me myslimanët që punojnë pak apo aspak. Mirëpo, mirësitë e botës tjetër nuk janë të tilla. Ato kanë shumë vlerë tek Allahu Teala dhe ato do t'ia falë besimtarëve të cilët i vlerësonin të mirat e botës tjetër që në këtë botë.

Kjo nuk do të thotë që besimtarët të ndërpresin lidhjet me këtë botë. Përkundrazi, ata të zotërojnë prej të mirave të kësaj bote, por të besojnë dhe të mos harrojnë se ato që zotërojnë janë të përkohshme dhe se nuk do t'i zotërojnë ato përjetësisht.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Profeti (a.s.), ka shfrytëzuar çdo rast për të edukuar sahabët.
2. Ashtu si caji i ngordhur nuk ka vlerë në sytë e njerëzve, ashtu edhe kjo botë nuk ka vlerë tek Allahu Teala.
3. Njerëzit nuk duhet të kapen pas kësaj bote sikur të ishte e përjetshme.



SHKOLLA E UNIVERSTIT

Gjithësia, Kurani dhe Njeriu – 3

ENIGMA TEK NJERIU

Njeriu është një enigmë, që jeton midis ahsen-i takuim¹ dhe esfel-i safilin², midis devotshmërisë dhe gjynahut dhe midis baticave dhe zbaticave. Ndër të gjitha krijesat, njeriu është krijesa më e aftë në pasqyrimin e manifestimeve hyjnore. Në këtë aspekt, edhe gjithësia, si një pasqyrë e plotë, i është kushtuar soditjes dhe meditimit të njeriut.

Në fakt, i gjithë universi përbëhet prej manifestimeve të cilësive hyjnore. Në këtë kuptim, universi është si një pllakë xhami, së cilës nuk i është vendosur ende formula kimike, që do ta kthejë atë në një pasqyrë. Kur njeriu, i cili është krijuar si një formulë hyjnore/enigmë që do t'i japë asaj pllake xhami cilësinë e pasqyrës, e plotëson atë dhe e sheh me syrin e meditimit, ajo (gjithësia) shndërrohet në një pasqyrë të plotë për njeriun. Në këtë pasqyrë, njeriu sheh dhe njeh dobësinë dhe esencën e vet. Në sajë të këtij meditimi:

“Kush njeh veten, njeh Zotin e tij.”

Sepse në një hadith fisnik, thuhet:

“Allahu³ e krijoi Ademin në formën (pamjen) e vet.”⁴

1. - ahsen-i takuim: Krijesa më e bukur, më e përsosur.

2. - esfel-i safilin: Më i ulëti i të ulëtëve.

3. - Është e domosdoshme të dihet se Allahu është i pastër nga çdo lloj forme, pamje apo imagjinatë. Ai nuk ngjan me askënd dhe asgjë.

4. - Në lidhje me këtë hadith është e këshillueshme të shihen mendimet e ndryshme të dijetarëve, me qëllim që të evitohen keqkuptimet. Një shpjegim në lidhje me këtë hadith në gjuhën shqipe mund ta gjeni në adresën e internetit: <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=1894>.

(Muslim, Birr, 115.)

E vërteta që shprehet në këtë hadith fisnik, nuk ka të bëjë me pamjen apo formën e dukshme trupore, por me atë shpirtërore dhe të padukshme. Nuk ka të bëjë me trupin dhe egon, por me shpirtin dhe të fshehtën.

Këtë shpreh edhe fakti që ekzistencës së njeriut i është fryrë një shpirt prej Allahut, që ai është bërë halife/mëkëmbës i Allahut në tokë dhe që melekët u urdhëruan t'i bënin sexhde atij. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: «Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë!..»” (Bekare, 30)

“E kur t'i jap trajtë dhe t'i fryj prej shpirtit Tim, përluni atij në sexhde!” (Sad, 72)

Po ashtu, Allahu i Madhëruar ia mësoi Ademit (a.s.), “të gjitha emrat”. Biri i njeriut, në sajë të këtyre dijeve dhe cilësive që i ka falur Allahu, do të jetë dëshmitari i Zotit në tokë dhe nën udhëzimin e Librit të Gjithësisë, Kuranit Fisnik, do të përpiqet të lexojë misteret dhe urtësitë në veten e tij.

Kjo përpjekje, do ta bëjë atë të përparojë në njohjen e Allahut. Për këtë arsye, të dashurit e Allahut, si shpjegim i këtyre të vërtetave hyjnore kanë thënë:

“Allahu është sekreti i njeriut, ndërsa njeriu është



sekreti i Allahut.” (Fususu’l-Hikem Terc. ve Şerhi, I, 48.)

Njeriu që arrin të kapërcejë pengesën e egos/ nefsit, është një ekspozitë bukurishë dhe një vepër e vërtetë arti. Ai është përmbledhja e Librit të Gjithësisë, hyrja e tij dhe e fshehta e krijimit.

Sepse:

Megjithëse në dukje ai është i përbërë prej mishit dhe kockës, në ekzistencën shpirtërore nën këtë pamje të njeriut, janë fshehur shumë mistere, urtësi dhe të vërteta të manifestimeve hyjnore. Aliu (r.a.), në një bejte kush-tuar njeriut, këtë të vërtetë e shpreh kështu:

“Tek ty është ilaçi, por ti nuk e sheh, tek ti është problemi, por ti nuk e di. Diçka e vogël kujton se je, por gjithë universi është fshehur te ti.”

Kjo është edhe e vërteta që shpreh Shejh Galibi në bejten e tij të famshme:

“O njeri! Shikoje bukur veten me syrin e zemrës, sepse ti je esenca dhe bebja e syrit të universit.”

Për shkak se nuk arriti ta shohë të vërtetën e Ademit (a.s.), Iblisi u tregua smirëzi ndaj tij dhe kundërshtoi urdhrin e Allahut duke mos rënë në sexhden e nderimit ndaj Ademit (a.s.). I nderuari Mevlana ka thënë:

“Merr mësim prej Iblisit dhe mos e çmo tepër atë! Sepse edhe Iblisi kishte dije, por, ai arriti të shohë

vetëm krijimin e prej balte të Ademit, pamjen e tij të jashtme dhe nuk arriti të shohë të vërtetën e tij.”

Nëse njeriu arrin ta pastrojë zemrën e tij nga papastërtitë trupore dhe egoiste me anë të devotshmërisë, duke përjetuar qetësinë shpirtërore, ai do të arrijë të përparojë edhe në horizontin e meditimit dhe thellësitë e kuptimit.

Kur robi arrin këtë pjekuri (shpirtërore), tek ai fillon të largohet perdja e indiferencës ndërmjet tij dhe Allahut. Në këtë mënyrë, ai zbulon misterin e “vdekjes para se të vijë vdekja”. Kjo botë dhe dashuria e përkohshme për të, bukuria dhe dëshirat e kota të saj nuk kanë më vlerë në sytë e tij dhe më në fund, ato i dalin prej zemrës. Në këtë mënyrë, shpirti arrin ëmbëlsinë e papërshkrueshme të afrimit me Krijuesin e vet.

Në çdo gjë që sheh, zemra e tij i kujton Allahun dhe kështu forcohet lidhja dhe miqësia e tij me Allahun. Një meditim i tillë, bëhet çelësi më i mirë i besimit.

Për një njeri me pjekuri të tillë shpirtërore, kjo gjithësi është një shkollë e mrekullueshme dhe një vend provimi i vërtetë.

SHKOLLA E UNIVERSIT

Çdo gjë, që prej grimcës më të vogël e deri tek trupi më i madh, tregon manifestimin e madhësisë dhe fuqisë hyjnore. Zija Pasha, e shpreh kështu

Çdo krijim bëhet me caktimin e Allahut... “... asnjë gjethe nuk bie, pa dijeninë e Tij dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh).”

(En'am, 59)

këtë të vërtetë:

“Në çdo fletë të librit të këtij universi, janë shënuar me mijëra mësimë prej manifestimeve të dijes dhe urtësisë hyjnore. O Zot! Sa shkollë e mirë është ky univers për ata që zhyten në oqeanin e medimit dhe për ata të cilët marrin mësim duke soditur vitrinat hyjnore!”

Gjithësia, është si një lloj komentimi i detajuar i mrekullisë së Kuranit Fisnik. Domethënë, Kurani Fisnik është një univers i përbërë prej fjalëve, ndërsa universi është një Kuran pa fjalë.

Një poet tjetër, e shpreh kështu këtë të vërtetë:

“Gjithësia është libri më i madh i Allahut, nga fundi në krye.

Cilëndo shkronjë të këtij libri të lexosh, do të shohësh që kuptimi i saj Allah del gjithmonë.

Mbi cilëndo grimcë të gjithësisë të meditosh, tek Allahu do të të çojë ajo.”

Siç shprehet edhe Shejh Sadi:

“Për zemrat e ndritura, edhe një gjethe peme mjafton për të njohur Allahun. Ndërsa për indiferentët, edhe të gjitha pemët nuk vlejnë sa një gjethe.”

Për të zotët e mendjes, universi në të cilin jetojmë, është një madhësi hyjnore dhe një bukuri e mrekullueshme mbi të cilin duhet medituar. Ndërsa për njerëzit pa mend, nuk është gjë tjetër përveçse ushqim dhe epsh.

Ndërsa i nderuari Mevlana, gjendjen e mjerë të atyre që janë të verbër e indiferentë ndaj manifestimeve të madhësisë dhe fuqisë hyjnore në këtë botë, e tregon me këtë fabul:

“Kau shkoi në Bagdad dhe e shëtiti fund e krye qytetin madhështor me plot bukuri. Mirëpo, atij nuk i zuri syri asnjërin prej këtyre bukurive. Në fakt ai nuk pa asgjë tjetër përveçse lëvore pjeprë e shalqiri.”

Kështu është edhe gjendja e njerëzve indiferentë përballë manifestimeve të madhësisë hyjnore!

Toka mbi të cilën jetojmë, është një planet në sistemin diellor që është zgjedhur midis trilionave yjeve. Me gjithë kërkimet që vazhdojnë të bëhen prej shumë vitesh në lidhje me kozmosin, ende nuk është zbuluar ndonjë planet tjetër i mbushur me jetë si Toka. Planetët e tjerë, janë ose shumë të nxehtë, ose shumë të ftohtë, ose pa oksigjen, ose të përbërë vetëm prej gazit, ose vetëm prej shkëmbinjve pa jetë dhe të tjerë faktorë që nuk e lejojnë jetën të zhvillohet.

Shkencëtarët mendojnë se, që nga krijimi i universit kanë kaluar rreth 13 miliardë vite.

Ndërsa ekzistenca e njeriut, ka filluar në pjesën e fundit të kësaj hapësire të madhe kohore. Allahu i Madhëruar, dëshiron që ne të meditojmë mbi këtë fakt. Për rrjedhojë, në një ajet fisnik urdhërohet:

“Vallë, a nuk ka kaluar një periudhë kohore, kur njeriu nuk ka qenë genie e denjë për t’u përmendur?!”
(Insan, 1)

Njeriu nuk ekzistonte as si emër e as si formë. Mirëpo, Allahu e përgatiti këtë botë për të dhe, me qëllim që njeriu të ketë mirësi të shumta për të medituar, arti hyjnor shpërtheu veçanërisht në këtë planet të vogël.

Një nga format e medimit, është edhe mendimi i të kundërtës. Kjo gjë e kufizon zakonin të bëhet pengesë për meditim.

MENDO NJËHERË TË KUNDËRTËN

Le të meditojmë pak! Allahu i Madhëruar, gjallesat e llojllojshme që janë manifestim i cilësive të Tij, **“el-Bari/Filluesi”** dhe **“el-Musauuir/Formdhënësi”**, mund t’i kishte krijuar edhe në një botë tjetër që nuk mund ta shohim kurrë. Fakti që Ai i ka krijuar dhe, i ka krijuar në këtë botë, është mirësi e madhe për ne në aspektin e përfitimit prej



tyre dhe në aspektin e zgjerimit të horizontit tonë të medimit...

Gjallesat e tjera ushqehen vetëm me disa lloje ushqimesh. Kështu mund të na kishte krijuar edhe neve Allahu. Por, drithërat e ndryshëm, shumëllojshmëria frutave, e ushqime bimore dhe shtazore, janë vetëm disa prej mirësive të Tij të veçanta për ne...

Po ashtu, edhe lulet, trëndafilat, zambakët, manushaqet dhe tulipanët plot ngjyra, forma dhe aroma të ndryshme që i japin rehati shpirtit, janë prej mirësive të Tij të veçanta...

Edhe kafshët e udhëtimit janë mirësi e Tij...

Edhe bilbilat që i emocionojnë zemrat me zërat e tyre të bukur, janë mirësi e Tij...

Edhe pëllumbat që i zgjojnë ndjenjat tona me "hu-hu"-të e tyre, janë mirësi e Tij...

Zogjtë që udhëtojnë ndër-mjet kontinenteve sikur të kishin busulla dhe harta, janë arti i Tij...

Kafshët grabitqare dhe helmuese, gjarpërinjtë dhe akrepat, të cilët të kallin frikën me pamjet e tyre dhe të bëjnë të mendosh dënimin hyjnor, janë po ashtu arti i Tij...

Nëse Ai nuk do t'i kishte caktuar orbitat e Tokës dhe të Diellit dhe pozicionet e tyre ndaj njëri-tjetrit me një precizitet të lartë dhe nëse nuk do të ekzistonte pjerrësia prej 23,5 gradësh e Tokës, stinët nuk do të krijoheshin dhe nuk do të ndryshonin njëra pas tjetrës. Ky është një ekuilibër ekologjik madhështor...

Nëse Ai nuk do ta kishte vendosur shpejtësinë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj në atë që është aktualisht, dita dhe nata nuk do të vinin njëra pas tjetrës në atë mënyrë që ne kemi nevojë, por do të kishim ose vetëm ditë, ose vetëm natë.

Mirëpo, për shkak se ne jemi shumë të dobët t'i

mendojmë vetë të gjitha këto mundësi, Allahu i Madhëruar na pyet dhe na urdhëron që të meditojmë, duke thënë:

"Thua ju (o Muhamed): «Pa mendoni, nëse Allahu jua bën natën të përhershme deri në Ditën e Kiametit, cili zot, përveç Tij, do t'jua sillte dritën? Vallë, a nuk dëgjoni?»"

Thua ju (o Muhamed): «Pa mendoni, nëse Allahu jua bën ditën të përhershme deri në Ditën e Kiametit, cili zot, përveç Tij, do t'jua sillte natën, në të cilën qetësoheni? Vallë, a nuk shihni?»" (Kasas, 71-72)

Uji i pastër dhe i ëmbël, pa të cilin nuk do të ishim dhe as do të jetonim, mund të mos ekzistonte. Ashtu si ujërat e kripur e të hidhur që kanë mbushur oqeanet, edhe shiu që bie nga qielli mund të ishte i kripur dhe i hidhur. Mirëpo, Allahu i Madhëruar e pastroi atë me anë të një sistemi filtrimi madhështor dhe, në sajë të tij u gjallëruan kopshtet dhe vreshtat. Po ashtu, me anë të rrjedhave nëntokësore, Allahu e pasuroi ujin me minerale të rëndësishme për njeriun, e ëmbëlsoi, e begatoi dhe na gostiti me të. Për këtë arsye, Zoti ynë i Madhëruar, duke na kërkuar meditim dhe falënderim, me të drejtë pyet:

PËRSE NUK FALËNDERONI?

"A e shihni ujin që pini? Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo Ne e zbrisim? Nëse duam, Ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk falënderoni?!" (Uakia, 68-70)

Uji është i rrjedhshëm dhe i përkohshëm, ndërsa toka është thithëse... Nëntoka në thellësi është e përbërë nga shtresa të cilat njeriu nuk mund t'i arrijë... Ndërsa më në thellësi gjendet zjarr... Mirëpo, uji që bie nga qielli, nuk humbet. Por, po të humbte?

Allahu i Madhëruar paralajmëron:

"A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme?"

(Lukman, 20)

“Ne zbresim ujë nga qielli me masë të caktuar, pastaj e depozitojmë atë në Tokë. Por, nëse dëshirojmë, Ne jemi në gjendje ta heqim atë tërësisht.”
(Mu'minun, 18)

Zoti ynë pyet përsëri:

“Thuaj: «Mendoni: nëse ujërat tua ju shteren, kush (përveç Allahut) do t'ju sjellë ujë rrjedhës?!»”
(Mulk, 30)

Allahu i Madhëruar i dha ujit edhe një cilësi tjetër, në sajë të së cilës është bërë e mundur që ne të udhëtojmë me anije. Po sikur Zoti ynë të mos e kishte vendosur këtë ligj?

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Është Ai që ju ka vënë në shërbim detin, që ju të hani prej tij mish të freskët dhe të nxirrni nga ai stolitë që mbani. Ti sheh se si anijet e çajnë atë, që ju të kërkonin mirësitë e Allahut dhe të jeni mirënjohës.” (Nahl, 14)

Nëse lëshojmë goftë edhe një gur të vogël në det, ai menjëherë do të bjerë në fund të tij. Mirëpo, anijet me peshë prej mijëra tonelatash lundrojnë mbi ujë. Kjo, sepse ato anije mund të ndërtohen në atë mënyrë që të lundrojnë mbi ujë pa u fundosur, në sajë të ligjit të Allahut të Madhëruar, që i bën gjërat me densitet më të ulët se e ujit të shtyhen nga forca poshtë-lart.

Në fakt:

Në përgjithësi, teknologjia është frymëzuar prej artit të Allahut të Madhëruar, të cilin ka arritur ta imitojë dhe ta kopjojë.

Për shembull, vëllezërit Wright, të cilët prodhuan aeroplanin e parë, morën si model krahët e hutit. Me gjithë përparimin teknik, edhe aeroplani më i përsosur, është imitimi i përafërt i një zogu.

Aeroplanët prodhohen duke imituar shpendë të ndryshëm. Për shembull, avionët për distanca të shkurtra prodhohen duke imituar zogjtë e vegjël si harabelat, ndërsa aeroplanët për distanca të largëta prodhohen duke imituar fluturakët e dis-

tancave të largëta si lejlekët.

Le të mendojmë pak!.. Edhe pse njeriu zotëron mendje, zgjuarsi dhe dije të trashëguar brez pas brezi, për të arritur të imitojë këto krijesa, është dashur të kalojnë me mijëra vite.

Mirëpo, nga ana tjetër, një zog i sapo dalë nga veza arrin të fluturojë pas një kohe të shkurtër. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“A nuk shohin ata, se si shpendët fluturojnë pa mundim në hapësirat qiellore? Ato i mban vetëm Allahu. Kjo, në të vërtetë, është shenjë për popullin që beson.” (Nahl, 79)

Ndërsa struktura e krahëve të shumicës prej insekteve fluturuese, ende nuk është imituar dot nga teknologjia. Po ashtu, ka ende shumë gjëra prej artit hyjnor, të cilat njeriu nuk mund t'i imitojë. Ja, një dele apo një lopë që ha bar, pi ujë dhe jep qumësht!.. Le të ngrenë njerëzit një fabrikë dhe të përdorin të gjithë teknologjinë më moderne për të prodhuar qumësht nga bari dhe uji! E pamundur!

Ajri që thithim gjatë frymëmarrjes sonë, përmban oksigjen dhe azot në nivelet e përshtatshme për ne. Ajri është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për ne kudo që jetojmë.

Por, po sikur të mos ishte kështu? Po sikur oksigjeni të pakësohej dhe njerëzit të vuanin duke kërkuar ajër me oksigjen sa andej këndeje?

Gjithashtu, edhe frutat e perimet e llojllojshme prej të cilave kemi shumë përfitime dhe bota e gjithë bimëve, me lulet e së cilës qetësohemi shpirtërisht, ekzistojnë në sajë të aftësisë së fotosintezës që u ka dhuruar Allahu i Madhëruar. Por, po sikur të mos ishte kështu? Po sikur bota të ishte një vend tepër i thatë vetëm me shkëmbinj e male?

Edhe jetëgjatësia e bimëve dhe kafshëve është një lloj i veçantë meditimi. Përkrah bimëve një stinore, kemi edhe pemën e ullirit që mund të jetojë më tepër se njëmijë vjet.



Ndërkohë që fluturat mund të jetojnë rreth një javë, breshkat mund të jetojnë edhe më shumë se një shekull. Bleta jeton 45 ditë derisa i përfundon funksioni që ka. Çfarë ekuilibri ekologjik brenda një rregulli madhështor!..

Ka prej gjallesave që zhvillohen ngadalë, por ka edhe nga ato që zhvillohen shpejt dhe janë ushqim për gjallesat e tjera. Edhe kjo është një urtësi më vete. Gjithashtu, edhe në ardhjen në këtë botë, tek krijesat ka një harmoni/ekuilibër në sasi.

Le të marrim një lloj kafshe! Nëse prej një lloj gjallesë do të dërgoheshin në këtë botë të gjitha përnjëherësh, ato që kanë ardhur dhe ato që do të vijnë deri në fund të botës, Toka jo vetëm që nuk do të mjaftonte vetëm për atë lloj kafshe, por as ushqimi nuk do të mjaftonte për to. Mirëpo, Allahu i Madhëruar në sajë të misterit të kohës, i shpërndan ato në një formë më të gjerë se sa është hapësira duke i krijuar me ligjin e një zinxhiri. I njëjti ligj vlen për të gjitha gjallesat. Për rrjedhojë, në sajë të misterit të kohës dhe hapësirës, bota bëhet skena e trilion fish më tepër krijesash se kapaciteti normal që ka.

Në këtë mënyrë, edhe ardhja e krijesave në botën tonë, ndodh në bazë të një ekuilibri kufizues. Për shembull, dihet se një pemë rrap i çdo vit prodhon me miliona fara, të cilat në sajë strukturës së tyre më të lehtë se një pupël dhe në formë parashute, ato shtyhen nga erërat deri në vende shumë të largëta.

Nëse çdo farë që del vetëm prej një rrap i do të kishte mundësinë të bëhej një rrap i ri, nuk do të kalonte shumë kohë kur çdo vend i tokës i përshtatshëm për bimët, do të pushtohej plotësisht nga pemët e rrapit. Pra, gjithë kjo tokë do të ishte e ngushtë edhe vetëm për një lloj peme. Të njëjtin shembull mund t'ia përshtatim edhe krijesave të tjera. E gjithë kjo, tregon ekzistencën e një harmonie dhe ekuilibri që nuk mund të perceptohet lehtë me mendje.

Edhe kafshët që shtohen me shpejtësi, nuk arrijnë ta pushtojnë botën, sepse shumë krijesa të tjera në natyrë ushqehen me to, duke siguruar kështu ekuilibrin e përsosur.

Por, kush e siguron këtë?

Në dukje, nuk shihet ndonjë administrues i pyjeve, i deteve, apo i maleve. Mirëpo, çdonjëri prej tyre vepron brenda një harmonie të plotë me urdhrin e Allahut të Madhëruar. Të gjitha tregojnë bindje dhe nënshtrim. Flutura, nuk thotë kurrë, *“përse jeta ime zgjat një javë, ndërsa ajo e breshkës një shekull?”*. Të gjithë janë të kënaqur.

Kafshët prej të cilave përfitojmë mishin dhe qumështin, nuk i rebelohen njeriut dhe nuk tregojnë koprraci. Nga ana tjetër, një elefant gjigand mund të tërhiqet edhe nga një fëmijë. Kush është Ai që i bëri ato të bindura ndaj njeriut dhe ia vuri ato në shërbim?

Po sikur të mos i bënte të bindura?

Mbrojtësit e krijimit rastësor dhe evolucionistët, pretendojnë në mënyrë të palogjikshme, se krijesat e kanë zhvilluar vetveten në bazë të dëshirave dhe nevojave të veta, brenda kushteve të ambientit ku jetonin.

Por, cila krijesë do të zgjidhte një jetë të shkurtër e do të kënaqej me të?

Cila krijesë do të pranonte me vullnetin e vet të bëhej furnizimi (ushqimi) i një krijese tjetër?

Le të mblidhen të gjithë njerëzit dhe t'ia zgjasin jetën një njeriu që sapo i ka mbaruar, duke ia shtuar edhe një shekull! E pamundur! Është e pamundur t'ia shtyjnë qoftë edhe një sekondë përtej asaj që është caktuar!

Sepse çdo krijim bëhet me caktimin e Allahut...

“...Asnjë gjethe nuk bie, pa dijeninë e Tij dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh).” (En'am, 59)

Allahu i Madhëruar na kujton:

“A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme? E megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyesi dhe pa libër ndriçues.” (Lukman, 20)

SEMI DHE BASIR

PËRGJËRIM DREJTUAR ATIJ QË DËGJON DHE SHEH ÇDO GJË

Ilir Hoxha

O Allah! Dija Jote përfshin çdo gjë. Ti dëgjon atë që nuk e dëgjon kush dhe sheh atë që nuk e sheh kush. Për Ty nuk bën dallim nëse diçka është bërë fshehtas apo hapur, nëse një mendim është thënë me pëshpëritje apo me zë të lartë, e madje edhe nëse ai mendim nuk shprehet me fjalë, por ngelet përbrenda. Për Ty nuk përbëjnë asnjë pengesë gjërat që janë pengesë për shikimin dhe dëgjimin tonë, si errësira-drita, afërsia-largësia, madhësia-vogëlsia, etj... E fshehta dhe e hapura, e folura dhe heshtja janë të njëjta për Ty. Ti sheh edhe milingonën që lëviz mbi një gurë të zi në një natë të errët dhe ujin i cili përzihet me një ujë tjetër. Fakti që unë e di se Ti je i tillë, më jep paqe e qetësi, për aq kohë sa nuk bëj gjëra që duhen fshehur dhe prej të cilave duhet të kem turp. Këtë paqe e ndiej vetëm nëse kam jetuar i pastër aq sa për të hapur duart dhe me përlulje të strehohem tek emrat e Tu të bukur Semi dhe Basir. Unë e di se Ti sheh, dëgjon dhe regjistron çdo gjë që më është bërë mua dhe që nuk kam mundur ta pengoj.

Mirëpo, kur unë bëj gjëra të pahijshme për t'u dëgjuar apo shikuar, atëherë fakti që Ti je Semi dhe Basir, kam frikë se është një kërcënim për mua. Çfarë do të bëja unë nëse nuk do të ishte tërësia e emrave të Tu, që plotësojnë njëri-tjetrin? Pra, çfarë do të bëja unë nëse në këtë situatë nuk do të strehohesha tek emrat e Tu Tevvab, Gaffar dhe Afuvv? Si do të jetoja me turpin e punëve të mia të shëmtuara që nuk mund të dalin para Teje?

Ti, Vetën Tënde e ke cilësuar si "Semi'u'd-Dua / Dëgjuesi i lutjeve". (shih. Al-i Imran, 38.) Ti na ke njoftuar se dëgjon çdo përgjërimit tonin që të drejtohet. (Shih. Bekare, 186.) Kur bëhet fjalë për Ty, "dëgjimi" zhvishet nga e zakonshmja. Atë që dëgjon Ti, e kupton dhe nuk e lë pa përgjigje, sepse Ti, edhe pse

ne jemi robër me të meta, na ke urdhëruar që të mos të neglizhojmë asnjë përgjërimit që vjen në veshin tonë. (shih. Duha, 10.) O Ti që mban në duar çelësat e qiejve e të tokës! (shih. Shuara, 12.) Ti na ke bërë të ditur se i dëgjon lutjet tona. A nuk do të thotë kjo se Ti i pranon ato? (shih. Muxhadele, 1.) Për këtë shkak edhe ne kemi mësuar nga Profeti ynë (a.s.), të mbarojmë çdo lutje tonën me këtë fjalë: "O Allah! Ti dëgjon çdo dua!" Me këtë fjalë e kanë mbaruar lutjen edhe profetët në Librin Tënd. Prandaj edhe ne kemi mësuar se emri Yt Semi, është shkak i pranimit të duave tona. (shih. Al-i Imran, 38; Ibrahim, 39.)

Profeti ynë (a.s.), na ka mësuar që sa herë të jemi para Teje, të fillojmë me falënderim. Çdo rekat të namazit e fillojmë me falënderim dhe pasi e kemi përsëritur fjalën Tënde, përkulemi me nderim. Dhe kur ngrihemi nga rukuja, themi "Semiallahu li men hamideh / Allahu dëgjon atë që falënderon", si një myzhde për ne. Kur e themi këtë fjalë, në fakt kemi thënë, "Allahu e pranon adhurimin e atij që e falënderon dhe e lavdëron Atë". Pra dijetarët tanë na thonë se nëse Ti e dëgjon një përgjërimit, do të thotë se Ti e ke pranuar atë. Kështu e dimë dhe kështu besojmë edhe ne, sepse edhe Profeti ynë (a.s.), fjalën "semi" në lutjet e veta e ka përdorur në kuptimin "të pranosh": "O Allah! Strehohem tek Ty prej zemrës që nuk drithërohet, prej duash që nuk pranohet (dëgjohej), prej egos së pangopur dhe dijes së padobishme!" (shih. Tirmidhi, Deauat, 68.)

Kur na prezanton Vetën në Librin Tënd, pranë emrit Semi, qëndron ose emri Basir, ose emri Alim. Të jem në prezencë të Zotit tim që gjithmonë më dëgjon, më sheh dhe më njeh në mënyrë të përsosur, të di që çdo punë e bëj në prezencë të Tij dhe të jem gjithmonë i vetëdijshëm për këtë, siç na ka mësuar edhe Profeti

Yt (a.s.), është mënyra për të arritur “gradën e mirësisë”. Ai që e di se Ti sheh gjithçka, do të përpiqet të korrigjojë çdo gjendje të tij, të hapur apo të fshehtë. E në këtë mënyrë do të rritet grada e myslimanit. E në fakt, kur njeriu sillet në mënyrë të hijshme para Allahut, ai vendoset në qoshe pranë Tij. O Zot! Nëse Ti do manifestoheshe tek ne me këto emra, shikimi ynë do të zgjerohej dhe tashmë nuk do të shihnim vetëm atë që shihet me sy, por edhe atë që shihet me zemër. Nuk do të dëgjonim vetëm atë që thërret, por edhe atë që lëshon britma të heshtura. Po ashtu, do t’i dëgjonim e do t’i kuptonim bukur e mirë edhe njerëzit që na ke lënë amanet.

O Zot! Ne kemi nevojë të shohim e të dëgjojmë drejtë edhe për të vendosur në vend drejtësinë që pret prej nesh, edhe për treguar mëshirën dhe dhembshurinë tonë! O Zot! Na e mpreh shikimin dhe na e forco dëgjimin, me qëllim që t’i vlerësojmë të gjithë ashtu siç duhet. Në këtë mënyrë, ajo që dimë, nuk do të mbështetet në pandehma, por në të vërteta dhe çdo njeri do ta vendosim në vendin e duhur. Me këtë dëgjim dhe shikim, do t’u bëheshim shërim atyre që vuajnë, do të shihnim e do të dëgjonim bukuritë e fshehura dhe do të kënaqeshim me to!

O Zot! Ti na premtove se nëse ne do të afrohem me Ty me adhurim dhe devotshmëri, do të bëheshe syri ynë që sheh, dora jonë që mban dhe këmba jonë që ecën. Nëse bëhemi të tillë, kushedi se çfarë do të shohim e do të dëgjojmë!? Kushedi se sa mirësi na iki prej duarve për shkak të shikimeve tona të ndotura me gjynah. (shih. Jasin, 9.) Kushedi se sa robër të Tu të dashur nuk arrijmë t’i shohim e t’i njohim vetëm për shkak të shikimit tonë të ndotur. Nëse e ruajmë syrin dhe veshin tonë nga gjërat e palejueshme, do të fitojmë dashurinë Tënde dhe, nëse e fitojmë atë, do të mund t’i përdorim siç duhet këto shqisa. Na e bëj të mundur o Zot!

Për shkak se ai na ndriçon që ne të shohim të vërtetat, Ti i quajte “*besair*” ajetet e Librit Tënd. (shih. A’raf, 203.) Ndërsa ata që nuk e përlyejnë veten me gjynahe dhe ndjenja egoiste, por veprojnë me dritën e mendjes dhe të besimit, e i shohin të vërtetat e kësaj bote dhe të botës tjetër në mënyrë të hapur, Ti i cilësove ata si “*ulu’l-ebzar*”. (Al-i Imran, 13.)

O Zot! Na ndriço edhe neve me ajetet e Tua dhe na bëj prej atyre që e kanë të hapur syrin e zemrës dhe të cilët Ti i ke lavdëruar në Librin Tënd! Ashtu si në të gjitha mirësitë e Tua, edhe në këtë mirësi, çdo rob ka pjesë të ndryshme. Por Ti na e shto pjesën tonë o Zot! Dhe kur të fillojmë të shohim me syrin e zemrës, mos na lër të harrojmë kurrë se të vërtetën absolute nuk mund ta mësojmë prej askujt tjetër përveçse prej Teje!



PSIKOLOGJIA DHE PREHJA


BASHKË ME MINUSET
DHE PLUSET E TYRE

✧ *Kybra Ergin* ✧

Problemi më i madh i shkencës së psikologjisë bashkëkohore është kontradikta që njeriu bën vetë kur pretendon se duke i vënë normë tjetrit e edukon dhe e mëson atë. Shkenca e psikologjisë moderne nuk i jep edukatë njeriut, sepse teoria ideologjike mbi të cilën është bazuar ajo e vlerëson njeriun si një copë frymor që ka evoluar brenda natyrës së vet. Kësisoj, ashtu sikurse nuk mund të vendosim kod etik sjelljeje, ndonjë lloj manuali mbi mirësjelljen për majmunët, po ashtu as njeriut s'mund t'i vendosim ndonjë rregullore sjelljeje. Madje, Frojdi dhe simpatizantët e tij janë përpjekur të pengojnë dhe të shtypin instinktet elementare dhe janë munduar t'i paraqesin si burimi i sëmundjeve. Ende sot vazhdon i njëjti botëkuptim; jepen rekomandime të gabuara, si për shembull; kur t'i mësohet fëmijës sjellja e shkuarjes në tualet, duhet sjellë me shumë tolerancë, pasi fëmija në të ardhmen mund të bëhet me shumë vese.

Krahas këtyre, njeriu i cili, si pasojë e edukimit jofetar që merr, është tëhuajësuar ndaj krijimit të vet, pas industrializimit është zhvlerësuar brenda jetës urbane; ndërkohë që kërkon një degë ku të kapet pasi bie në depresion, psikologët tashmë në një farë mënyre janë bërë si udhërrëfyesit e Ahirzamanit. Psikologët, në vijim të kësaj nevojë, marrin stilolapsin që t'u japin shënimet përkatëse pacientëve që u kërkojnë ndihmë dhe për t'i shëruar pacientët në fjalë kanë zhvilluar disa lloj terapish.

Kur shohim të kaluarën e metodave të psikoterapisë, vërejmë se ato bazohen në teori që janë në kundërshtim me njëra – tjetrën. Mënyra se si qasen ndaj njeriut ka bërë që secila prej tyre të dalë si reagim ndaj tjetrës. Për shembull; teoria psikologjike e analizimit të pacientëve dhe e përpjekjes së shërimit të tyre përmes hipnozës, këshillimit, psikanalizës etj., pretendon se gjithçka



lidhet me kujtimet që shqetësojnë, të cilat janë përjetuar në kohën e fëmijërisë dhe që janë hedhur në të pavetëdijshmen. Në këtë mënyrë, duke i bërë një analizë të thelluar të pandërgjegjshmes arrihet në disa konstatime të caktuara jo shumë të sigurt, bëhen stigmatizime. Kështu, shpeshherë njerëzit mësojnë (!) se si prindërit e tyre ua kanë shkatërruar jetën duke bërë sjellje të gabuara ndaj tyre kur kanë qenë të vegjël, kështu i bëjnë përgjegjës këta njerëz që kanë dhënë aq shumë për vite të tëra. Po ashtu është kritikuar mjaft fakti që fajësohen padrejtësisht prindërit kur disa njerëz manifestojnë sjellje të çrregullta për shkak të ndonjë dëmtimi që kanë në tru.

Kësisoj, metodat e ndryshimit të sjelljeve konjitive që lindin si reaksion ndaj këtyre metodave, zakonisht hedhin shikimin brenda çastit të cilin jetojmë dhe, duke u përpjekur për t'i dhënë një kuptim anormal dhe të tepruar një gjëje apo një fenomeni, çfarëdolloj shkak që të ketë njeriu, përpiqet të rregullojë sjelljen e sëmurë. Madje, nganjëherë pa ngecur fare tek shkaqet shikon që të pakësojë sjelljen e gabuar dhe të fitojë sjellje të drejta vetëm përmes disa ushtrimeve të caktuara. Ky botëkuptim mund të pranohet më shumë si një rezultat i nevojave praktike, që përpiqen ta edukojnë atë, megjithëse nuk posedon një besim apo një pranim mbi ato se çfarë duhet të ketë dhe se çfarë mund të jetë njeriu.

Mirëpo edhe kjo metodë është larg së treguari të një objektivi. E gjithë përpjekja e terapive të sjelljes duket sikur është tek realizimi i stabilitetit.



E rëndësishme është që njeriu të mund të kalojë jetën e përditshme, të mund të shkojë në punë, të mund të punojë, të mund të vazhdojë jetën e tij familjare. Madje, në përkufizimet e sëmundjes dhe çrregullimit, bie në sy kjo shprehje:

“Frika, droja, pengesa etj., çfarëdo qoftë ankesa, të qenit e saj e fuqishme apo e zgjatur sa të mund ta pengojë jetën e përditshme të njeriut...”

Sikur, “njeriu ideal” është ai që shkon nga shtëpia në punë, nga puna në shtëpi, që dëfrehet me shoqëri, që flet broçkulla, që ka disa argëtime që kënaq veten. Madje, një njeri që nuk e tepron me gjëra sa të pengojë jetën e punës, mund të përdorë lëndë që mund ta qetësojnë. Mundet që ta shpenzojë jetën e tij duke vrapsuar pas karrierës dhe posteve, që përjeton marrëdhënie që i japin kënaqësi, të cilat mund ta dëfrenjë dhe mund ta emocionojnë. Këto janë normale dhe, për njerëzit që bien në depresion duke mos u mjaftuar me aq sa kanë, duhet gjetur menjëherë një rrugëdalje dhe sërish u duhet mundësuar përjetimi i së njëjtës vorbull përditshmërie.

Një pjesë e konsiderueshme e pacientëve që shkojnë tek psikologët, u drejtohen psikologëve duke u thënë:

“Nuk kam asnjëfarë çrregullimi në sjellje, asnjë lloj vesi, asnjë fobi, as frikë, por nuk arrij dot të kënaqem nga jeta. Pasi, jetën e kam shumë të pakuptimtë. Nuk e di çfarë duhet të bëj, si duhet t’ia bëj...” Kështu, psikologët kanë shpikur një tjetër terapi:

“Psikoterapia ekzistencialiste”

Sjelljet në këtë terapi nuk depërtojnë në kujtimet e fëmijërisë e as nuk jepen detyra shtëpie. Përgjithësisht, përmes metodës së terapisë së grupit, një grup njerëzish në depresion flasin nën vëzhgimin e psikologut. Pjesë e bisedës së tyre janë tema mjaft esenciale si; rolet dhe identitetet që merr njeriu gjatë rrjedhës së jetës si dhe tema të rënda si uni ynë përtej roleve në jetë, liria, vdekja etj. Mirëpo, fatkeqësisht me këtë metodë i thonë si të kërkosh gjilpërën në kashtë apo si të kërkosh vrimën e gjilpërës në errësirë, pra një përpjekje e kotë. Shpeshherë bisedat e tyre janë vetëm një e folur jerm. Pasi, është e pamundur që mendja e njeriut të arrijë të gjejë vetëveti të vërtetën, mbi të gjitha, kur nuk përpiqet fare ta kërkojë të vërtetën akoma më e pamundur. Arsyeja pse po themi “kur nuk përpiqet fare ta kërkojë” është sepse filozofia ekzistencialiste që në krye të herës shprehet se; “Jeta nuk ka ndonjë kuptim, njeriu nuk ka ndonjë qëllim. Njeriu i jep kuptim jetës dhe vetes ashtu sikurse ia ka ënda”. Duke mbajtur këtë qëndrim, të gjitha shpresat i hedh në greminën e pafund të nihilizmit.

Sipas psikologëve që përkrahin këtë filozofi;

“Njeriu, ngaqë është qenia e vetme që është e ndërgjegjshme për unin e vet, është në një depresion të thellë. Njeriu është i lirë dhe për shkak të kësaj lirie, të gjitha përgjegjësitë i mban mbi supet e veta.”

Kjo qasje, e cila e percepton njeriun si një qenie që jeton në një vetmi tejet të padurueshme, larg të tjerëve dhe nën peshën që nuk mund ta mbajë, ashtu siç mund të parashikohet, nuk mund të thuhet se ka qenë e suksesshme në sjelljen e ndonjë zgjidhjeje për pacientët, të cilët presin një zgjidhje sa më urgjente. Kësisoj, shumica e psikologëve, përpiqen të ndihmojnë përmes metodave relaksuese të marra hua nga fetë e Lindjes së Largët.

Mund ta zgjasim edhe më tej listën, por le t’i biem me shkurt:

Ndërkohë që mendja e njeriut është një organ i thjeshtë shqisor që njeh, percepton dhe analizon vetëm një pjesë të botës shpirtërore, ndoshta vetëm lëvoren e saj dhe ndoshta vetëm botën materiale; atëherë kur njeriu ngrihet të përkufizojë botën shpirtërore, si në rastin kur të verbrit përkufizojnë se çfarë ishte elefanti, bëjnë të njëjtin gabim. Natyrisht që ka fusha ku funksionon studimi përmes arsyetimit mbi shëndetin psikologjik të njeriut. Sot përmes PET, SPECT, MEG, f-MR dhe aparaturave të tjera mjekësore, mund të analizojmë qendrat e trurit dhe hormone, të cilat ndikojnë në ndjenjat dhe sjelljet tona. Mund t’i mbledhim informacionet në fusha të ndryshme, përmes metodave të ndryshme, si anketat, testet, statistikat dhe analizat e ngjarjeve.

Mirëpo këto të dhëna që na akumulohen para nesh porsi një mal i madh, nuk na japin të dhënë themelore, të cilën mund ta ndërtojmë mbi jetën tonë, që mund ta formësojmë veten tonë sipas saj, e cila mund të na udhëheqë kur përdorim vullnetin tonë:

“Përse ekzistojmë ne? Përse ekziston gjithësia? Përse i jetojmë këto? Çfarë do të ndodhë në fund të tyre? Atëherë, çfarë duhet bërë dhe si duhet të sillemi? Si duhet të veprojmë që të vlerësojmë mirë jetën dhe të mund të jemi njerëz të mirë, të vërtetë?”

Përkundrazi, të dhënat që kemi, na drejtojnë më shumë nga:

“Njeriu është një qenie, ndryshe nga gjallesat e tjera, si nga aspekti fizik, po ashtu edhe nga struktura shpirtërore e cila administron trupin. Njeriu ka një prirje për t’u drejtuar nga lartësimi i ndjesive dhe mendimeve sublimë, që administron instinktet që vijnë nga trupi. Veçanërisht vlerat morale të të vjetërve, stili i jetesës, praktikat shpirtërore ndikojnë që të zbulohen këto prirje... Atëherë, mos vallë ato dinë diçka që ne nuk dimë?”

Sot me orientimin e këtij mendimi; në shumë vende të botës, disiplinave të mbetura nga fetë e vjetra, po u bëhen studime shpirtërore, po praktikohen duke i modernizuar. Mirëpo edhe këto janë larg paraqitjes së të vërtetës mbi njeriun dhe larg të treguarit të rrugëve të lartësimit që kërkon njeriu.

Ekziston një nevojë e thellë që nuk arrin dot të shpalosë rrugëzgjdhjen dhe nuk arrin ta përkufizojë në mënyrë të duhur asnjë shkollë të psikologjisë, që bën studim mbi nevojat psikologjike të njeriut:

Njeriu ndjen nevojën e zhvillimit porsi një embrion në mitrën e kësaj bote dhe lindjes në botën tjetër në formë të përsosur. Për të arritur këtë përsosje, ndjen një uri shpirtërore ndaj vitaminave që shpirtit i nevojiten. Të gjithë studimet psikoterapeutiste nuk kanë arritur ndonjë sukses tjetër përveç punës së shtypjes së gjërave dytësore të kësaj urie.

Mirëpo, nuk mund të thuhet se shkenca e psikologjisë nuk ka arritur asnjë lloj suksesi. Pesë natyrat e mëdha të personalitetit (Big Five) janë një shembull për këtë. Realisht është një studim që përmban vlerë. Nëse do të thelloheshim më tej, do të vërenim se Pejgamberi ynë (a.s.), si mësuesi më i përsosur i njerëzimit, i bartte këto cilësi në mënyrën më të përsosur të mundshme dhe i stolisi shokët e tij të ngushtë me këto cilësi sublimë.

Emrat në anglisht të këtyre pesë faktorëve që lartësojnë njeriun dhe rrisin cilësinë e jetës së tij, janë: Openness to Experience, Conscientiousness, Extraversion, Agreeableness, Neuroticism, që mund të përkthehen si: I hapur drejt Përvojave, Përgjegjësia, Ekstravert, Pajtueshmëria dhe Neurotika.

Tipari që përkthehet si i hapur drejt përvojave, do të thotë: të mos jesh i mbyllur brenda një trajte të caktuar mendimi, të jesh njeri që mirëkupton, njeri i hapur për dije të reja, për përvoja të reja, i hapur për të zhvilluar pikëpamjet... Një hapje ndaj një fillimi krejtësisht të ri me Atë, duke lënë çdo praktikë të vjetër...

Përgjegjësia, që është si tipar i dytë, sikur i vendos një kornizë, një masë mendimit të kësaj “hapjeje ndaj të rejave”. Gjendja e të qenit i hapur ndaj të rejave, nuk duhet kuptuar si devijim ndaj përgjegjësive mbi vlerat morale, mospërfillje, moskokëçarje dhe të kapurit e jetës sipas ëndjes. Përkundrazi, duhet kuptuar si vetëdijësim për përgjegjësitë që ka, për detyrat që kryen, madje një njeri që bën detyrën e vet në mënyrën më të mirë të mundshme, në mënyrë të përsosur, njerëz që ndiejnë veten përgjegjës jo vetëm për gjërat e tyre personale, por edhe për gjërat që e interesojnë njerëzimin, atëherë mund të konsiderohet njeri me personalitet. Këto cilësi që përmendëm, i shohim në jetën e Pejgamberit tonë të nderuar (a.s.) dhe në jetën e shokëve të tij fisnikë. Një shoqëri e mrekullueshme, që ndiente përsipër përgjegjësinë për tërë ymetin që do vinte deri në Kiamet dhe që sakrifikonte jetën për të lënë pas një etalon virtyti.

Një njeri që është i hapur ndaj kontaktit me rrethin e afërm dhe të largët... Është një njeri që për çdo punë që bën konsultohet me njerëzit e duhur, nuk ecën sipas opinionit vetjak, por duke marrë dhe dhënë dije... Enesi (r.a.), lidhur me Pejgamberin (a.s.), ka thënë kështu:

“Nuk kam parë njeri më të dhënë pas konsulencës sesa i Dërguari i Allahut.”

Një tjetër trajtë që e plotëson këtë cilësi sublimë është edhe sjellja në harmoni, paqeruajtës. Njeri që nuk ecën me mendjemadhësi dhe moskokëçarje, përkundrazi një njeri me zemër të butë, i dashur, modest dhe solidar. Ai është një personalitet në zenit mbi këto çështje...

Si përfundim, të qenit i qëndrueshëm, që mund ta përkthejmë si të qenit në prehje me botën e brendshme, i qetë, i kthjellët dhe i ekuilibruar; mos të ndikuarit në mënyrë të ekzagjeruar nga ndikimet e brendshme dhe të jashtme. Të kesh cilësi si durimi, qëndrimi, tolerimi dhe cilësi të tjera të larta. Në krye të asaj detyre të vështirë, ndonëse po kalonte sprovat e llojllojshme, ai kurrë nuk u lëkund, qëndroi porsi një mal gjakftohtë. Ashtu sikurse i kishte thënë edhe Siddiku:

“Ti ishe porsi një mal, i palëkundshëm...”

Ja pra pika ku ka mbërritur shkenca e psikologjisë:

Fundi i këmbëve të mësuesit, të cilin e ka dërguar Allahu...

Të kujtosh që të jetosh

Edison Çeraj

Çfarë kuptimi dhe çfarë roli ka vërtetësia në një rrëfim letrar? A është e mjaftueshme të bazohesh vetëm tek ajo?

Për disa përgjigjja është po, pra është e mjaftueshme, duke u nisur nga ideja se lexuesi ka nevojë për përvoja reale, konkrete. Për disa të tjerë jo, sepse përndryshe është kronikë ose raport. Sipas këtyre të fundit një e vërtetë e caktuar duhet veshur “me stil”, ngaqë nëse e vërteta shfaqet lakuriq atëherë do të nënvlerësohet ose përçmohet.

Kështu, në këtë pikë, më shumë sesa me një çështje letrare kemi të bëjmë me një çështje të etikës. Pavarësisht se autorë të ndryshëm mendojnë se krijimtaria artistike e tejkalon etikën, dhe si e tillë ajo nuk mund t’i nënshtrohet një gjykimi eksplicit të etikës, prapëseparapë, në fund të fundit çdo vepër përmban një mësim, mesazh apo kumt, i cili, tërthorazi apo haptazi, lidhet edhe me etikën.¹

Po ashtu, një tjetër diskutim që rrjedh që këtej është edhe marrëdhënia mes rrëfimit letrar dhe atij historik.

Autori i *E nesërmja dje dhe sot*, për nga formimi dhe nga përvoja është i lidhur me disiplinën e historisë, dhe kjo është një e dhënë që meriton vëmendje.

Në thelb, një historian operon në rrafsh sasior, pasi atij i interesojnë sa më shumë të dhëna për një çështje të caktuar; ndryshe nga një poet apo shkrimtar i cili i anashkalon të dhënat për të rrokur thelbin, ose i kthen ato në veshje për thelbin. Historiani është i përfshirë nga e vërteta jashtë tij, kurse artisti te e vërteta brenda tij. Këto janë dy të vërteta krejt të ndryshme, por jo në luftë me njëra-tjetrën. Dhe pikërisht ngaqë nuk janë në luftë, Nazarko sikur përpiqet t’i takojë sadopak me njëra-tjetrën.

Vepra në fjalë ka një natyrë autobiografike, e cila merr trajtë nëpërmjet rrëfimit në vetën e tretë. Meqë ra fjala, çdo rrëfim, poezi apo prozë qoftë, në një mënyrë apo në një tjetër mbetet autobiografik; ashtu sikurse çdo portret në pikturë është edhe autoportret në të njëjtën kohë.

Një vepër arti është e vërtetë ngaqë transmeton një të vërtetë, por këtu nuk bëhet fjalë për një të vërtetë apo të vërtetë në kuptimin e parë/zakonshtëm, por për të vërtetë të cilat e ndihmojnë njeriun për të njohur veten. Pra, vërtetësia që nënkuptojmë këtu lidhet me mundësinë që i jep njeriut për t’iu afruar vetes, për t’u thelluar; për të ndërtuar një mendim kritik; për të kuptuar se të gjalluarit dhe të jetuarit janë dy gjëra të ndryshme, pavarësisht lidhjes ndërmjet tyre; për të kuptuar që njeriu është më shumë se *zoon politikon*²; për të kuptuar se njeriu ka diçka nga kafsha por edhe nga engjëlli e të tjera të kësaj natyre.

Por, në rastin e rrëfimit të Nazarkos kemi të bëjmë më shumë me vërtetësinë në kuptimin e parë dhe të njohur të fjalës; një vërtetësi e cila synon të na japë një përvojë konkrete, në një linjë të brishtë kronologjike, e psonisur me merak historiani. Është një rrëfim që i ruhet dhe ndoshta i druhet ndërmjetësimit të një metafore. Kjo na bën të mendojmë (por jo edhe të besojmë) se, sipas autorit, me gjasë, rrëfimi i shtruar dhe pa dorashka është vetë metafora, vetë stili, formë dhe përmbajtje e njësuar në emër të një nevojë metafizike për të komunikuar dhe ndarë me të tjerët një peshë që zakonisht është e pamundur ta mbash vetë.

Mund të listojmë shumë përgjigje për pyetjen se çfarë e shtyn njeriun të rrëfejë, por, besoj se një gjë është e sigurt: çdo rrëfim është kujtesë.

Mbase rasti më proverbial në këtë drejtim është Don Kishoti i Mançës, ku e shkuara e çdo njeriu, cilado qoftë ajo, pavarësisht përkufizimeve apo etiketave që mund t’i vendosin të tjerët apo vetë ne me kalimin e kohës, mbetet kujtesë dhe meriton të mbrohet me çdo kusht. Ajo as nuk adhurohet dhe as nuk mohohet.³

Të kujtosh është kusht për të kuptuar kush je dhe cili mund apo duhet të jesh.

Pikërisht kjo është zona më gravitacionale në rrëfimin e Nazarkos, ku edhe vetë titulli, *E nesërmja dje dhe sot*, shënon një aludim të qartë: për të njohur të nesërmen tonë kemi nevojë të kujtojmë të djeshmen.

1. “Religjioni, morali dhe arti ushqehen nga i njëjti trung gjenalogjik.” (Izetbegović)

2. “Kafshë politike”.

3. “Çdo shenjt ka një të shkuar dhe çdo mëkatar ka një të ardhme.” (Wilde)

Vegjetativët



Nuredin Nazarko



Jo rrallë ndodh që të përfshihemi nga ndjesi pësh-tjelluese. Pështjellohemi dhe më pas shqetësohemi për të gjetur pak qetësi e rehati. Nuk jemi duke u vramundur shumë nëse mund të gjendet rehati e qetësi në këtë muzgëtitirë, por gjithsesi shpresojmë. Ka syresh që edhe kur shpresojnë për pak qetësi e rehati, shqetësohen nga mendimet për tu implikuar me ndonjë punë të caktuar. Iu hanë duart edhe atëhe-rë kur duhet të pushojnë. Nëse nuk do të kishte natë për tu qetësuar, ndoshta nuk do të kishte pushim e qetësi për këto natyra.

Si antipod i këtyre janë ca syresh të tjerë që i vetmi shqetësim që kanë është rehati pa limit. Rutina e tyre ditore është plotësisht e përputhshme me sloganin që po ata vetë e kanë shpikur me gjenialitetin e tyre, *gjumë-kafe-shëtitje-kafe-gjumë*.

Një formulë jetësore tepër shpresëdhënëse kjo. Kush implikohet nga energjia që çliron aplikimi analitik i saj ndihet i relaksuar dhe i çliruar nga problemet e muzgëtitirës aktuale. Gjenialët më me fat janë këta. Këta janë edhe shpikësit e sloganit, po edhe jetojnë sipas sloganit që vetë kanë shpikur. Janë me fat se jo rrallë herë ndodh të bashkohet kaq pastërtisht dhe me kaq singeritet fjala e thënë dhe vepra e kryer.

Ata syresh anakronikë që janë implikuar nga dë-shirat e çmendura për punë e shqetësime edhe kur

gjejnë paksa qetësi, duhet t'i thërrasin mendjes. T'i vendosin gishtin kokës e ta mendojnë seriozisht the-llësinë filozofike të këtij sloganit. Madje, pse edhe të mos angazhohen për të bërë studime rreth efekteve të mrekullueshme që mund të sjellë në jetën e nje-riut ky slogan. Po kjo punë të mos lihet me kaq. Pse të mos shtyhen edhe më tej dhe të krijohet edhe Akademi Mendimi për këtë perlë të çmuar, që këta zhytës të thellësive e nxorën në sipërfaqe.

Paskëndaj të ndërtohet dhe Muzeu i Mendimit mbi zhytësit e thellësive që brezat e rinj të kenë ç'të mar-rin për shembull e model. Brezat e rinj duhet të ndihen krenarë për gjenialitetet që iu kanë para-prirë. Janë lodhur e kanë vrarë mendjen ditë edhe natë këta gjenialë si e si t'i ndihmojnë njerëzisë në procesin e iluminimit. Është mëkat të mos u jesh mirënjohës përjetë. Duhet të përulen para veprës së tyre madhështore. Të caktohen edhe data për-kujtimore për këtë akt madhor. Data e ngjizjes së sloganit të shpallet festë kombëtare. Festimet të zgjaten derisa gjumi t'i marrë festuesit. Të vend-osen edhe kurora me lule në monumentin që do të ngrihet posaçërisht për këtë slogan nga skulptorët më të zellshëm dhe më duarartë të Akademisë së Mendimit. Kurorat duhet të ndërrohen çdo ditë e të jenë të freskëta dhe me vesë mëngjesore, që të faptijnë nga dielli mëngjesit. Kushdo që t'i shohë




të çmeritet e të mbetet gojëhapur nga zelli që zien ndër dejet e këtyre syresh. Nuk janë çështje me të cilat mund të bësh shaka. E ke të pamundur të mos i marrësh seriozisht në seriozitetin e tyre. Edhe po të duash, të imponojnë me konsekuencën e tyre në zbatimin e sloganit.

Këto gjenialitete duhen kërkuar me kandil ditën nëpër diell. Duhet tu qasësh si çiraku të zotit. Duhet të jesh i aftë ta përfitosh gjenialitetin e tyre në heshtje, duke mos prishur aspak qetësinë me pyetje që pa frikë mund t'i klasifikojmë si peraqende. Po nuk mund të sillen njerëzia kaq shpërfillës ndaj gjenialiteteve që kanë lënë mend e kresë për të mirën e njerëzisë, që gjithë kohën ia qajnë hallet në kafene. Duhet tu qëndrosh afër. Të ndjesh aromën e mendimeve të tyre të vyera, që edhe kur të kenë përfunduar si koleksion i Muzeut të Mendimit të ndjesh ende në hojet e tua atë parfum erëmirë të veprës së tyre madhështore. Prandaj duhen shoqëruar në çdo hap që hedhin. Është bekim i madh të qëndrosh afër me gjenialitete që edhe vdekja u rrezaton frymëzim për të gjallët për të realizuar vepra madhore.

Vetëm të roiturit nuk mund tu qasen këtyre perlave. Ata janë të paaftë për ta kuptuar këtë slogan. Lëre më që për të zbatuar më pas as që bëhet fjalë. E ç'të presësh nga kokëboshët që iu hanë duart veç për punëra të kota e të padobishme. Ku ka punë më të kulluar, më të pastër, më të dobishme sesa të nxjerrësh perla e xhevahire nga thellësitë e mendjeve gjeniale. Kush nuk e kupton këtë rëndësi me siguri që duhet të ketë probleme serioze mentale. Nuk ka si të shpjegohet ndryshe kjo ngecje në këtë pikë e kokëboshëve. Vërtet kokëboshë paskan qenë. Ja, një shembull i kokëboshësisë së tyre. Po a mund të kërkohej gjeniu i sloganit, ditën nëpër diell me

kandil në dorë? Kjo është tallje dhe fyerje e hapur. Po vetëm një kokëbosh mund ta kryejë këtë makabritet ndaj ngjizësve të sloganit të famshëm, për të cilin shkruajnë lajmet e botës mbarë. Si kanë guxim këta të vënë në dyshim këtë gjenialitet, kur shtypi mbarë i bën jehonë brenda dhe jashtë vendit sloganit dhe perlave të gjenialiteteve? Kjo as është parë e dëgjuar kund, por prapë kokëboshët përfitojnë nga zemërgjerësia e gjeniut, i cili duke qenë shumë, po shumë i zënë ama me Akademinë e Mendimit, i toleron këto çudanëri, sepse i quan pesha pupël këta të roitur që mendojnë veç të punojnë, më keq se skllëvërit në vaktin e tyre.

E ç'mund të bëhet ndaj të roiturve që vegjetojnë mbi zellin e tyre për punë? Të krijojmë ndonjë koloni ndëshkimore ku t'i izolojmë dhe lë të shtrembërohen nga punët që duan të kryejnë. Lë të hanë kokën duke punuar, se atë kokë kanë. Ne, ndjekësit e gjenialiteteve që na shpikin slogane të përndritura dhe na frymëzojnë për të bërë hatanë me punëra të hatashme në të mire të njerëzisë, nuk do ndalemi nga ndjekja e përpiktë e sloganeve perla. Bota mbarë le ta marrë vesh se kush jemi ne dhe çfarë talenti kemi për vepra të mëdha. Inat do të na kenë me siguri, po neve aq na bën. Ne ecim krah për krah dhe të palosur më dysh nga respekti, me gjenialët e sloganeve. Dhe jemi të sigurt se zbatimi analitik i sloganit themelor *gjumë-kafe-shëtitje-kafe-gjumë*, do të japë frytet më të ëmbla që janë parë ndonjëherë. Kush nuk na merr seriozisht bën mirë të presë dhe të lutet të jetojë gjatë që të shohë vërtetësinë e besimit tonë të patundur mbi frytet që do të vilen nga ky slogan.





Të mësosh DUKE LUAJTUR

— ❧ Hulja Akbul Çakër ❧ —

Fëmijët e kanë në natyrë që të jenë të lëvizshëm. Mënyra për ta treguar këtë është lëvizja e rastësishme dhe e vazhdueshme e gjymtyrëve që para se të mësojnë si të ecin. Këto janë veprime natyrale dhe instiktive që bën njeriu kur është foshnjë. Më pas, ai fillon të marrë kënaqësi nga këto lëvizje dhe kupton funksionin e trupit të vet duke kaluar në lëvizje të ndërgjegjshme. Vetë loja është një aksion që fillon pa pasur praktikë, por që më vonë kthehet në diçka prej të cilës merret kënaqësi. Loja

e lejon fëmijën që të lëvizë. Ndërkohë që lëvizja vë në punë organet e frymëmarrjes. Në këtë mënyrë loja bën të mundur fuqizimin pa nevojën e lodhjes. Loja rrit vëmendjen, perceptimin, aftësinë për të marrë vendime, guximin dhe shumë aftësi të tjera të fëmijës. Gjatë lojës fëmijët mësojnë të jenë lider si edhe të veprojnë në grup me njerëz të



tjerë. Vendosija e rregullave dhe mësimi i zbatimit të tyre, i ndihmon që të njohin më mirë shokët dhe të forcojnë lidhjet me to. Në këtë mënyrë, ato hedhin hapat e para në një jetë të disiplinuar dhe përjetojnë eksperiencat e para të provimit të vetes dhe këtë gjë e bëjnë pa e kuptuar fare.

Loja i ndihmon fëmijët që të hedhin farat e para të jetës sociale dhe të krijojnë eksperiencat të vlefshme në fushën e zgjidhjes së problemeve. Mos të harrojmë se loja ka një vend shumë të rëndësishëm në zhvillimin e karakterit të fëmijës. Për shembull, në lojën me shtëpia, fëmijët mësojnë si të mirëpresin mysafirët dhe t'i dalin atyre para duke i thënë: "Mirë se erdhët! Si jeni?". Më pas, ato mësojnë aplikimin e disa sjelljeve edukuese si: gostitja e mysafirëve me karamelle, çaj e kafe.

Ose mund të marrim shembullin e lojës me topa. Me ndihmën e kësaj loje fëmija mëson si të marrë shënjestër, të dallojë sendet e largëta dhe ato të afërta, të gjuajë shënjestrën, të njohë më mirë trupin e vet, të koordinojë sytë, të stërvitë muskujt e duarve.

Loja i lejon fëmijët që të konsumojnë energjitë e tyre në një mënyrë pozitive. Mos të harrojmë se fëmijët që kanë trup të shëndetshëm dhe të fuqishëm, kanë edhe mendje vigjilente. Për më tepër, nëse fëmija ka një problem, e pasqyron atë në lojë duke gjetur mundësinë për të shprehur veten dhe duke i dërguar mesazhe domethënëse edhe të tjerëve. Nëse e shohim lojën nga ky këndvështrim, mund ta pranojmë atë si një terapi të veçantë që ndihmon në zhvillimin e fëmijës.

Për fat të keq, prindër që zhvillojnë lojëra të veçanta për të gjitha etapat e zhvillimit të fëmijës, shihen rrallë. Të gjithë e dimë se fëmijët në moshë të vogël kanë shumë dëshirë që të luajnë me ujë dhe të ecin këmbëzbathur. Ndërkohë të rriturit ia ndalojnë këtë aktivitet me justifikimin se do të lagin rrobat. Ndërkohë ne shikojmë shumë prindër që i ndalojnë fëmijët të zhvillojnë lojërat e tyre prej të cilave do të fitonin eksperiencë, me justifikime si: në dimër mund të ketë ftohtë, në verë djersit, në kuzhinë ka rrezik të thyejë gjëra e shumë arsyetime të ngjashme. Prindërit duhet t'i krijojnë kushte fëmijëve të tyre për të plotësuar këto nevoja. Nëse është ftohtë, vishe ndërsa nëse është vapë, kujdesu që t'ia fshish djersën. Një problem tjetër është edhe kërcënimi i panevojshëm i fëmijëve. Këto sjellje përveçse nuk kanë ndikim pozitiv në edukimin e fëmijës, ato do të dalin në pah gjatë viteve të mëvonshme dhe do të ndikojnë negativisht tek karakteri i tij. Një fëmijë që ulet në një cep i frikësuar, nuk është fëmijë i zgjuar.

Le të marrim parasysh se 50% e zhvillimit të inteligjencës së fëmijës ndodh deri në moshën 4 vjeçare, 30% në periudhën 4-8 vjeçare dhe 20% në moshën 8-18 vjeçare. Pra mund të shihet qartë se pjesa më dominuese i përket moshës parashkollore. Pra, nga kjo kuptojmë edhe një herë rëndësinë e lojës. Ajo e ndihmon individin që të zbulojë edhe cilësitë e veta më të fshehura. Lojërat edukative kanë efekt pozitiv në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës, por ato ndihmojnë edhe në krijimin e ndjenjës së lumturisë, marrjes së sjelljeve të mira, fuqizimin e lidhjeve shoqërore, respektimin e ambientit ku jeton, (me ndihmën e tregimeve dhe historive) zhvillimin e imagjinatës dhe transmetimin e saj tek të tjerët, tolerancën ndaj të tjerëve dhe zbatimin e rregullave të përbashkëta. Prindi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e lojërave të fëmijëve duke zgjedhur ato që janë edukative. Në emër të parapërgatitjes së fëmijëve për jetë, le të kuptojmë rëndësinë e lojës. Mos të harrojmë se për fëmijën, loja është një pjesë serioze e jetës.



Fatma H. Liman



Shëndeti dhe mendja jonë janë në rrezik

Në raportin e studimit të Helga Dittmarit nga Universiteti Sussex, thuhet: “Këto mënyra të të rënit në peshë, jo vetëm që e pakësojnë respektin që vajzat kanë për trupin e tyre, por, duke mos qenë të kënaqura me përmasat e tyre trupore, bëhen shkak që ato të kërkojnë trup më të dobët.”

“Kujdes, mos i kushtoni rëndësi rënies në peshë! Nuk ekziston masa (trupore) zero. Masa zero është masa trupore e njerëzve të uritur të Etiopisë.”

Këto fjalë, të cilat thuhën për të vënë në dukje gjendjen serioze dhe për të paralajmëruar vajzat adoleshente, i përkasin një modeleve të famshme. Ajo është një person që për të arritur masën zero, nuk hëngri e nuk piu dhe u përball me tretjen e muskujve...

Mania e masës së vogël trupore, e cila shihet më shumë te personat me nivel të lartë socio-ekonomik, në sajë të mediave është përhapur edhe në zonat rurale. Doktor i njohur turk, Ender Saraç thotë se kjo sëmundje, e cila buron nga pretendimi i tepërt për t'u dukur nga shoqëria mondane, është përhapur në zonat rurale me mendimin: “nëse ke një trup të dobët e ideal, ke më shumë reputacion”.

Tashmë në çdo pjesë të shoqërisë ekziston dëshira për t'u dukur i dobët dhe për hir të kësaj praktikohen dieta vdekjeprurëse. Sidomos vajzat e reja, të cilat i kushtojnë shumë rëndësi pamjes së jashtme në moshën e adoleshencës, shtimi më i vogël në peshë, bëhet shkak që ata për hir të dobësisë, të shkatërrojnë trupin dhe të vënë në rrezik shëndetin e tyre. Ato qëndrojnë të uritura, ose e vjellin menjëherë ushqimin që hanë, ose përdorin ilaç pastrues (për zorrët), ose përdorin

diuretik, ose marrin hormone të ndryshme dhe bëjnë ushtrime të tepruara.

Në këtë mënyrë, muskujt fillojnë të treten dhe ato fillojnë të mos kenë cikël menstrual. Ato madje mund të përballen edhe me rrezikun për të arritur në një kohë të shkurtër menopauzën. Mëlçia e zezë dhe veshkat falimentojnë, zemra e humb fuqinë e saj dhe fillojnë të dalin në pah sëmundjet e saj.

Të gjitha këto probleme shëndetësore shfaqen si rrjedhojë e dietave vdekjeprurëse të cilat praktikohen për hir të të qenit belhollë. Vajzat i praktikojnë këto metoda pa njoftuar familjen dhe pa u konsultuar me doktorin. Sado që të dobësohen, përballë pasqyrës akoma e ndjejnë veten të shëndoshë.

Vajzën e re me emrin Hatixhe Danabash, e cila disa vite më parë kishte rënë në 19 kg dhe kishte mbetur kockë e lëkurë, e ndoqëm si një film të frikshëm. Nuk ulej e nuk ngrihej nga dhembja e kockave dhe akoma i dukej vetja e shëndoshë.

Kur punonte në repartin e konfeksionit, shoqet e saj ishin më të dobëta se ajo dhe shoqet e kishin etiketuar si e shëndoshë. Duke parë këtë gjendje dhe duke u ndikuar nga modelet, vendosi të binte në peshë. Në fillim nuk ulej të hante vaktin e drekës, ndërsa më vonë ndërpreu edhe vaktin e darkës. Në fillim e kapi çrregullimi i oreksit; hante deri sa plaste, pastaj e villte të tërin. Vazhdoi kështu për tre vite me radhë. Familja nuk po kuptonte asgjë. Më vonë e kapi edhe sëmundja e “anoreksisë” dhe tashmë i dukej vetja vazhdimisht e shëndoshë dhe nuk mund të hante asgjë. Unë u ndikova shumë nga një fjalë e saj:

“Pesha për mua ishte më e rëndësishme se bukuria.”

Prof. Dr. Bengi Semerxhi e shpreh kështu pikën kritike që arrin çmenduria dietike:

“Aq i theksuar është te të rinjtë mendimi se bukuria është në masën e vogël trupore dhe se vetëm të dobëtat janë të bukura, sa që një sërë të rinjsh fillojnë të mbajnë dieta për hir të të qenit të bukur. Të rinjtë e moshës pesëmbëdhjetë-njëzet e pesë vjeç, si rezultat i këtyre dietave, e burgosin veten në uri. Një pjesë e këtyre të rinjve nuk mundën në asnjë mënyrë të ndalojnë së praktikuari këto dieta. Tashmë, edhe pse kanë rënë në peshë, e vazhdojnë çmendurinë e dietave. Ata tashmë nuk zbatojnë dietë, por

një ushqyerje të çrregullt që mund t'i çojë drejt vdekjes.

Në daç quajeni anoreksi, në daç bulimi, që të dyja fillojnë me historinë e dietës. Këta të rinj, të cilët i frikësohen shtimit në peshë, por që në shkollë janë mjaft të suksesshëm dhe ambiciozë, nuk e vlerësojnë siç duhet pamjen e tyre fizike dhe fillojnë të shfaqin veprime si: ndërpresin ushqimin, bëjnë ushtrime të tepruara dhe vjellin me dëshirë. Nëse kjo gjendje nuk kuptohet në kohë, mund të përballen me vdekjen si pasojë e çrregullimit të të ushqyerit ose vetëvrasjes. Disa të rinj nuk mund të mbajnë dietë të vazhdueshme dhe nganjëherë konsumojnë aq shumë ushqim, sa që pothuajse bllokohen. Çdo krizë e të ngrënit, ndiqet nga pendimi dhe përpjekja për të nxjerrë gjërat që janë ngrënë. Në këtë mënyrë mundohen të qëndrojnë të dobët. Të vjellët dhe çrregullimet e oreksit bëhen shkak për shkatërrimin e fytit dhe sistemit tretës si edhe dëmtimit të rëndë të shëndetit.”

Në raportin e studimit të Helga Dittmarit nga Universiteti Sussex, thuhet: “Këto mënyra të të rënit në peshë, jo vetëm që e pakësojnë respektin që vajzat kanë për trupin e tyre, por, duke mos qenë të kënaqura me përmasat e tyre trupore, bëhen shkak që ato të kërkojnë trup më të dobët.”

Sipas një studimi të botuar në revistën «**Developmental Psychology**», ndikimet e fotografive të dy lodrave foshnje, njëra Barbi, tjetra me masa trupi më të mëdha, influencuan te 200 vajza që ishin nxënëse të fillores. Të gjitha vajzat kërkonin që të bëheshin si kukulla Barbi. Zëdhënësi i Mattel, prodhuesit të Barbit thotë për revistën Times: “Vajzat e vogla të ditëve të sotme, Barbi i bën të mendojnë se do të kenë çdo gjë që dëshirojnë nëse do të kenë një trup si të saj.” Imazhi që formon Barbi në subkoshiençën e vajzave të vogla, nuk është aspak i pafajshëm.

Allahu në Kuranin fisnik thotë:

“Hani nga ushqimet e shijshme e të lejuara me të cilat ju kemi furnizuar dhe mos e kapërceni kufirin, përndryshe do t’ju zërë zemërimi Im. Ai të cilin e zëmërimi Im, është i humbur!” (Taha, 81)

Qoftë e ngrëna e tepërt, qoftë dieta për të rënë në peshë, që të dyja janë të tepruara dhe bëhen shkak për problemet shëndetësore që të çojnë drejt vdekjes si dhe nxjerrin në pah ajetin e mësipërm; në këtë mënyrë njeriu shkon në prag të shkatërrimit.

Gjigantët botëror të modës luajnë me imazhin trupor të grave. Sa mësimdhënëse janë këto fjalë të specialistit të modës, Vogtit:

“Masën trupore të veshjes së femrave e caktojmë ne me tabelat tona të veçanta të masës.”

Ka të drejtë. Imazhin e masës trupore të grave e caktojnë stilistët evropianë dhe amerikanë. Në vitet 1950 modele ishin gratë me masë 42. Sipas



stilistëve të asaj kohe grua e bukur quhej gruaja e majmë. Ndërsa stilistët e sotëm punësojnë modele me masë 32-34. Këto modele që quhen “Masa zero”, bëhen shembull për miliona të rinj.

Më tmerroi një artikull të cilin e lexova pak kohë më parë. Susie Obraxh, një psikoterapiste e njohur e tregon kështu presionin që media bën mbi trupin tonë:

“Përveç hyrjes në tregun arab, revista Marie Claire synon të hyjë edhe në regjimin e vajzave të moshës pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetë vjeçare, në mënyrë që ato të praktikojnë konceptin e ri të bukurisë.”

Kjo qasje është shumë e çuditshme, duke qenë se në kulturën e lindjes të qenit në peshë shihet si tregues i pasurisë!.. Sapo hedh hapin në botën e modës, te njeriu zhduken zakonet e kultura dhe ai shndërrohet në një tip të vetëm.

Tregu i dietës, është një treg përafërsisht 30 miliard dollarësh. Konsulenti i obezitetit, Dr. Haluk Saçakllë thotë se në ditët e sotme ekzistojnë mbi 20 mijë “dieta të rreme”. Disa nga këto janë Atkins, Montignac, Pritikin, Zvicëran, Supë lakrash, South Beach dhe dietat ndarëse, ndërsa disa dieta të tjera që kanë lidhje me acidin dhe për të cilat ka interesim të madh kohët e fundit, janë Dieta e kohës së gurit, dieta Dukan, dieta Karataj etj... Ndërkohë që dhjetë vitet e fundit kanë dalë në treg qindra libra dietash, revista, programe televizive dhe gazeta, sot dy në tre gra mbajnë dietë.

Por në vend që të mbajmë dieta, me konceptin “Ushqyerje e shëndetshme”, që na rekomandojnë doktorët, kemi mundësi të mbrojmë shëndetin dhe të shpëtojmë nga kilogramët e tepërt. Ndërsa praktikimi i vazhdueshëm i dietave bëhet shkak për oreks të tepërt ose për sëmundje të ndryshme.

Një zonjë, e cila është në mbipeshë që në fëmijëri, thotë:



“Në shkollë shokët, në shtëpi prindërit dhe pasi u martova bashkëshorti vazhdimisht janë tallur me peshën time. Vendosa dhe rashë përnjëherë 25 kg. Mendova se çdo gjë do të ishte më bukur, se nëse dobësohesha, lidhja me shoqërinë dhe bashkëshortin do të bëheshin perfekte, por asgjë nuk ndryshoi. Mendova se esenca e ndryshimit ishte vetëm ndryshimi i trupit tim, por unë prapë isha i njëjti person. Shpirti im prapë ishte i shqetësuar... Do të thotë se ndryshimi i lëndës së parë, nuk i ndryshonte përmasat e kuptimit. Ndërsa trupi mbante dietë, shpirti plagosej.”

Fakti se nuk kanë trupin e hollë që kanë caktuar shoqëria dhe autoritetet e modës, i shtyn personat në mënyrë serioze drejt përplasjes me veten. Në këtë mënyrë ata besojnë se nuk janë të bukur nëse nuk bien në peshë dhe se janë krijesa që nuk ia vlen të duhen e të pëlqehen.

Një herë na ftoi në shtëpinë e saj nusja e një familjeje të nderuar në Levent. Ajo kishte ftuar edhe shoqet dhe në këtë mënyrë u bë një ambient i bukur bisede. Zonjat kërkuan nga ne të luteshim për martesat e tyre dhe vazhdimësinë e lumturisë. Çdo gjë ishte luksoze, kishin shumë njerëz në shërbimin e tyre që kujdeseshin për beben, gatuanin, pastronin shtëpinë, shërbenin ushqimin, kujdeseshin për kopshtin, përdornin makinën dhe përsëri këto gra nuk ishin të lumtura. Gjatë qerasjes vumë re se nuk hëngrën asgjë. Nuk ishin agjërueshëm, por me dietë.

Kur i pyetëm: “Pse mbani dietë, faktikisht ju jeni të dobëta?”, e kishim vënë gishtin në një plagë aq të madhe, sa që na thanë:

“Dje burri pa në gazetë foton e një modeleje dhe duke ma treguar, më tha: ‘Ja, si kjo dua të bëhesh, ke pesë kilogramë mbi peshë.’ Tashmë sytë e burrit tim janë bërë si peshore. Sapo të shtoj pak në peshë, më lajmëron menjëherë duke më thënë ‘Po bien kambanat e rrezikut. Mblidhe veten, sepse e humb formën dhe bëhesh e shëmtuar. Ka shumë rëndësi pamja dhe qëndrimi yt kur je përkrah meje.’”

Dhe thoshin: “Në këtë mjedis nuk ka as edukatë dhe as moral. Mjedi i këtyre burrave është i privuar nga morali dhe i mbushur plot me gra që shohin rreth e rrotull me të katër sytë hapur për të gjetur një burrë të pasur. Ato nuk e kanë problem nëse është i martuar apo beqar dhe nuk njohin kufij. Këto gra, janë gra të dobëta, që bëjnë kujdes ndaj peshës së tyre, gazmore, të mbajtura dhe të bukura. Ne nuk mund të mendojmë se burrat tanë nuk mund të heqin dorë prej nesh, sepse në botën e të qenit e bukur, e dobët, e pashme dhe e mbajtur, ka një konkurrencë shumë të madhe. Veçanërisht, nëse burri nuk i frikësohet Allahut, atë nuk mund ta ndalojnë as fëmijët dhe as gruaja e tij.

Gratë që nuk mund të hanë asgjë që dëshirojnë apo që mbajnë dietë me ditë të tëra, nëse kanë ngrënë me mendimin që, “Burri le të më pëlqejë vetëm mua dhe të mos shohë tjetër.”- sikur ta shfaqnin këtë përpikëri në adhurim, shumë shpejt do të bëheshin evlija (robër të dashur të Allahut). A është i qetë shpirti i një gruaje që nuk ha e nuk pi duke menduar se do të arrijë masën 36 të trupit të cilin e do burri i saj? Sepse shpirti dëshiron të adhurojë vetëm Allahun. Ai nuk dëshiron të bëhet rob i rregullave në lidhje me trupin e gruas që mjedisi social ka imponuar.

Mendimi për t’u dobësuar për ndonjë, goftë burri, shoqja apo prindërit, e dobëson dhe e shkatërron shpirtin. Sepse sforcohen kufijtë që shprehen në ajetin fisnik dhe njeriu e tepron në emër të robërve duke e lënë Zotin.

Ndërkohë që një grua është e vlefshme dhe ndershme me të qenët e saj një bashkëshorte dhe një nënë, është shumë poshtëruese që ta shohësh atë vetëm si një qenie që i tregohet botës së jashtme dhe me bukurinë e së cilës mund të lavdërosh. Sa poshtërim i madh është që ta shohësh gruan si diçka të përbërë vetëm nga trupi e pamja e jashtme dhe jo nga mentaliteti e shpirti!.. Sa i privuar dhe sa i shkretë është një njeri që e pranon veten vetëm si pamje e jashtme dhe trup!.. Shëndeti dhe shpirti ynë janë në rrezik me dietat që bëhen për shkak të presionit të këtyre mendimeve të ulëta. Shqetësimi për pamjen e jashtme, pothuajse e ka kaluar shqetësimin për fenë dhe besimin. Nëse kjo nuk është kalim kufijsh, çfarë mund të jetë tjetër?

“Vajza e re, u bë kurban i X ilaçi dobësimi.”

“Vajza e re që u bë operacion për të shpëtuar nga dhjamërat në zonën e barkut e të ijëve, humbi jetën.”

Tashmë jemi mësuar me lajme të tilla. Sa qartë që shprehet ajeti fisnik. Të kalosh kufijtë në të ngrënë e në të pirë, me të vërtetë i rrokullis njerëzit drejt humnerës.

Në njërën anë fast food-ët, reklamat e shumë ushqimeve, inkurajimi për në çmendurinë e konsumimit... Në anën tjetër të rinjtë ballë përballë me rrezikun e obezitetit, shumë larg lëvizjes dhe në krye të kompjuterit e internetit... Koncepti i botës së modës dhe medias i nxit ata drejt “dëshirës

**Një zonjë, e cila
është në mbipeshë që
në fëmijëri, thotë:**

**“Në shkollë shokët,
në shtëpi prindërit dhe
pasi u martova bashkëshorti
vazhdimisht janë tallur me
peshën time. Vendosa dhe rashë
përnjëherë 25 kg. Mendova se çdo
gjë do të ishte më bukur, se nëse
dobësohesha, lidhja me shoqërinë dhe
bashkëshortin do të bëheshin perfekte,
por asgjë nuk ndryshoi.**

për të pasur trup të hollë” dhe “çmendurisë së dietës”... Njerëz në konfuzion.

Kjo çmenduri diete do të marrë fund ditën kur njerëzit, në çastin që takohen me njëri-tjetrin, nuk do ta vënë re peshën e tyre dhe nuk do të thonë “qenke shëndoshur shumë”, ose “qenke dobësuar shumë”... Nënata tona, bashkëshortet, mikeshat tona u thonë vajzave të reja:

“Dobësohu!.. Nuk do të të nxërë velloja!”

Ndërsa grave të martuara u thonë njerëzit përreth:

“Bjer në peshë! Nëse shëndoshesh, të humb bukuria dhe burri yt do t’i mbajë sytë jashtë te gratë më tërheqëse.”

Kur të mos jepen më këshilla të tilla, atëherë do të marrë fund çmenduria e dietës.

Kur adoleshentëve të mos u jepen si model manekinët me masë zero dhe kur të mos ketë tepriçë dhe mangësi gjatë ngrënies e pirjes, çmenduria e dietës do të marrë fund, sepse atëherë njerëzit nuk do të merren me masën trupore të njëri-tjetrit, por me mendjen dhe shpirtin e tyre.

Sepse atëherë njerëzit do të ushqehen shëndetshëm, do të jetojnë një jetë në lëvizje dhe nuk do të ekzistojë problemi i mbipeshës.

Degët e Xhenetit

Seher Ajdën

Allahu është më i Mëshirshmi dhe i ka dhuruar çdokujt të mira pa u kursyer aspak; Ai dëshiron që ne ta falënderojmë dhe ta përkujtojmë gjatë gjithë kohës. Krijuesi ynë na ka këshilluar që ta kërkojmë Xhenetin me përgjërime dhe të bëjnë përpjekje për ta merituar dashurinë e Allahut me bindje, plotësimin e detyrave të myslimanit dhe më dhënien e lëmoshës.

Veprimi që bën i pasuri duke dhuruar lëmoshë për një njeri në nevojë, nga njëra anë e ndihmon atë vetë që të fitojë sevape dhe nga ana tjetër bën që të fitojë riskun e vet një njeri i vuajtur. Zekati është një nga adhurimet më të rëndësishme të fesë sonë, ai është urdhëruar në të njëjtën kohë me namazin. Namazi njihet si shtylla kryesore e Islamit, kurse zekati një adhurim që bëhet duke përdorur një pasuri materiale me qëllimin e pas-trimit të pasurisë. Allahu (xh.sh.), na ka shpjeguar se rruga për të hyrë në Xhenet kalon nga namazi dhe infaku (zekati dhe lëmosha).

“Kush do t’i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t’ia kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron; tek Ai do të ktheheni.” (Bekare, 245)

“Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet,

besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të singertët) dhe të drejtat (të singertat), duruesit dhe durueset, të përlulurit dhe të përlulur, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.” (Ahzab, 35)

“Ata që japin lëmoshë e që i japin Allahut një hua të mirë, qofshin burra ose gra, do t’u shumëfishohet përfitimi dhe do të kenë një shpërblim fisnik.” (El- Hadid, 18)

“Nëse i jepni Allahut një hua të bukur, Ai jua kthen shumëfish atë dhe ju fal. Allahu është Mirënjohës dhe nuk nxiton në dënime.” (Tegabun, 17)

Pejgamberi i nderuar na ka treguar se adhurimi që të fut në Xhenet është: **“Adhurimi i Allahut, pa i bërë ortak, falja e saktë e namazit, kujdesi për të afërmit dhe dhënia e zekatit.”** (Buhari, Zekat, 1; Myslim, Iman, 12)

Në kohën pas një namazi, Muaz bin Xhebeli e kishte pyetur Pejgamberin tonë të nderuar (a.s.) se cilat janë veprat që na afrojnë me Xhenetin dhe na largojnë nga Xhehenemi. Ai i është përgjigjur:

“Faleminderit që më bërë një pyetje kaq të rëndësishme. Nuk ka dyshim se Allahu e ka bërë shumë të lehtë këtë gjë për disa nga njerëzit. Duhet që të adhurosh Allahun pa i bërë ortak askënd, të falësh namazin ashtu siç duhet, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të bësh Haxhin.” (Ahmed bin Hanbel, Mysned, V, 231.)

Në një hadith tjetër, Resulullahu ka thënë:

“Lëmosha do të fikë zjarrin e varrit. Në Ditën e Kiametit, besimtari do të strehohet në hijen e lëmoshës.” (Hejsemi, Mecmauz- Zevaid, III, 110.)

Zekati ose një e dhjeta jepen kur njeriu zotëron një pasuri që arrin vlerën e nisabit. Nga ana tjetër, falja e parave (infak) është të japësh një pjesë të asaj që të gjendet në dorë; atë që Allahu ta ka dhuruar ty, ta ndash me njerëzit e tjerë. Në këtë lloj dhurimi nuk ka kufij të përcaktuar, nuk ka rregulla për të dhënë pak ose shumë. Më e rëndësishmja

është të ndash diçka me njerëzit në nevojë dhe ta bësh këtë me sinqeritet dhe dëshirë. Të ndash pasurinë tënde më njerëzit në nevojë, ashtu siç bënë ensarët e Medinës me muhaxhirët e Mekës, që i ndanë së bashku bukën, shtëpinë dhe kafshët... Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), në lidhje me këtë temë ka thënë:

“Kush nga ju jep lëmoshë goftë një hurmë nga pasuria që e ka fituar në hallall, Allahu ia llogarit si pesëdhjetë hurma. Pastaj kjo sasi e vogël rritet ashtu siç ndonjëri nga ju e rrit mëzin e vet dhe në Ditën e Llogarisë do t’ju dalë përpara në madhësinë e malit Uhud.” (Buhari, III, 290.)

Pejgamberi ynë i nderuar, salallahu alejhi dhe selem, në lidhje me lëmoshën na thotë këtë lajm të mirë:

“Në çdo lindje të diellit; dy melekë që qëndrojnë pranë diellit thërrasin me një zë që mund të dëgjohet nga të gjitha krijesat përveç njerëzve dhe xhindeve:

‘O njerëz, bashkohuni me Zotin tuaj. Rrishtu i pakët por i mjaftueshëm është më i mirë se rrishtu i shumtë që të shpërqendron.’

Në çdo perëndim të diellit; dy melekë që qëndrojnë pranë diellit thërrasin me një zë që mund të dëgjohet nga të gjitha krijesat përveç njerëzve dhe xhindeve:

‘O Allahu im, shtojë pasurinë e njeriut që ndihmon të tjerët dhe pakësoje mallin e atit që është korrak!’” (Kitabuz Zuhd, Ahmed bin Hanbel, Mysned, V, 197.)

Në Islam ‘dora që jep’ është mbajtur gjithmonë më lart se ‘dora që merr’. Duke filluar që nga Pejgamberi ynë i nderuar dhe për të vazhduar me të gjithë sahabët e tjerë, të gjithë janë treguar të kujdesshëm në këtë temë. Disa prej sahabëve i kanë shpërndarë të gjithë mallrat e tyre dhe u kanë thënë familjeve që kanë mbajtur vetëm dashurinë e Allahut dhe të Resulullahut. Një prej tyre janë Ebu Dahdah dhe gruaja e tij, të cilët e shitën kopshtin e tyre në këmbim të Xhenetit.

Një ditë, një jetim shkoi pranë Resulullahut dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Në kopshtin e filanit është hedhur në tokë një pemë hurme. Jepni urdhër që të ma japin mua atë pemë dhe ta vendosi në mur të shtëpisë sime. Resulullahu, (a.s.), e thirri burrin dhe i tha:

“Në goftë se ti do t’ja japësh pemën e hurmës këtij jetimi, unë dal garant se ty do të të jepet një kopsht me hurma në Xhenet.”

Burri nuk e kishte pranuar këtë kërkesë dhe Ebu Dahdah i kishte thënë:

“Ma jep mua pemën dhe unë do të jap kopshtin tim.”

Burri e kishte pranuar këtë kërkesë me kënaqësi. Pas kësaj marrëveshjeje, Ebu Dahdah kishte shkuar pranë Resulullahut (a.s.), dhe i kishte thënë:

“O i Dërguari i Allahut! Unë e kam blerë pemën e atij burri me kopshtin tim. Unë po ta fal ty atë pemë dhe ti thirrë jetimin që t’ia japësh pemën e hurmës.”

Rasulullahu, (a.s.), u gëzua shumë nga ky veprim i Ebu Dahdahut dhe tha:

“Ebu Dahdah u bë pronar i shumë hurmave në Xhenet.”

Ebu Dahdah u largua nga Resulullahu dhe shkoi në kopsht, i tha gruas:

“Dil jashtë nga kopshti. Unë e shita kopshtin në këmbim të një peme të hurmës në Xhenet.” Gruaja iu përgjigj me fjalët:

“Sa këmbim të dobishëm paske bërë, goftë i bekuar!” (Mexhmauz Zevaid, 10 / 3242)

Çdo gjë që zotërojmë në këtë botë nuk është asgjë tjetër veçse diçka që Allahu na e ka dhënë amanet, na e ka lënë porosi. Të tregohesh dorështrënguar për të dhënë diçka që nuk është e jotja është gabim i madh dhe është një veprim për të cilin janë bërë paralajmërime të shumta. Resulullahu e ka kritikuar edhe Bilalin (r.a.), i cili u ka shërbyer mysafirëve të tij. Një ditë, Pejgamberi ynë i nderuar e kishte parë Bilalin që po ruante hurma në një cep të mesxhidit, fytyrës së tij të nderuar i kishte ndërruar ngjyra dhe i kishte thënë Bilalit (r.a):

“Çfarë po bën, o Bilal?”

“Këto janë hurma që po i ruaj për mysafirët tanë që vijnë papritur, o Resulallah!”, i ishte përgjigjur Bilali (r.a.).

Pejgamberi (a.s.), i kishte thënë:

“A nuk ke frikë nga avulli i zjarrit të Xhehenemit që është përgatitur për ty? Dhuroje menjëherë atë që ke ruajtur, o Bilal! Mos ki frikë, sepse Zoti i Arshit nuk të lë në vështirësi!” (Mexhmeuz Zevaid, III, 129.)

Si përfundim, Pejgamberi ynë i nderuar na ka porositur me fjalët:

“Bujaria është një pemë Xheneti, degët e të cilës zgjaten deri në këtë botë; kush mbahet nga degët e saj do të shkojë në Xhenet. Korracia është një pemë e Xhehenemit, degët e së cilës mbërrijnë në këtë botë; kush do të mbahet nga degët e saj, do të zvarritet në Xhehenem.” (Shiko: Bejhaki, Shuabul-Iman, VII, 435.)

Allahu na e mundësoftë mbajtjen në degët e pemës së Xhenetit, në mënyrë që të fitojmë dashurinë e Tij dhe të meritojmë Xhenetin.

Amin!

Urtësia dhe vetëpërmbajtja

Allahu (xh.sh.) i drejtohet Profetit (a.s.) në Kuranin Famëllartë, duke i thënë: **“Sepse Zoti të dha mëshirë, prandaj ti ishe i butë me ta. Sikur të tregoheshe fjalërrëndë dhe zemërgur, ata do të iknin prej teje”.** (Ali Imran, 159).

Jeta e përplas njeriun me probleme nga më të ndryshmet, do apo nuk do ai. Jeta e përplas njeriun me dikë, që ka dy gramë mend në kokë, por edhe me njerëz që e kanë kokën bosh, me njerëz të urtë, por edhe me arrogantë, e përplas me njerëz injorantë dhe mendjelehtë, saqë njeriu nuk di nga t’ia mbajë e çfarë të thotë.

Njeriu kalon probleme e kriza nga më të ndryshmet. Kalon situata aq delikate, në të cilat duhet të mendohet mirë para se të vendosë, sepse me një fjalë fiton apo humb gjithçka.

Koha që po jetojmë, është e mbushur me të tilla situata dhe fjala më e mirë që më vjen ndër mend për të gjitha këto është **sprovë**. Ka rrezik të përçahet i gjithë populli, prandaj lum ai njeri që ulet dhe mendon, lum ai njeri që i lutet Allahut (xh.sh) që ta udhëzojë tek rruga më e mirë, t’i japë urtësi e butësi, ta ruajë nga nxitimi dhe mos përmbajtja e vetes.

Kapitali më i madh që ka njeriu në këto kohë, nuk është as pasuria dhe as mençuria, por është morali i tij. Ky moral e bën njeriun që të përmbajë veten. Morali ka dy cilësi kryesore: **URTËSINË** dhe **VETËPËRMBAJTJEN**.

Këto cilësi i do Zoti i gjithësisë, i deshi Profeti (a.s) dhe çdo njeri i dëshiron për veten e tij. Profeti (a.s), i tha njeriut prej shokëve të tij: *“Ti ke dy cilësi që i do shumë Allahu (xh.sh) dhe profeti i Tij. Ti je i urtë dhe i vetëpërmbajtur”*.¹ Atëherë ky njeri falënderoi Allahun (xh.sh), që ia kishte dhënë këto dy cilësi.

Njeriu ka nevojë për urtësi, për butësi dhe vetëpër-

mbajtje. Këto cilësi nevojiten sidomos në ato situata, kur njerëzit çoroditen dhe bëhet rrëmujë e madhe.

Për këto cilësi ka nevojë besimtari, sepse **urtësia** dhe **vetëpërmbajtja** janë cilësi hyjnore. Një nga emrat e Zotit tonë është **EL-HALIM (I URTI)**. Allahu (xh. sh.), nuk nxitohet me krijesat e Tij, nuk nxitohet me atë njeri që bën mëkate, por pret që ai të pendohet. Dënimi i Allahut (xh.sh.), vonon dhe mëshira e Tij pret. Sikur Allahu (xh.sh.), t’i jepte çdo njeriu hakun pasi ka bërë punën, vallahi ne do të shkatërroheshim nga mëkatet që bëjmë. Kjo është drejtësia e Zotit. Kush është ai që nuk bën mëkate?! Të gjithë ne jemi mëkatarë. Thuhet se të gjitha krijesat e lusin Allahun (xh.sh.), që t’i shkatërrojë këta njerëz, por Zoti e vonon dënimin e Tij, sepse është i Urtë, i Butë, i Vetëpërmbajtur. Për çdo ditë që lind, deti i lutet Zotit: “O Zot më jep leje t’i mbys mëkatarët, që bredhin nga njëri breg në tjetrin e nuk të kanë frikë Ty”. Toka nga ana e saj i lutet Zotit çdo ditë: “O Zot më jep leje t’i fundos në barkun tim të gjithë ata njerëz, që nuk e njohin Madhësitinë Tënde”. Po ashtu edhe qielli i lutet Zotit të gjithësisë: “O Zot, më jep leje t’i shkatërroj të gjithë mëkatarët, që nuk duan t’ia dinë, se Ti i shikon në çdo moment”. Por Allahu (xh.sh) nuk i jep leje askujt, që t’i zhdukë gjynahqarët. Ai është i Butë, është Mëshirues dhe Falës i madh.

Sa njerëz sot lundrojnë në barkun e detit?! Sikur Allahu (xh.sh) të jepte leje, që gjynahqarët dhe mëkatarët të shkatërroheshin në këto momente, sa mendoni se do të ishin vallë?

Sa njerëz ecin me makinat e tyre mbi shpinën e tokës? Janë miliona e miliona njerëz. Sikur të dënoheshin menjëherë për gjynahet që kanë bërë, e mendoni sa vetë do të përpinte toka?!

Sa njerëz fluturojnë në zemër të qiellit? Sikur t’i dënonte Allahu (xh.sh), asnjë nuk do të mbetej i gjallë, por Zoti pret, se është i Butë, është Bujar, është

1. Muslimi (25).

i Mëshirshëm. Allahu (xh.sh) i thotë detit, qiellit edhe tokës: **“Ju nuk i krijuat njerëzit, prandaj doni të hakmerreni ndaj tyre. Ata janë krijesat e Mia, Unë i kam krijuar e Unë i mëshiroj. Sikur t’i kishit krijuar ju njerëzit, s’do të thoshit fjalë të tilla”.**

Vetëpërmbytja është cilësi e Zotit të gjithësisë. Është cilësi, për të cilën na fton vetë Zoti i gjithësisë. Cilësinë e butësisë dhe vetëpërmbytjes e pati pejgamberi Muhamed (a.s), sepse atë e edukoi vetë Allahu (xh.sh) dhe Zoti i tha: **“Sepse Zoti të dha mëshirë, prandaj ti ishe i butë me ta. Sikur të tregoheshe fjalërrëndë dhe zemërgur, ata do të iknin prej teje”.** (Ali Imran, 159) Profeti (a.s) ishte i butë, i mëshirshëm dhe nuk u hakmor kurrë për veten, prandaj dhe armiqtë u nënshtruan përpara tij. Meditoni pak për historinë e Profetit (a.s). Këtë Profet e ofenduan, i thanë: “Budalla, i çmendur, magjistar, poet”, por ai kurrë nuk u nevrikos, kurrë nuk i mallkoi këta njerëz. Ky Profet i Zotit u dëbua si mos më keq, pa asnjë gabim, pa asnjë faj dhe u keqtrajtua nga banorët e Taifit. Ai nuk mori hak ndaj tyre, por tha: *“O Zot, fali se ata nuk e dinë se çfarë bëjnë! O Zot nxirr nga pasardhësit e tyre, besimtarë që do të të madhërojnë Ty!”*.²

Njëherë kur po ndante plaçkën e luftës, dikush me paturpësinë më të madhe i tha: “Pasha Zotin nuk e ndave drejt o Profet i Zotit”. Profeti (a.s.), ia ktheu: *“Zoti të faltë ty dhe të gjithë të tjerët. Nëse unë nuk e ndaj drejt, kush do ta ndajë më mirë se unë?”*.³

Ky profet i Zotit nuk mori hak edhe kur i urinuan në xhami, por me butësinë më të madhe dhe me një vetëpërmbytje të admirueshme, diti si të silltet me këta njerëz dhe arriti t’i hapte zemrat e tyre. Prandaj këta njerëz nga armiq, u bënë miq, nga beduinë që ishin, u bënë njerëzit më të civilizuar.

Profeti (a.s) nuk u nxitua edhe në punët, që janë krejtësisht fetare. Pak kohë përpara se të ndërronte jetë, ai (a.s) i tha bashkëshortes së tij: *“O Aishe! A e di ti se xhamia e Qabes nuk është në themelet e saj origjinale?” Pasha Zotin, sikur të mos kisha frikë se njerëzit përçahen, unë do e prishja Qaben, do ta ndërtoja në themelet e saj origjinale dhe do t’i bëja dy dyer”*.⁴ Profeti (a.s) preferonte që më mirë ta linte Qaben aty ku është, sesa të përçante njerëzit. Ky është Profeti (a.s), kjo është butësia e tij, kjo është vetëpërmbytja e tij.

Profeti (a.s) i mësoi shokët e tij, të mos nxitohen në asnjë situatë, as atëherë kur provokohen e as atëherë kur janë të qetë. Ai (a.s) i ftoi shokët e tij, të mos nxitohen edhe në punët e mira. Prandaj Islami nuk e preferon, që namazin ta falim me nxitim. Pse

duhet të nxitohesh? Kush po të sulmon nga pas? Mos u nxito, por përqendrohu në namazin tënd dhe mundohu ta përjetosh atë.

Kur Profeti (a.s.), bëri haxhin e lamtumirës, u thoshte njerëzve: *“Qetësohuni, qetësohuni o robër të Zotit, mos u nxitoni”*.⁵ Në atë kohë ishin vetëm 100 mijë vetë. Po sot që mblidhen me miliona njerëz në haxh?! A nuk duhet të jemi të kujdesshëm e të mos nxitohemi. Për fat të keq ka njerëz, që mund të pësojnë aksidente gjatë haxhit, brenda në Qabe, në vendin më të mirë që ka bërë Zoti për njerëzit dhe kjo vjen, ngaqë njerëzit nuk e përfillin porosinë e Profetit (a.s). Nxitimi nuk sjell asnjëherë punë të mira.

Profeti (a.s.) i mësoi shokët e tij, na mësoi edhe ne me dy fjalë shumë të shkurtra: *“Nxitimi është prej shejtanit, ndërsa vetëpërmbytja është prej Rrahmanit”*.⁶

Nëse vetëpërmbytja dhe butësia i duhen njeriut në çdo situatë, unë mendoj se më shumë se kurrë i duhen myslimanit sot. Atëherë kur kjo fe akuzohet padrejtësisht nga mëngjesi deri më mbrëmje, ne duhet ta kontrollojmë veten tonë. Në një kohë kur provokohemi padrejtësisht me lloj – lloj termash e lloj – lloj veprimesh, vetëm që ne të bëjmë veprime të pahijshme, duhet ta kontrollojmë veten tonë. Është koha e thashethemeve e njeriu duhet ta përmabajë veten e tij. Çdokush le t’i lutet Allahut (xh.sh), që t’i japë butësi e urtësi në zemër.

Sot më shumë se kurrë duhet ta edukojmë veten tonë, që të mos bëjmë veprime, të cilat nuk i bëjnë dobi myslimanëve. Sot më shumë se kurrë duhet t’i masim fjalët tona, t’i masim punët tona, t’i edukojmë mirë fëmijët tanë, që të jenë të urtë e të vetëpërmbytur.

Të jesh i vetëpërmbytur dhe i butë, nuk do të thotë që ti je frikacak dhe nuk pyet për fenë e Zotit. Ne duhet të jemi të butë, por jo të nënshtruar, modeshtë por jo naivë, krenarë por jo mendjemëdhenj. Ne duhet të kontrollojmë fjalët dhe zemërimin tonë, të falim kur kemi mundësi, të japim kur të tjerët nuk japin, sepse për këto cilësi na nxit Zoti i gjithësisë dhe Profeti (a.s).

Profeti (a.s) ka thënë: *“Ajo që arrihet me butësi, nuk arrihet kurrë me vrazhdësi”*.⁷

Lusim Zotin t’i mbushë zemrat tona me butësi dhe maturi. E lus Zotin që në situatë krizash e rrëmujash, të na udhëzojë në rrugën e drejtë e të na japë forcë ta ndjekim atë, të na ruajë nga rruga e keqe e të na japë forcë t’i largohemi asaj!

Amin!..

5. Muslimi (147, 1218).

6. Ebu Ja’la (4254). Hejthemiu në Mexhmauz’zeuaid (8/43) thotë: “E shënon Ebu Ja’la me përcjellës të vërtetë”. Shejh Albani e vlerëson hadithin të pranuar.

7. Muslimi (2592).

2. Buhariu (3231).

3. Buhariu (3610).

4. Muslimi (2374).



Vaji i Lirit

Vaji i lirit njihet që nga kohët e lashta, veçanërisht në industri, dhe pastaj si pjesë e ushqimit.

Relativisht kohët e fundit ka filluar të përmendet më shpesh, veçanërisht pasi që disa mjekë dhe terapistë me përvojë kanë filluar ta përmendin si një lidhje kyçe në parandalimin dhe shërimin e karcinomave, sidomos në raport dhe kombinim adekuat me ushqimet tjera, siç është për shembull djathi i freskët i lopës.

Ndihmon tek sëmundja e Chronit, koliti ulcerativ, artriti, depresioni, djegiet, aknet dhe sëmundjet tjera të lëkurës, redukton simptomat e astmës, redukton tensionin e lartë të gjakut. Pavarësisht kësaj, nëse tashmë i konsumoni disa ilaçe apo shtesa në ushqim, duhet të këshilloheni me mjekun kur bëhet fjalë për konsumimin e vajit të lirit, sepse rrit dhe zvogëlon veprimin e disa ilaçeve dhe mund të shkaktojë mosbalancim në marrjen e acideve yndyrore.

DALLIMI I FARAVE TË LIRIT NGA DRITHËRAT E TJERA

Farat e lirit dallohen nga drithërat dhe bimët e tjera të cilat na japin vajin sepse janë jashtëzakonisht të pasura me acidet e pangopura yndyrore, më të pasura se vaji i ullirit, e të mos

flasim për vajin e lulediellit ose farat e kungullit. Pikërisht, acidi alfa-linoleik, i cili u përket acideve yndyrore omega-4 gjendet në vajin e lirit, dhe madje në përqindje të madhe.

Sigurisht e dimë se sa janë të nevojshme acidet yndyrore omega 3 për ruajtjen e zemrës dhe enëve të gjakut, në rregullimin e nivelit të kolesterolit në gjak, ruajtja nga sëmundjet e sistemit nervor dhe para së gjithash në balancimin e duhur të acideve yndyrore omega 3 dhe omega 6 të cilat janë të domosdoshme për parandalimin e inflamacioneve në organizëm.

VAJRAT E FARAVE

Vaji i farave të lirit mund të kombinohet në shumë mënyra në kuzhinë. Disa e rekomandojnë me djathin e freskët të lopës tashmë të përmendur sepse para së gjithash është më pak i yndyrshëm prandaj "më lehtë" e thith yndyrën nga vaji i lirit, dhe njëkohësisht shërben edhe si njësi transportuese e acideve yndyrore nga vaji deri tek qelizat në organizëm.

Është jashtëzakonisht i pasur me proteina dhe kalcium. Mund ta hani si shtesë të sallatave apo shtesave të perimeve, por pasi që të ftohen sepse në temperatura të larta vaji i lirit dekompozohet

në materie të dëmshme që helmojnë organizmin tuaj. Po ashtu, kur hapet një herë, rekomandohet të shpenzohet brenda 3 javësh, ndërsa duhet të ruhet në shishe të ftohtë dhe të errët që të mos vijë deri tek ndryshimet në strukturë.

Nëse prishet, vaji do të jetë i tharbët, ndërsa ai i freskëti në gjendje të mirë është pa aromë, me shije të ngjashme me arrat dhe frutet arrorë. Rekomandimi është një deri dy lugë në ditë, përveç nëse sipas rekomandimit të nutricionistëve apo mjekëve nuk është përshkruar ndryshe. Një gram vaj ka 9 kcal, ndërsa është burim shumë i mirë i yndyrave.

Nëse dëshironi të fitoni edhe përbërës më kualitativë të lirit, në ushqyerjen e përditshme përfshini edhe farat, përbërësit e të cilave në këtë mënyrë absorbohen edhe më mirë, dhe të cilat janë pranishme më shumë se në vetë vajin, ndërsa fjala është për vitaminat B, C, E, fitosterolet: mineralet e kalciumit, selenit, bakrit, hekurit, zinkut, natriumit, magnezit, fosforit dhe kaliumit.

Farat është më së miri të blihen të plota dhe vetëm të bluhen apo shtypen para përgatitjes së ushqimit sepse të bluarat nëse qëndrojnë më gjatë se 15 minuta humbin përbërësit kualitativë, respektivisht oksidojnë. E rëndësishme është të dihet që nuk bën t'i nënshtrohen përpunimit termik sepse kështu acidet e pangopura yndyrore ndryshojnë dhe dekompozohen në të dëmshme.

GJITHÇKA ME MASË

Në kohën e fundit, me rritjen e përdorimi të vajit të lirit dhe konsumimit të farave, janë shfaqur më shumë shkencëtarë të cilët konsiderojnë që vaji i lirit nuk është aq i shëndetshëm sa flitet, pikërisht për atë që diku mund të qëndrojë i hapur në temperaturë të papërshtatshme dhe atëherë bëhet madje kancerogjen dhe vepron keq në zemër dhe enët e gjakut.



E rëndësishme është të dihet data e shtypjes, e cila gjendet në të gjitha shishet kualitative të vajit të lirit. Po ashtu, është jashtëzakonisht e rëndësishme ta mbani në frigorifer pas hapjes sepse në të kundërtën prishet dhe bëhet i dëmshëm. Po ashtu, në sasi më të mëdha duhet të konsumohet nën mbikëqyrjen e mjekut sepse në mënyrë të pafavorshme vepron në rastin e disa sëmundjeve.

Është e rëndësishme të keni masë, si në gjithçka. "Kriposeni" sallatën me vaj liri. Shtoni një lugë me djathë të freskët lope pas treningut sepse kështu do të fitoni vaktin me proteina dhe yndyra të pasura me acidet yndyrore omega 3, që janë të domosdoshme për aktivitetin e sistemit të qarkullimit të gjakut dhe zemrës, trurit, por edhe sistemeve tjera në organizëm. Nëse vendosni ekuilibër në ushqim, keni gjetur recetën për shëndet të mirë dhe jetëgjatësi.



MISTERI I VDEKJES

Një nga misteret më të mëdha të ekzistencës sonë është jeta që vjen pas vdekjes. Megjithatë, ekspertët në ditët e sotme pohojnë se nuk ka vdekje të ndër-gjegjes, por vetëm vdekje të trupit.

Sipas disa shkencëtarëve të spikatur, mekanika kuantike bën të mundur që vetëdija të jetojë edhe pas vdekjes së trupit. Edhe pse shkencëtarët ende nuk mund të përcaktojnë kuptimin e vërtetë të vetëdijes, Stuart Hameroff nga Universiteti i Arizonës pohon se është vetëm një lloj informacioni kuantik.

Fizikanti britanik Roger Penrose beson se ai dhe ekipi i tij kanë zbuluar një provë e cila konfirmon këtë teori. Konkretisht, struktura bazë e mikrotubulave përfshin proteinat të cilat janë përbërësit strukturorë të qelizave të njeriut, që mbajnë informacione kuantike në nivel nënatomik.

Sipas Roger, kur një person i nënshtrohet vdekjes së përkohshme, këto informacione kuantike lëshohen nga mikrotubulat në univers.

Megjithatë, nëse ai person kthehet në jetë, informacioni kuantik i kthehet mikrotubulave. Kjo shkakton ndjenjën e vdekjes së afërt.

Përveç kësaj, Roger thotë se nëse personi nuk ringjallet dhe vdes, informacioni kuantik ndoshta vazhdon të ekzistojë jashtë trupit dhe mbetet përgjithmonë në univers. Në fakt besohet të jetë shpirti.



Studiuesit nga Instituti i njohur i Fizikës “Max Planck” në Mynih, pohojnë se bota fizike është vetëm një perceptim i mendjeve tona dhe kur trupat tanë vdesin, e vetmja gjë që do të përjetojmë pas vdekjes do të ishte pafundësia.

Ish-drejtori i këtij instituti deklaroi se njerëzit e perceptojnë konceptimin e “këtu dhe tani” si pjesë e botës materiale, gjë e cila është e kuptueshme. Bota materiale ka edhe rrënjët e saj, gjë që mund të thotë që jetët tona në këtë botë tashmë janë përfshirë në jetën tjetër. Trupi vdes, por informacioni shpirtëror kuantik vazhdon të ekzistojë. Kjo do të thotë që ne jemi të pavdekshëm.

Dr. Christian Helluig nga Instituti i Kimisë Biofizike “Max Planck” shtoi se mendimet tona, vullneti, ndërgjegjja dhe ndjenjat tona janë pjesë e spiritualitetit tonë. Nuk ka ndërveprim të drejtpërdrejtë me forcat themelore të shkencës natyrore të cilat mund të zbulohen në bazë shpirtërore.

Megjithatë, këto karakteristika përputhen në mënyrë të përkryer me ato që i përkasin dukurisë jashtëzakonisht hutuese dhe mahnitëse të botës kuantike.



KOMPLEKSITETI I TRURIT ARRIN DERI NË... 11 DIMENSIONE!

Truri është shumë më kompleks nga se mendohej, sipas një studimi të publikuar në revistën shkencore “Frontiers in Computational Neuroscience”, i realizuar falë projektit “Blue Brain” i krijuar në vitin 2015 me iniciativë të Universitetit Politeknik të Lozanës dhe të gjigantit amerikan të teknologjisë IBM.

Kompleksiteti i trurit arrin në atë pikë sa që çdo herë që mëson diçka të re, qelizat e tij riorganizohen dhe lidhen me njëra tjetrën duke filluar nga struktura shumë të thjeshta me dy dimansione, ose tre dimensione si kubi dhe duke arritur në struktura shumë më të komplikuara me pesë, gjashtë madje edhe 11 dimensione.

“Strukturat sipas të cilave organizohet truri janë si kështjella prej rëre multidimensionale, që materializohen vazhdimisht për t’u shpërbërë menjëherë

më pas”, thotë koordinatori i këtij studimi, Henry Markram, drejtor i projektit “Blue Brain” dhe studiues në Politeknikun e Lozanës.

Shkencëtarët kanë arritur të individualizojnë këtë aspekt deri tani të panjohur dhe pak fantashkencor të organizimit të trurit duke aplikuar në mënyrë të re matematikën e studimit të neuroshkencave.

Në veçanti, organizimi i neuroneve është studiuar duke përdorur algjebrën topologjike, që është ajo degë e matematikës që përdoret për të studiuar vetitë dhe strukturën e formave në hapësirë.

Kjo është hera e parë që një metodë e tillë përdoret në neuroshkencë dhe aplikohet në studimin e qarqeve cerebrale duke mundësuar që të zbulohet se këto qarqe mund të paraqiten në figura gjeometrike me shumë dimensione.



FUSHA MANJETIKE E TOKËS

Tre mijëvjeçarë më parë, fusha magnetike e Tokës “shpërtheu” në Lindjen e Mesme. Një ngjarje e dhunshme dhe e shpejtë që ende lë gjurmë. Si ka mundësi që pikërisht në djepin e qytetërimeve dhe të feve?

Fusha magnetike e Tokës është e domosdoshme për jetën, sepse ajo vepron si një mburojë ndaj fenomeneve të dhunshme të hapësirës: studimet e reja, megjithatë, tregojnë se kjo mbrojtje nuk është e mirëqenë, apo nuk është në atë masë që na duhet, për shkak se ajo është shumë më e paparashikueshme se sa mendohet.

Disa çekuilibra aktuale në fushën magnetike janë të njohura, për shembull, një rënie e intensitetit prej 10% në zonën e Atlantikut të Jugut që, sa u përket aktiviteteve njerëzore, ka ndikuar në operimin e satelitetëve në orbitë, në atë rajon. Gjurmët e një ndryshimi të dëmshëm në të kaluarën janë gjetur: 3000 vjet më parë, në Lindjen e Mesme, fusha magnetike më shumë se u dyfishua.

ANOMALITE

Kjo ishte një rritje e papritur me më shumë se 100%, pasuar nga një kthim në gjendjen e mëparshme gjatë 30 viteve të ardhshëm. Ky është zbulimi i gjeologëve që kanë analizuar gjetjet dhe mineralet e bakrit në Jordani dhe Izrael.

Bakri ruan një gjurmë të fushës magnetike të cilës i nënshtrohet në kohën kur ngurtësohet. Shtresa pas shtrese, sipas periudhës, gjeologët kanë qenë në gjendje të rindërtojnë një valë magnetike 30-vjeçare anormale. Rezultatet u lidhën më pas me studime të ngjashme në Kinë, Turqi dhe Gjeorgji, dhe u zbulua se, për çudi, në të njëjtën periudhë, fusha magnetike e regjistruar në Egjipt, Qipro dhe Indi ishte krejtësisht normale.

Kjo lloj anomalie është si një lançim gjeomagnetik: një rritje të shpejtë dhe e lokalizuar e magnetizmit në një sipërfaqe prej rreth 2000 km.

Fusha magnetike gjenerohet 3000 km poshtë këmbëve tona, në bërthamën e lëngët të planetit, ku hekuri i shkrirë i nënshtrohet lëvizjeve konvektive që janë burimi i vetë fushës dhe motori i pllakave tektonike. Teoria e gjeologëve është se ngjarja e 3000 vjetëve më parë u prodhuan nga një fluks hekuri 5 deri në 10 herë më shpejt se normalja.

FENOMEN I LASHTË, SHKENCE MODERNE

Ky është një nga ndryshimet më drastike në fushën magnetike dhe është unik në llojin e vet – tani për tani, sepse njohuritë tona të gjeomagnetizmit janë bazuar vetëm në 200 vite matje direkte.

RRITJA E ARDHSHME

Një zbulim që ngre pyetje të reja mbi rajonet e brendshme të Tokës, dhe në bazë të këtij studimi janë duke u ndërtuar modele të reja matematikore, që lejojnë simulimin e marrëdhënieve mes bërthamës dhe magnetosferës.

Ndoshta janë edhe në gjendje të parashikojnë sjellje të ardhshme anormale si kjo, që nuk mund të jetë aq të dëmshme për vendin ku ndodhin, se sa për zonat që do të mbeten më pak të mbrojtura, me një fushë të dobësuar dhe, për këtë arsye, me një mburojë më pak efektive ndaj rrezatimit diellor dhe atij kozmik, që në varësi të intensitetit mund të shkaktojë dëmtimin e jetës dhe teknologjisë. Sepse, kur fusha rritet në një zonë, zvogëlohet në një tjetër.



“Udhëzона
në rrugën
e drejtë!”

(Fatiha, 6)

ISSN 2227-3611



9 772227 361004

12